



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 633 Akti

Nr. 658 Vendimi
Tiranë, më 12.5.2023

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Roland Ilia	Kryesues
Genta Tafa (Bungo)	Relatore
Suela Zhegu	Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Etmonda Hoxha, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Gerrit Sprenger, në datën 10.5.2023, ora 13:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Petraq Çuri**, gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2015, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Genta Tafa (Bungo), vlerësoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe analizoi provat shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit dhe në seancë dëgjimore, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, bazuar në paragrafin 5 të nenit 179/b të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në pikën 5 të nenit 3 dhe në pikën 1 të nenit 5 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

2. Subjekti i rivlerësimit, z. Petraq Çuri, aktualisht me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, është subjekt i rivlerësimit që i nënshtrohet rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

3. Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni) ka hedhur shortin në datën 15.12.2020, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit, z. Petraq Çuri, do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Genta Tafa (Bungo), Roland Ilia dhe Suela Zhegu. Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionerja Genta Tafa (Bungo).

4. Në mbledhjen e datës 24.12.2020 u caktua me mirëkuptim kryesues komisioneri Roland Ilia, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin Petraq Çuri.

5. Në referim të pikës 1 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, për subjektin Petraq Çuri nisi procesi i rivlerësimit dhe hetimi i thelluar administrativ.

6. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK); dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor.

7. Në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave dërgoi raportin¹ e hollësishëm dhe të arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Petraq Çuri. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, është konstatuar se:

- deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;
- nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- ka kryer fshehje të pasurisë;
- ka kryer deklarim të rremë;
- subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

8. Në vijim, relatorja e çështjes ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm.

9. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe provat e grumbulluara për kriterin e vlerësimit të pasurisë, në datën 31.3.2023 vendosi përfundimin e hetimit kryesisht vetëm për kriterin e pasurisë për subjektin e rivlerësimit Petraq Çuri, si dhe njoftimin e subjektit për t’u njohur me materialet e dosjes dhe rezultatet e hetimit në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.

¹ Me shkresën nr. *** prot., datë 10.1.2020.

10. Subjekti i rivlerësimit u njoftua me anë të postës elektronike, të datës 31.3.2023, mbi të drejtën për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo të kërkonte marrjen e provave të reja ose thirrjen e dëshmitarëve lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga Komisioni.

11. Në datën 13.4.2023 subjekti paraqiti kërkesën për zgjatjen e afatit për dorëzimin e shpjegimeve dhe provave në lidhje me rezultatin e hetimeve paraprake deri më 31.5.2023. Në lidhje me vlerësimin e kësaj kërkesë, Komisioni mbajti në vëmendje se:

- i. Në datën 26.1.2023 subjektit i është dërguar një pyetësor, duke iu lënë si afat për kthimin e përgjigjeve data 8.2.2023. Njoftimi i dërgimit të këtij pyetësori është lexuar nga subjekti në datën 27.1.2023 dhe më 1.2.2023 subjekti ka konfirmuar marrjen e njoftimit.
- ii. Në datën 7.2.2023, një ditë përpara mbarimit të afatit për kthim përgjigje të pyetësorit, subjekti ka kërkuar shtyrjen për 3 muaj të këtij afati. Në lidhje me këtë kërkesë Komisioni vendosi ta pranojë pjesërisht, duke e shtyrë afatin deri në datën 27.1.2023.
- iii. Në datën 17.2.2023 subjekti ka kërkuar sërish shtyrje afati. Komisioni sërish ka pranuar kërkesën e subjektit duke i caktuar një afat përfundimtar deri në datën 21.2.2023 për të kthyer përgjigje dhe deri më 27.2.2023 për të depozituar dokumentacionin, duke e vënë në dijeni se i gjithë qëndrimi i tij do të merret në konsideratë gjatë vendimmarrjes përfundimtare, në përputhje me nenin 48 të ligjit nr. 84/2016.

12. Për pasojë, Komisioni vlerësoi se kjo kërkesë kalon kufijtë e një afati të arsyeshëm, por megjithatë vendosi t'i japë subjektit afat të ri për paraqitjen e prapësimeve për rezultatet e hetimit deri në datën 20.4.2023. Në *email*-in e dërguar subjektit në lidhje me këtë kërkesë, iu vu në dukje edhe fakti se me vullnetin e tij të lirë kishte zgjedhur të përfaqësohej me anë të një avokati, sipas prokurës së datës 3.4.2023, duke pasur kështu mundësitë të ushtronte të gjitha të drejtat e tij nëpërmjet përfaqësimit.

13. Komisioni ka konstatuar se subjekti, së bashku me prapësimet dhe provat e paraqitura më 24.4.2023, ka bashkëlidhur edhe revokimin e prokurës që kishte lëshuar për avokatin I. H. Në dokumentin noterial revokim prokure nr. ***, datë 14.4.2023, subjekti deklaroi se revokon tagrat e përfaqësimit, pasi avokati nuk ka përvojën e nevojshme për ta përfaqësuar në procedurën e gjyqimit. Ky veprimi i subjektit duket sikur është bërë me qëllim zvarritjen e procesit të tij të rivlerësimit, pasi është bërë menjëherë pasi Komisioni i ka vënë në dukje subjektit se ai kishte një përfaqësues ligjor për të vijuar më tej me procesin e rivlerësimit.

14. Në datën 18.4.2023 subjekti ka kërkuar sërish kohë shtesë për të paraqitur prapësimet e tij deri më 3.5.2023. Kësaj kërkesë Komisioni i ka dhënë përgjigje në datën 24.4.2023 (kjo për shkak të mungesës në punë të njërit prej anëtarëve të trupit gjykues, për arsye objektive).

15. Në datën 20.4.2023 subjekti ka kërkuar çeljen e hetimit administrativ edhe për të dyja kriteret e tjera. Komisioni ka vlerësuar të mos e pranojë këtë kërkesë, duke e njoftuar subjektin se një vendimmarrje e tillë do të bëhej pasi të vlerësoheshin të gjitha provat dhe shpjegimet e paraqitura në kundërshtim të barrës së provës, si dhe pasi të dëgjohej në seancë dëgjimore, në përputhje me praktikën dhe standardin e vendosur nga Komisioni.

16. Në këtë kërkesë sërish subjekti ka kërkuar afat shtesë 1 muaj. Në pikën 11 të kësaj kërkesë subjekti shprehet se beteja e tij nuk lidhet me vazhdimësinë e të qenit gjyqtar, pasi funksioni i tij si gjyqtar mbaron në datën 13.6.2023 për shkak të pensionit të pleqërisë. Komisioni nuk e ka pranuar këtë kërkesë të subjektit, duke i dhënë kohë deri më 3.5.2023, sikundër ishte kërkuar prej tij në datën 18.4.2023.

17. Në datën 2.5.2023 subjekti ka kërkuar sërish zgjatjen e afatit deri më 4.6.2023. Kjo kërkesë nuk është pranuar nga Komisioni, duke vlerësuar se subjekti ka pasur të gjithë kohën e mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen e tij, për më tepër data e vendosur nga Komisioni 3.5.2023 është një datë e kërkuar nga vetë subjekti në kërkesën e datës 18.4.2023. Gjithashtu,

Komisioni mban në konsideratë faktin se rezultatet e hetimit janë dërguar më 31.3.2023 dhe subjekti ka pasur më shumë së 1 muaj kohë për të paraqitur prapësimet e tij deri në datën 3.5.2023. Në këtë vlerësim, Komisioni mban në vëmendje edhe faktin se barra e provës e dërguar subjektit pothuajse përputhet me pyetësorin e dërguar në datën 26.1.2023, për pasojë subjekti ka pasur gjithë kohën e mjaftueshme për të plotësuar dokumentacionin e pretenduar nga ana e tij deri më 3.5.2023. Për sa më sipër, kjo kërkesë për shtyrjen e afatit vlerësohet se është bërë me qëllim zvarritjen e procesit të rivlerësimit dhe është abuzive.

II. SEANCA DËGJIMORE

18. Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore publike me njoftimin e bërë elektronikisht me *email* në datën 3.5.2023.

19. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në datën 10.5.2023, ora 13:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Gerrit Sprenger.

20. Subjekti i rivlerësimit Petraq Çuri mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur dhe parashtruar shpjegimet dhe opinionin individual në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij. Në përfundim të shpjegimeve dhe parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit kërkoi nga Komisioni riçeljen e hetimit për të dyja kriteret e tjera.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

21. Në vlerësimin e përgjithshëm, Komisioni konstaton se z. Petraq Çuri nuk ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij. Ai nuk është përgjigjur në kohë, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ, duke kërkuar vazhdimisht shtyrjen e afatit për kthimin e përgjigjes së pyetësorit të datës 26.1.2023. Si pasojë e këtyre kërkesave, Komisioni, për t'i dhënë mundësi subjektit për të kthyer përgjigje shteruese, shoqëruar me dokumentacion shterues, e ka shtyrë tre herë afatin për paraqitjen e përgjigjeve dhe dokumentacionit të kërkuar në pyetësorin e datës 26.1.2023. Pavarësisht këtij qëndrimi, subjekti sërish nuk ka dhënë përgjigje të plota, si dhe nuk ka depozituar dokumentacionin e kërkuar nga Komisioni. Subjekti ka vijuar të mbajë të njëjtin qëndrim edhe pas dërgimit të rezultateve të hetimit në datën 31.3.2023. Ai ka kërkuar kohë shtesë fillimisht 3 muaj, më pas deri në datën 3.5.2023, si dhe pas pranimit të kësaj kërkesë ka kërkuar edhe një afat tjetër 1-mujor. Për më tepër nga ana e tij, gjatë periudhës pas dërgimit të rezultateve të hetimit është revokuar me akt nr. **, datë 14.4.2023, prokura e posaçme nr. ***, datë 3.4.2023, e lëshuar për avokatin I.H. Ky veprim është kryer pasi Komisioni i ka vënë në dukje subjektit se ai kishte një përfaqësues ligjor dhe kërkesa për shtyrjen e afatit nuk ishte e mbështetur. Të gjitha afatet e kërkuara nga subjekti përfundonin në qershor të këtij viti, muaj i cili përkon me mbushjen e moshës për të dalë në pension, pasi subjekti është i datëlindjes 13.6.1956. Trupi gjykues krijoi bindjen se subjekti ka pasur për qëllim që procesi i kontrollit të verifikimit të pasurisë të shtyhet deri në datën e mbushjes së moshës për të dalë në pension, me qëllim shmangien e tij nga ky proces, duke prodhuar një rezultat në favor të tij. Kjo mungesë bashkëpunimi e ka vendosur Komisionin në kushtet e pamundësisë për kryerjen e plotë e të detajuar të procesit të rivlerësimit të pasurive të subjektit dhe personave të lidhur me të. Mungesa e bashkëpunimit të subjektit për zhvillimin e procesit të rivlerësimit do të mbahet në konsideratë nga Komisioni në marrjen e vendimit përfundimtar, në përputhje me kërkesat e nenit 48 të ligjit.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

22. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe

prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

23. Referuar vendimit nr. 2/2017² të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016 rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

24. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*, të dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI; (ç) deklaratat periodike të dorëzuara ndër vite dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja, të cilat gjenden në dosjen e subjektit, dërguar në Komision; (d) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (dh) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ; si dhe (e) shpjegimet e subjektit dhe provat e paraqitura gjatë seancës dëgjimore.

A. VLERËSIMI I PASURISË

25. Pas marrjes së raportit të hollësishëm dhe të arsyetuar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit nga ILDKPKI-ja, u procedua me hetimin administrativ për vlerësimin e pasurisë së subjektit. Hetimi i kryer nga Komisioni është përqendruar në vërtetësinë e deklarimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, si dhe burimin e ligjshëm të krijimit të këtyre pasurive.

Në deklaratën *Vetting* (shtojca 2), të dorëzuar në ILDKPKI në datën 28.1.2017, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë deklaruar se posedojnë pasuritë në vijim.

Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar këto pasuri:

26. Apartament³ me sipërfaqe 76.7 m², në Tiranë. Kontratë sipërmarrjeje nr. ***, datë 10.7.2007. Vërtetim hipotekor nr. ***, datë 14.7.2014. Vlera: 72,080 euro. Pjesa takuese: 50%.

Burimi sipas deklaratës *Vetting*: të ardhurat nga puna si avokat në vitet 1993 – 2010, të ardhurat e bashkëshortes nga paga si punonjëse e “P.D” sh.a., Vlorë, në vitet 1987 – 2011, si dhe interesat bankarë në vite.

27. Garazh me sipërfaqe 19.8 m², në Tiranë. Kontratë sipërmarrjeje nr. ***, datë 10.7.2007. Vlera: 12.000 euro. Pjesa takuese: 50%.

² “41. Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelimit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se: “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelimit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse.”

³ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratën *Vetting*: (i) kontratë sipërmarrjeje nr. ***, datë 10.7.2007; (ii) vërtetim nga dokumenti hipotekor, i datës 22.7.2014.

Burimi sipas deklaratës Vetting: të ardhurat nga puna si avokat në vitet 1993 – 2010, të ardhurat e bashkëshortes nga paga si punonjëse e “P.D” sh.a., Vlorë, në vitet 1987 – 2011, si dhe interesat bankarë në vite.

Konstatimi i ILDKPKI-së

- *Të ardhura të subjektit nga fitimi i aktiviteti të tij si person fizik avokati, me NIPT K***E, llogariten në total maksimalisht rreth 20,000,000 lekë (bazuar në xhiro - tatime).*
- *Subjekti e ka shoqëruar deklarinimin me dokumentacion bankar që i përket periudhës 1998 – 2010, për pagesë tatime, taksa etj., në funksion të aktivitetit të tij avokati, me NIPT K***E, që gjithsesi konfirmojnë kryerje aktiviteti privat, por jo masën e fitimit të realizuar/deklaruar nga ky biznes. Periudha 1993 – 1997 mbetet e padokumentuar.*
- *DRT Vlorë konfirmon fitimin për periudhën 2008 – 2009, në total 1,314,000 lekë.*
- *Nuk është i qartë punësimi i subjektit për periudhën para vitit 1993.*

Hetimi⁴ dhe analiza financiare-juridike e kryer nga Komisioni

28. Në datën 10.7.2007 bashkëshortja e subjektit ka lidhur kontratë sipërmarrjeje nr. ***, sipas së cilës ka porositur pranë shoqërisë “P.C.A” sh.p.k. apartament nr. ***, me sip. 84.8 m², me vlerë 72,080 euro, me çmim 850 euro/m² dhe garazh me vlerë 12,000 euro në godinën e banimit në Rr e K.

Në pikën 3.1 të kontratës është parashikuar edhe mënyra e pagesës, si vijon:

- kësti i parë 42,000 euro do të likuidohet në momentin e nënshkrimit të kontratës;
- kësti i dytë 20,000 euro do të paguhet në datën 20.12.2007;
- diferenca e mbetur prej 22,040 euro deri në datën 20.3.2008.

Të dyja pasuritë e mësipërme rezultojnë të regjistruara në ASHK në emër të subjektit dhe bashkëshortes së tij, përkatësisht apartamenti nr. *** me sip. 76.7 m², me nr. pasurie ***, z. k. *** dhe garazhi me sip. 19.8 m², me nr. pasurie ***-G**, z. k. ***.

Subjekti dhe bashkëshortja e tij për pasurinë apartament kanë lidhur kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 26.5.2014 dhe për pasurinë garazh kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 26.5.2014.

29. Duke qenë se nga ana e shoqërisë “P.C.A” sh.p.k. është konfirmuar se pagesat janë kryer sipas parashikimeve të nenit 3/3.1 të kontratës së porosisë dhe çmimi i plotë është likuiduar tërësisht brenda vitit 2008, Komisioni do të kryejë analizën financiare për blerjen e këtyre dy pasurive me gjendjen e të ardhurave të subjektit deri më 20.3.2008.

30. Komisioni, në lidhje me këto pasuri, ka konstatuar se subjekti nuk ka qenë i saktë në deklarinimin e tij në deklaratën Vetting në lidhje me burimin e tyre, pasi ka përfshirë në këtë burim edhe të ardhurat e viteve 2008 – 2011, periudhë kjo që është përtej kohës së kryerjes së pagesave.

⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 28.1.2021, drejtuar ASHK-së; kthim përgjigje nr. *** prot., datë 25.2.2021, e ASHK Tiranë Jug; shkresë nr. *** prot., datë 28.1.2019, drejtuar OSHEE-së; kthim përgjigje nr. *** prot., datë 11.2.2021, e FSHU-së; shkresë nr. *** prot., datë 28.1.2021, drejtuar UKT-së; kthim përgjigje nr. K-***prot., datë 10.2.2021, e UKT-së; shkresë nr. *** prot., datë 28.1.2019, drejtuar QKB-së; kthim përgjigje nr. *** prot., datë 16.2.2021, e QKB-së; shkresë nr. *** prot., datë 28.1.2021, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve; kthim përgjigje nr. *** prot., datë 10.2.2021, e DPT-së; kthim përgjigje nr. *** prot., datë 17.2.2021, e DRT-së Vlorë; shkresë nr. *** prot., datë 17.11.2022, drejtuar shoqërisë “P.C.A” sh.p.k.; kthim përgjigje datë 30.11.2022, e shoqërisë “P.C.A” sh.p.k.; shkresë nr. *** prot., datë 26.1.2023, drejtuar noterit publik M.S; kthim përgjigje e noterit publik M.S, datë 3.2.2023.

31. Në lidhje me këtë konstatim, subjekti pas dërgimit të rezultateve të hetimit ka sqaruar⁵ se nga ana e bashkëshortes së tij janë cituar si burim të ardhurat e saj deri në vitin 2011, për faktin se ajo ka depozituar vërtetimin e lëshuar nga “P.D” sh.a., Vlorë, sipas të cilit znj. M.Ç ka punuar pa ndërprerje në këtë institucion nga data 6.10.1987 deri më 30.12.2011. Kjo shumë të ardhurash nga paga shërben si burim për pasuritë sipas kohës kur ato janë krijuar. Për rrjedhojë, prej saj është menduar që kjo shumë do të ndahej sipas kohës së krijimit të pasurisë, në rastin konkret të ndahej deri në vitin 2008 që është blerë ky apartament, pa përfshirë periudhën e të ardhurave pas vitit 2008.

32. Në lidhje me këtë pretendim të subjektit, Komisioni vlerëson se ai nuk është bindës, pasi bazuar në nenin D, pikat 2 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në nenin 32 të ligjit nr. 84/2016, subjektet kanë detyrimin ligjor që të deklarojnë saktë burimin e ligjshëm të të ardhurave të krijimit të pasurive të tyre. Nga ana e subjektit, sikundër pranohet edhe në shpjegimet e tij, nuk është deklaruar saktësisht burimi i ligjshëm i të ardhurave të pasurive të mësipërme, pasi ai ka deklaruar si burim në mënyrë të përgjithshme të ardhurat e tij dhe të bashkëshortes, duke mos specifikuar vitet përkatëse kur janë krijuar këto pasuri. Në lidhje me këtë pasaktësi, Komisioni vlerëson se ajo nuk përbën shkak autonom për shkarkimin e subjektit, por do të mbahet në konsideratë në vlerësimin tërësor të kriterit të pasurisë.

33. Në lidhje me mobilimin e këtij apartamenti, subjekti gjatë hetimit deklaroi se e ka bërë në vitin 2009, kryer nga një klient i tij, shtetasi A.C, me profesion marangoz. Subjekti ka depozituar deklaratën noteriale nr. ***, datë 26.12.2020, në të cilën z. C deklaroi se: *“...duke e vlerësuar maksimalisht punën e tij si avokat, unë e kam ndihmuar atë për mobilimin... e apartamentit në Tiranë ku ai ka paguar vetëm vlerën e materialeve, kurse punën si marangoz e kam kryer pa shpërblim. Vlera e materialeve është në masën 100,000 lekë. ...apartamenti në Tiranë është mobiluar rreth vitit 2009”*.

34. Në lidhje me deklarinimin e shpenzimeve për mobilimin, Komisioni konstaton se nga ana e subjektit nuk janë dhënë shpjegime në lidhje me vlerën e pajisjeve dhe orendive të tjera të apartamentit, për rrjedhojë Komisioni e ka pasur të pamundur për të kryer një analizë financiare të plotë të subjektit të rivlerësimit. Ky veprim i subjektit do të konsiderohet si mungesë bashkëpunimi, në kuptim të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016.

35. Pas dërgimit të rezultateve të hetimit, subjekti sqaron⁶ se në pyetësorin nr. 1, datë 31.1.2023, nuk i është kërkuar të japë shpjegime në lidhje me vlerën e pajisjeve dhe orendive të tjera të apartamentit, por vetëm për vlerën e mobilimit të tij, prandaj ka dhënë shpjegime vetëm për mobilimin. Subjekti deklaroi se *pajisjet elektroshtëpiake iu bënë dhuratë për blerjen e shtëpisë së re nga prindërit dhe të afërmit*.

36. Komisioni konstaton se sërish subjekti nuk ka specifikuar saktësisht vlerën e mobilimit të shtëpisë, por është përpjekur të shmangë dhënien e një përgjigjeje të plotë. Deklarimi i tij se pajisjet elektroshtëpiake i janë dhuruar, mbetet në nivel deklarativ dhe i pashoqëruar me dokumentacion provues. Komisioni vlerëson se subjekti ka refuzuar të japë shpjegime me qëllim që procesi i kontrollit të verifikimit të pasurisë të prodhojë një rezultat në favor të tij. Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka qenë bashkëpunues, në kuptim të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016 dhe ky qëndrim i tij do të mbahet në konsideratë në vlerësimin tërësor të kriterit të pasurisë.

37. Si burim për këtë apartament subjekti ka deklaruar të ardhurat e tij nga puna si avokat, duke vënë në dispozicion dokumentacion provues si vijon:

⁵ Për më shumë referohuni në prapësimet dhe provat e depozituara nga subjekti pas dërgimit të rezultateve të hetimit, si dhe gjatë seancës dëgjimore.

⁶ Për më shumë referohuni në prapësimet dhe provat e depozituara nga subjekti pas dërgimit të rezultateve të hetimit, si dhe gjatë seancës dëgjimore.

- vërtetim të Dhomës Kombëtare të Avokatisë, datë 25.3.2014, sipas të cilit subjekti ka ushtruar profesionin e avokatit nga viti 1993 deri më 31.3.2010;
- vërtetim të Dhomës së Avokatisë Vlorë, datë 20.3.2014, sipas të cilit subjekti ka ushtruar profesionin e avokatit nga për periudhën 6.3.1993 – 31.3.2010;
- vërtetim nr. ***, datë 16.9.2010, i ISSH-së Vlorë, sipas të cilit z. Petraq Çuri është i siguruar pranë personit fizik nr. ***, për periudhën 16.3.1993 – 31.12.2004;
- vërtetim nr. ***, datë 16.9.2010, i ISSH-së Vlorë, sipas të cilit ka paguar në rregull kontributet e sigurimeve shoqërore sipas ligjit në fuqi pranë subjektit me NIPT K***E, për periudhën 1.1.2005 – 31.3.2010, me pagë minimale;
- kthim përgjigje nr. *** prot., datë 12.10.2016, e Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Vlorë, sipas së cilës rezulton informacioni i mëposhtëm në lidhje me xhiron e deklaruar nga subjekti:

Viti	Xhiro e parashikuar	Tatimi i paguar	Deklarata	Fitimi i deklaruar
1999		70,000		
2000				
2001	2,000,000	30,000		
2002		70,000		
2003	1,500,000	60,000		
2004	3,000,000	120,000		
2005	4,000,000	120,000		
2006	5,000,000	75,000		
2007				
2008	2,530,000	0	2,530,000	980,000
2009	2,530,000	0	2,500,000	120,000
2010	0	0	0	0

- kthim përgjigje nr. *** prot., datë 24.10.2016, e Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Vlorë, sipas së cilës subjekti ka qenë i regjistruar me vendim gjykate nr. ***, datë 5.3.1993, me kod fiskal ***, lloji i aktivitetit “Avokati”. Lidhur me periudhën 1993 – 1997 nuk disponohet asnjë dokumentacion, ndërsa në vitin 1998 në sistemin e vjetër rezultojnë disa pagesa, si:
 - taksë mbi biznesin e vogël 70,000 lekë;
 - taksë solidariteti 5,400 lekë;
 - taksë mbi qiranë 2,000 lekë;
- vërtetim nr. *** prot., datë 25.10.2016, i Bashkisë Vlorë, sipas së cilit subjekti ka deklaruar xhiro në vitin 2007 në shumën 4,000,000 lekë dhe ka paguar taksë mbi biznesin e vogël në shumën 83,000 lekë dhe në vitin 2008 xhiro 5,200,000 lekë dhe ka paguar taksë mbi biznesin e vogël 98,000 lekë;
- mandatarkëtimi nga viti 1998 e në vijim për pagesën e detyrimeve të ndryshme tatimore dhe taksave.

Në lidhje me të ardhurat nga avokatia, subjekti në deklaratën *Vetting* ka deklaruar se ka përfituar shumën 42,100,000 lekë.

38. Nga hetimi ka rezultuar:

- i. QKB-ja informon se subjekti figuron të ketë qenë i regjistruar si person fizik me NIPT K***E, i cili nuk ka kryer plotësimin e të dhënave. Aktualisht, subjekti është me status “çregjistruar”. Nga ekstrakti i depozituar në QKB rezulton se subjekti është regjistruar në datën 27.3.2003.

- ii. DRT Vlorë, me shkresën⁷ nr. *** prot., datë 7.7.2017, informon se subjekti figuron i regjistruar si person fizik me NIPT K***E në datën 27.3.2003 dhe në datën 20.5.2011 ka aplikuar për çregjistrim.

Qarkullimi dhe fitimi i deklaruar:

Viti	Qarkullimi	Fitimi
2008	2,530,000	882,000
2009	2,500,000	432,000
2010	0	0
2011	0	0

- iii. DRT Vlorë, me shkresën nr. *** prot., datë 17.2.2021, informon se subjekti është regjistruar në DRT-në Vlorë në datën 1.1.1994, me kod fiskal ***, më pas me NIPT K***E, në datën 9.2.2016, është çregjistruar nga regjistrat e administratës tatimore (subjekti ka aplikuar për çregjistrim që prej datës 6.4.2010).

Viti	Xhiro e parashikuar	Fitimi
2001	2,000,000	
2003	1,500,000	
2004	3,000,000	
2005	4,000,000	
2006 ⁸	5,000,000	
2008	2,530,000	882,000
2009	2,500,000	432,000
2010	0	0

Bazuar në të dhënat e mësipërme, Komisioni, duke iu referuar edhe rasteve të tjera të ngjashme⁹, ka llogaritur marzhin e fitimit të subjektit në vlerën 26.1%, duke iu referuar të dhënave të viteve 2008 - 2009, të vëna në dispozicion nga Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë.

39. Komisioni, për të qenë sa më shterues në lidhje me marzhin e fitimit dhe përlllogaritjen e të ardhurave nga avokatia të subjektit, i ka kërkuar informacion në lidhje me të ardhurat nga ushtrimi i profesionit të avokatit. Subjekti ka sqaruar¹⁰ në pyetësonin e datës 26.1.2023 se shkresa nr. *** prot., datë 12.10.2016, e DRT-së Vlorë, është e paplotë në tërësi dhe e gabuar në pjesën për deklarimet e viteve 2007 dhe 2008. Sipas subjektit, kjo shkresë për vitin 2007 nuk ka asnjë të dhënë, ndërsa për vitin 2008 xhiroja e parashikuar është 2,530,000 lekë dhe fitimi 980,000 lekë. Duke parë mangësitë në shkresën nr. *** prot., datë 12.10.2016, të DRT-së Vlorë, ai i është drejtuar Bashkisë Vlorë, Drejtorisë së Menaxhimit Financiar.

Në vërtetimin nr. *** prot., datë 25.10.2016, të lëshuar nga ky institucion, citohet: “...xhiroja e deklaruar në fillim të vitit 2007 dhe 2008 ka qenë si më poshtë:

- viti 2007, xhiroja 4.000.000 lekë, T. B. Vogël 83,000 lekë;

⁷ Pjesë e hetimit të ILDKPKI-së.

⁸ Për vitet 2001 – 2006 s’ka informacion. Në dosje është vetëm parashikimi.

⁹ Vendimet nr. 583/2022, nr. 339/2021 dhe nr. 175/2019 të Komisionit.

¹⁰ Subjekti ka depozituar: (i) listën e vendimeve nga të tria gjykatat për vitet 1993 – 2000. Kjo listë është thjesht e subjektit dhe jo e lëshuar nga gjykatat përkatëse, për rrjedhojë nuk mund të merret në cilësinë e provës; (ii) disa akte të përpiluara nga avokat P.M. Këto akte, për sa kohë nuk janë përpiluar nga subjekti, nuk mund të merren në cilësinë e provës; (iii) foto të vërtetimit për bazën e vlerësuar, i cili nuk rezulton të jetë i paraqitur në formën e kërkuar nga ligji, pasi nuk është as i firmosur e as i vulosur, për rrjedhojë nuk mund të merret në cilësinë e provës; (iv) akti i detyrimit për taksat dhe tarifatat vendore, datë 6.3.2006, sipas të cilit është paguar shuma 9,200 lekë; (v) urdhërderdhje datë 25.1.2002, lëvizje e arkës, datë 19.3.2003, derdhur taksë për biznesin e vogël vlera 7,100 lekë; (vi) mandatarëkëtim nr. ***, datë 6.3.2006, i Bashkisë Vlorë, paguar shuma 9,200 lekë; (vii) vërtetim nr. *** prot., datë 25.10.2016, i Bashkisë Vlorë, sipas të cilit subjekti ka deklaruar xhirot e mëposhtme: viti 2007 4,000,000 lekë, taksë biznesi i vogël 83,000 lekë; viti 2008 xhiro 5,200,000 lekë, taksë biznesi i vogël 98,000 lekë; (viii) foto të një konteneri; (ix) kopje të vendimeve të ndryshme ku subjekti ka qenë përfaqësues i palëve.

- viti 2008, xhiroja 5.200.000 lekë, T. B. Vogël 98.000 lekë... ”.

Në funksion të mbrojtjes së tij, subjekti ka depozituar vendimet gjyqësore në të cilat figuron avokat, ku ka përfaqësuar dhe mbrojtur klientët e tij, të nxjerra nga arkiva e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, nga volumet e vendimeve gjyqësore për vitet 1993 – 2000. Subjekti ka sqaruar se këto palë i ka përfaqësuar në këto gjykime edhe në gjykatat më të larta, pasi ishte avokat që i ndiqte çështjet deri në fund.

Vlera e përfaqësimeve në gjykatën e shkallës së parë për periudhën 1993 – 1997, 2000

Viti	Numri i çështjeve	Tarifa mesatare	Vlera totale
1993	26.0	50,000	1,300,000
1994	51.0	50,000	2,550,000
1995	33.0	50,000	1,650,000
1996	48.0	50,000	2,400,000
1997	15.0	50,000	750,000
Shuma	173.0		8,650,000

Vlera e përfaqësimeve në gjykatat e apelit për periudhën 1993 – 1997, 2000

Viti	Numri i çështjeve	Tarifa mesatare	Vlera totale
1993	9.0	60,000	540,000
1994	16.0	60,000	960,000
1995	10.0	60,000	600,000
1996	20.0	60,000	1,200,000
1997	5.0	60,000	300,000
2000	11.0	70,000	770,000
Shuma	71.0		4,370,000

Vlera e përfaqësimeve në Gjykatën e Lartë për periudhën 1993 – 1997, 2000

Viti	Numri i çështjeve	Tarifa mesatare	Vlera totale
1993	1	80,000	80,000
1994	4	80,000	320,000
1995	9	80,000	720,000
1996	6	80,000	480,000
1997	3	80,000	240,000
2000	11	100,000	1,100,000
Shuma	34		2,940,000

Subjekti ka pretenduar se, përveç përfaqësimit dhe mbrojtjes së klientëve në gjykatë në vitet 1993 – 1997, nga ana e tij si avokat redaktoheshin kontrata dhe akte noteriale të ndryshme, të cilat më pas firmoseshin tek noteri. Kjo pas vitit 1999 kryhej nga vetë noterët.

Për të provuar këtë pretendim, subjekti ka depozituar kontrata dhe akte që i përkasin ish-avokat P.M, pasi vetë nuk ka mundur t'i ruajë ato, për faktin se zyra e tij u prish në vitin 1999. Subjekti ka pretenduar si të ardhura neto për vitet 1993 – 2009 shumë 48,361,757 lekë.

40. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerëson se për sa i përket marzhit të fitimit do të vijojë të mbështetet në të dhënat e administruara nga Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë, kjo për vetë faktin se ka qenë vetë subjekti i rivlerësimit që së bashku me deklaratën *Vetting* ka depozituar shkresën nr. ***prot., datë 12.10.2016 dhe shkresën nr. *** prot., datë 24.10.2016, të DRT-së Vlorë. Në këto shkresa jepen të dhëna për ushtrimin e aktivitetit si avokat të subjektit. Për më tepër, edhe nga hetimi i Komisionit janë konfirmuar të dhënat nga organet tatimore dhe mbi këtë bazë marzhi i fitimit është përllogaritur në vlerën 26%.

Komisioni, për sa kohë nga subjekti nuk janë paraqitur dokumente ligjore nga organet tatimore për vitet 1993 – 2000 në lidhje me ushtrimin e aktivitetit si avokat, nuk do të përfshijë në analizë financiare të ardhurat e pretenduara nga subjekti për këtë periudhë, pasi nuk është provuar pagimi i detyrimeve tatimore, si dhe qarkullimi vjetor i subjektit në këtë periudhë. Tarifat e deklaruara nga subjekti për vitet 1993 – 2000 në vlerat 50,000 lekë, 80,000 lekë dhe 60,000 lekë janë tarifa që nuk mbështeten në dokumentacion provues, por edhe nuk përputhen me piramidën e pagave, pasi këto tarifa janë të barabarta ose më të larta se të ardhurat vjetore të një punonjësi që paguhej me pagë minimale. Duke iu referuar ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, paga minimale vjetore për periudhën 1993 – 1997 varion nga 40,000 lekë – 55,000 lekë dhe për vitin 2000 është rreth 77,000 lekë.

Në përfundim, nga analiza financiare duket se subjekti ka përfutuar të ardhura nga avokatia në vlerën 6,384,000.00 lekë.

Për rrjedhojë, subjekti ka kryer deklaram të pasaktë në deklaratën *Vetting*, duke deklaruar të ardhura nga avokatia në shumën 42,100,000 lekë.

41. Pas kalimit të barrës së provës subjekti sqaron¹¹ se në periudhën që ka filluar punë si avokat ka qenë në fuqi ligji nr. 7667, datë 28.1.1993, “Për regjistrin tregtar dhe formalitetet e regjistrimit të shoqërive tregtare”, dhe ky regjistër mbahej nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë për shoqëritë tregtare, kurse regjistrat tregtarë për personat fizikë mbaheshin nga gjykatat e rretheve. Prandaj i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, e cila me vendimin nr. ***, datë 5.3.1993, ka lëshuar vendimin për regjistrimin e tij si person fizik, veprimtari avokatore. Gjithë dokumentacioni që ka paraqitur tregon se ai ka ushtruar aktivitetin e avokatit që nga muaji mars 1993 e në vazhdim, pa ndërprerje dhe është pajisur me NIPT K***E (fillimisht bizneset janë pajisur me kod fiskal dhe më pas me NIPT).

42. Subjekti ka pretenduar se Komisioni nuk i është referuar asnjë rasti të ngjashëm lidhur me marzhin e fitimi 26%. Ai ka përmendur disa vendime të Komisionit ku janë marrë marzhe fitimi më të larta. Më konkretisht, vendimi nr. 339/2021 i subjektit E.H, vendimi nr. 367/2021 i subjektit B.M, vendimi nr. 479/2021 i subjektit A.D dhe vendimi nr. 199/2019 i subjektit N. T. Duke iu referuar këtyre vendimeve subjekti pretendon se marzhi i fitimit duhet të ishte të paktën 80%. Subjekti vijon më tej duke pretenduar një marzh fitimi prej 93.64% sipas aktit të ekspertimit të z. A.M. Subjekti përmend edhe dy vendime të Kolegjit, që kanë lidhje me subjektin N.T, nr. 33/2021 dhe subjektin H.K, nr. 6/2022.

43. Në lidhje me të ardhurat për periudhën 1993 – 2000, subjekti pretendon se referuar vendimeve gjyqësore, nxjerrë nga arkiva e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, i ndodhur para faktit të mungesës së fitimit për ushtrimin e profesionit të avokatit, ka bërë një përlllogaritje për vlerën e përfaqësimeve në gjykatën e shkallës së parë, në gjykatat e apelit, si dhe në Gjykatën e Lartë për periudhën 1993 – 1997, 2000 dhe 2002. Në këtë mënyrë ai ka shteruar të gjitha mundësitë dhe mjetet juridike efektive, pasi organet tatimore nuk kanë dokumente në arkivat e tyre për veprimtarinë private të avokatit të ushtruar prej tij. Lidhur me shpenzimet, ka sqaruar se përfshihej vlera e tatimit të paguar për çdo vit, taksat bashkiake, sigurimet shoqërore dhe shpenzimet të tjera, të cilat ishin të papërfillshme, pasi avokati ofron shërbim dhe nuk ka shpenzim. Ka sqaruar se nuk ka pasur pagesë për qira zyre, pasi aktivitetin e ushtronte në një garazh metalik, foto të të cilit i ka vendosur në dispozicion.

Gjithashtu, për të vërtetuar se shpenzimet e tjera ishin minimale, referuar dokumenteve që dispononte, për periudhën 2002 – 2007, bashkëlidhur ka vënë në dispozicion mandatpagesat për taksë pastrimi, taksë tabele etj.

¹¹ Për më shumë referohuni në prapësimet dhe provat e depozituara nga subjekti pas dërgimit të rezultateve të hetimit, si dhe gjatë seancës dëgjimore.

44. Subjekti pretendon se të ardhurat e tij për periudhën 2001 – 2007 janë në shumën 20,132,600 lekë, ndërsa për të gjithë periudhën pretendon të ardhura në total në vlerën 39,605,990 lekë.

Subjekti ka depozituar:

i. Raport ekspertim kontabël dhe raport shtesë ekspertimi kontabël

Në lidhje me këtë raport, Komisioni vlerëson se ai nuk mund të merret në konsideratë pasi nuk është kryer sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, duke mos u bazuar në deklaratimet e subjektit në deklaratat periodike, por duke mbartur për çdo vit mundësinë e kursimeve, pavarësisht se subjekti nuk ka rezultuar të ketë deklaruar kursime *cash*. Në këtë raport janë përfshirë të ardhurat e prindërve të subjektit dhe nënës së bashkëshortes të tij, pavarësisht faktit se këto nuk rezultojnë të deklaruara nga subjekti as në deklaratat periodike, por as në deklaratën *Vetting*. Vetë subjekti në përgjigje të pyetësorit të datës 26.1.2023 ka sqaruar: “Unë nuk kam jetuar në një banesë me nënën time. Rreth muajit tetor 2009 shëndeti i nënës sime u përkeqësua dhe nga të katër fëmijët e saj vetëm unë jetoja në Vlorë (motra e madhe në Greqi, vëllai në Itali, motra e vogël në Tiranë). Nëna kishte, ndër të tjera, edhe një depozitë në “Raiffeisen Bank”, në shumën rreth 1,200,000 lekë, që ishin kursimet e saj nga pensioni në Shqipëri dhe ai që merrte në shtetin grek. Për shkak të moshës dhe shëndetit të saj në përkeqësim, nëna më kërkoi që të përfshihesha edhe unë në këtë depozitë, si firmë e parë, për të bërë tërheqjen e parave, të cilat do të nevojiteshin për të kryer shërbimet ndaj saj”. Pra, nga ana e subjektit është konfirmuar fakti që ai nuk ka përfituar të ardhura nga nëna e tij. Për më tepër, eksperti ka përfshirë të ardhurat e prindërve, por nuk ka përfshirë shpenzimet e tyre jetike, si dhe gjendjet e llogarive bankare. Gjithashtu, të ardhurat nga avokatia janë marrë pa u bazuar në dokumentacion justifikues ligjor.

- ii. Kthim përgjigje nr. *** prot., datë 12.4.2023, e “Raiffeisen Bank”, në të cilën pasqyrohen depozita të subjektit dhe bashkëshortes së tij për periudhën 1996 e në vijim.
- iii. Shkresë nr. *** prot., datë 5.4.2023, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, në lidhje me vendimet e dhëna në vitin 2002, ku si përfaqësues i palës ka qenë subjekti i rivlerësimit.
- iv. Shkresë nr. *** prot., datë 5.4.2023, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, në lidhje me vendimet e dhëna në vitet 1993 – 2000, ku si përfaqësues i palës ka qenë subjekti i rivlerësimit.
- v. Formular i deklaratimit të pagesës së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, dhjetor 2006.
- vi. Vërtetim nr. *** prot., datë 3.4.2023, i Drejtorisë Rajonale Vlorë.
- vii. Libreze pune.
- viii. Kthim përgjigje nr. *** prot., datë 2.12.2009, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.
- ix. Mandatarkëtim nr. ***.

45. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti në lidhje me të ardhurat e tij nga avokatia, konstaton se ato janë në nivel deklarativ dhe të pashoqëruara me dokumentacion provues për sa i përket sasisë së të ardhurave të përfituara në të gjitha vitet e ushtrimit të veprimtarisë së tij si avokat. Është e vërtetë që provohet që nga ana e subjektit është ushtruar profesioni i avokatit, si dhe pagesave e detyrimeve tatimore pas vitit 1998, por ndërkohë për periudhën 1993 – 1998 nuk disponohet asnjë e dhënë për pagimin e detyrimeve tatimore, por edhe për xhiron e realizuar nga subjekti. Gjithashtu, mungesë të dhënash në lidhje me xhiron e realizuar ka edhe për vitet 1998 – 2000 dhe vitin 2002. Mungesa e këtyre të dhënave e bën të pamundur për Komisionin kryerjen e një analize të plotë për të ardhurat e përfituara nga subjekti në këtë periudhë. Në këto kushte, Komisioni nuk mund të marrë në konsideratë pretendimet e subjektit për sa i përket marzhit të fitimit në vlerën 80% apo në vlerën 93.64%, sikundër pretendohet nga subjekti. Në lidhje me marzhin e fitimit të pretenduar

nga subjekti në vlerën 93.64%, ai nuk është i mbështetur në asnjë dokumentacion dhe mbetet në nivel deklarativ, për rrjedhojë nuk do të pranohet nga Komisioni.

Përpos këtij fakti, për sa kohë nuk është depozituar dokumentacion provues për pagesën e detyrimeve tatimore për vitet 1993 dhe 1998, rezulton se nuk përmbushen standardet e nenit D të Aneksit të Kushtetutës, për rrjedhojë, edhe sikur subjekti të kishte krijuar të ardhura, ato nuk mund të konsiderohen si të ardhura të ligjshme.

46. Komisioni shqyrtoi edhe pretendimin e subjektit për rastet e ngjashme dhe duke marrë në konsideratë jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit, të shprehur së fundmi edhe në vendimin nr. 33/2022¹², vlerëson se pretendimi i subjektit të rivlerësimit se në raste të tjera Komisioni, ndryshe nga çka vlerësuar në çështjen objekt gjykimi, ka marrë në konsideratë në analizë marzhe fitimi më të larta, nuk qëndron, pasi çdo vendimmarrje e Komisionit merret në mënyrë individuale, bazuar në specifikat e situatës faktike dhe në zbatimin e duhur të ligjit për situatën konkrete faktike dhe jo nga mënyra se si mund të jenë rivlerësuar subjektet e tjera të rivlerësimit. Për rrjedhojë të sa më sipër, vendimet e Komisionit, të cilat përmenden nga subjekti i rivlerësimit, nuk përbëjnë provë të fakteve relevante që lidhen me deklarimin e të ardhurave nga ana e subjektit dhe, si të tilla, çmohen pa efekt në zgjidhjen e kësaj çështjeje.

47. Në përfundim në lidhje me të ardhurat nga avokatia, Komisioni vlerëson se subjekti nuk arriti të provojë shumën e deklaruar prej tij në deklaratën *Vetting* prej 42,100,000 lekësh.

Për sa më sipër, Komisioni vlerëson se të ardhurat e krijuara nga subjekti i rivlerësimit gjatë ushtrimit të aktivitetit të avokatisë, të cilat përmbushin standardet e ligjshmërisë, sipas parashikimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe dispozitave të ligjit nr. 84/2016, nuk përputhen në vlerë me të ardhurat e deklaruara nga subjekti në deklaratën e pasurisë *Vetting*. Deklarimi i subjektit në këtë rast vlerësohet nga trupi gjykues si deklarim i pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin, referuar parashikimit të nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016¹³.

48. Për periudhën 1995 e në vijim, Komisioni ka pranuar gjendjet e depozitave të subjektit dhe bashkëshortes së tij, vërtetuar përmes shkresës kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 12.4.2023, të “Raiffeisen Bank” së bashku me interesat bankarë, duke i përfshirë ato në analizë financiare.

49. Pavarësisht qëndrimit të mësipërm, Komisioni, për të qenë sa më ezaurues në lidhje me pretendimet e subjektit, ka kryer një analizë financiare hipotetike, duke marrë në konsideratë të ardhurat e pretenduara nga subjekti nga avokatia me një marzh fitimi prej 80% (i cili është marzhi më i madh i fitimit i pranuar ndonjëherë nga Komisioni) për ato vite ku nga DRT-ja Vlorë nuk është deklaruar fitimi i subjektit. Ndërsa për vitet 1993 – 1997 janë përfshirë të ardhurat në shumën 11,272,000 lekë, shumë e cila është në nivel deklarativ, por që nuk mbështet me të dhënat e pagesave të kohës. Për analogji në rastin e vendimit nr. ***/2021¹⁴, tarifa për një çështje gjyqësore është marrë 500 lekë.

Në total, të ardhurat nga avokatia për subjektin për periudhën 1993 – 2010 janë marrë në shumën 34,474,000 lekë. Edhe në këtë rast subjekti për periudhën para fillimit të detyrës rezulton me një rezultat negativ në shumën 15,259,318 lekë.

50. Komisioni ka kryer një analizë financiare në lidhje me blerjen e pasurisë apartament dhe garazh¹⁵, duke përfshirë:

- i. të ardhura e subjektit nga aktiviteti “Avokati”, bazuar në marzhin e fitimit 26%;
- ii. të ardhura e bashkëshortes së subjektit nga paga;
- iii. të ardhura nga interesat bankarë;

¹² Vendimet nr. 35/2022 dhe nr. 38/2022.

¹³ I njëjti qëndrim është mbajtur edhe nga Kolegji i Posaçëm i Apelit në vendimin nr. 20, datë 14.7.2021, paragrafi 49.

¹⁴ Shihni paragrafin 32.1.

¹⁵ Për më shumë detaje shihni tabelën nr. 1 të rezultateve të hetimit.

- iv. shpenzimet jetike janë përlogaritur për vitet 1992 – 2000 në masën 66% të të ardhurave dhe në vijim sipas shkresës ref. nr. *** prot., datë 29.1.2019, të ILDKPKI-së. Shpenzimet jetike të vajzës së subjektit për ditë qëndrimi në Mbretërinë e Bashkuar janë ngarkuar në zërin “TIMS F.Ç” dhe ditët e qëndrimit në Shqipëri janë ngarkuar në zërin “shpenzime jetike të përlogaritura për 3 persona”;
- v. shpenzimet e shkollimit të vajzës në Mbretërinë e Bashkuar i janë referuar pagesave të kryera përmes transfertave bankare.

Nga analiza financiare rezultoi se subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme në shumën kumulative 44,072,088.89 lekë për blerjen e apartamentit dhe garazhit, ndërsa për vitet përkatëse kur janë kryer pagesat në shumën 2,797,310.67 lekë dhe në shumën 4,590,090.75 lekë.

51. Pas kalimit të barrës së provës¹⁶ subjekti ka pretenduar se të ardhurat e tij nga avokatia duhej të llogariteshin me marzhin e fitimit të pretenduar prej tij. Gjithashtu, ai ka pretenduar edhe të ardhurat të tjera të bashkëshortes për vitet 1992 – 1996. Subjekti deklaroi se ai dhe bashkëshortja e tij kanë punuar rregullisht, i kanë paguar shtetit tatime dhe kursimet i depozitonin në banka. Më tej ai ka kërkuar që analiza të bazohet në aktin e ekspertit kontabël A. M.

52. Subjekti ka pretenduar se në analizën financiare Komisioni ka përfshirë edhe shpenzimet jetike të vajzës së tij për ditë qëndrimi në Mbretërinë e Bashkuar, të ngarkuara në zërin “TIMS F.Ç” dhe ditët e qëndrimit në Shqipëri janë ngarkuar në zërin “shpenzime jetike të përlogaritura për 3 persona”. Shpenzimet e shkollimit të vajzës në Mbretërinë e Bashkuar u janë referuar pagesave të kryera përmes transfertave bankare. Ai kërkon që në analizë të mos përfshihen shpenzimet jetike të vajzës së tij, duke pretenduar se pagesat e kryera në lidhje me shkollimin e vajzës përfshijnë edhe shpenzimet e akomodimit dhe të jetesës, pasi sipas subjektit vajza e tij është akomoduar brenda rezidencës studentore. Për çdo vit pagesat bëheshin sipas tarifave të përcaktuara nga universiteti, të detajuara për shkollim dhe akomodim. Subjekti pretendon se llogaria studentore në Ll.B është mbyllur dhe se nuk merr dot informacion.

53. Subjekti deklaroi se me mbarimin e shkollës në vitin 2010, vajza e tij zgjodhi të qëndronte në Mbretërinë e Bashkuar, nisur nga fakti se ajo kishte njohur një djalë me shtetësi angleze dhe me mbarimin e shkollës filloi bashkëjetesën me të. Kjo lidhje vazhdoi edhe pasi vajza e tyre u kthye në Shqipëri për 3 vjet dhe përsëri në vitin 2015, kur iku përfundimisht në Mbretërinë e Bashkuar, vazhdoi bashkëjetesën me këtë djalë. Subjekti pretendon se shpenzimet e jetesës së vajzës së tij janë mbuluar nga ky shtetas derisa ajo filloi punë.

Subjekti kërkon që në analizë financiare të zbriten shumat që janë konsideruar, konkretisht për vitin 2010 shuma 1,270,111.50 lekë dhe për vitin 2011 shuma 1,244,700 lekë.

54. Subjekti pretendon se prindërit e tij dhe nëna e bashkëshortes kanë pasur të ardhura dhe kërkon që ato të përfshihen në analizë financiare. Ai ka depozituar edhe deklaratën noteriale nr. ** rep., nr. ** kol., datë 13.1.2019, të notere S.S. H, ku vjehrra e tij deklaroi: “...kam nënshkruar pranë kësaj zyre noteriale sot, në datën 13.1.2019, një deklaratë noteriale të regjistruar me nr. **rep., nr. ** kol., sipas së cilës unë kam deklaruar të ardhurat e mia financiare për periudhën 1998 – 2012. Unë, E.M, deklaroj se këto të ardhura, të cilat për moshën time ishin mëse të mjaftueshme e më ngeleshin, pasi unë qëndroja te vajza ime, deklaroj se pasi kam pasur shumë afrimitet e dashuri për mbesën time F.Ç, të cilën e kam rritur dhe për këtë e kam ndihmuar të përballoj shpenzimet për qëndrimin e saj në Angli në vitet 2010 – 2011, në shumën që ajo më kërkonte dhe këtë e bëja thjesht për shkak të sjelljes së saj dashamirëse ndaj meje”.

¹⁶ Për më shumë referohuni në prapësimet dhe provat e depozituara nga subjekti pas dërgimit të rezultateve të hetimit, si dhe gjatë seancës dëgjimore.

Subjekti ka depozituar:

- i. dokumentacion për periudhën 2002 – 2008, për pensionin e përfituar në Greqi nga babai i tij A.C;
- ii. dokumentacion për periudhën 2002 – 2010, për pensionin e përfituar në Greqi nga nëna e tij P.Ç;
- iii. *email* në gjuhën angleze nga [s****k](#);
- iv. një tabelë në gjuhën angleze format *Excel*, i pa shoqëruar me vulë apo firmë se kush është autoriteti që e ka lëshuar dhe për çfarë është lëshuar. Kjo tabelë ka edhe versionin e përkthyer. Në këtë version është shtuar edhe një kolonë me emërtim “tipi i kostos”, e cila nuk gjendet në versionin anglez;
- v. TIMS të shtetasit P.J, nxjerrë nga sistemi *online* me emër përdoruesi P, koha e hyrjes 13.4.2023, 10:49 – në lidhje me këtë dokument, i cili rezulton të jetë administruar pa dijeni e shtetasit P.J, i cili nuk është person i lidhur apo tjetër i lidhur me subjektin, Komisioni me qëllim mbrojtjen e të dhënave të tij personale vlerëson të mos e marrë në konsideratë;
- vi. foto familjare të tij, bashkëshortes, vajzës dhe një shtetasi tjetër;
- vii. vërtetim nr. *** prot., datë 3.4.2023, i Drejtorisë Rajonale Vlorë.

55. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti, konstaton se nga ana e tij nuk është depozituar asnjë provë për të mbështetur pretendimet e tij në lidhje me shpenzimet e akomodimit dhe të jetesës së vajzës gjatë kohës së studimit. Tabela e depozituar nga subjekti nuk është në formën e parashikuar nga ligji, për më tepër në këtë tabelë nuk specifikohen se për çfarë janë kryer pagesat.

Komisioni, sikundër do të trajtohet në vijim, i ka kërkuar subjektit, duke i kaluar edhe barrën e provës, të paraqesë të gjithë dokumentacionin e shkollimit të vajzës së tij nga universiteti ku ka studiuar, por nga ana e subjektit është refuzuar si gjatë hetimit, ashtu edhe pas dërgimit të rezultateve të hetimit, të depozitohet një dokumentacion i tillë, përfshirë edhe nxjerrjet e llogarive bankare. Për sa kohë nga ana e subjektit nuk është depozituar dokumentacion provues konform parashikimeve ligjore, Komisioni nuk do t’i marrë në konsideratë pretendimet e tij.

56. Në lidhje me pretendimin e subjektit se kanë shërbyer si burim për shkollimin e vajzës dhe të ardhurat e prindërve të tij dhe nënës së bashkëshortes, Komisioni vlerëson se edhe ky pretendim nuk do të pranohet. Subjekti nuk rezulton të ketë deklaruar në deklaratën *Vetting*, por as në pyetësorin standard, dhurime të kryera nga prindërit e tij dhe të bashkëshortes. Gjithashtu, tek zëri “të ardhura” në deklaratën *Vetting* nuk rezulton të jenë deklaruar të ardhura të përfituar nga këta të fundit. Subjekti ka deklaruar si burim të ardhurat e nënës së bashkëshortes së tij vetëm në depozitën e krijuar në “Tirana Bank”, e cila do të trajtohet në vijim.

57. Në lidhje me deklaratën noteriale nr. *** , datë 13.1.2019, para noterit publik S.S.H, Komisioni konstaton se nga hetimi i tij nuk ka rezultuar një deklaratë e tillë noteriale. Më konkretisht, nga shkresa e Ministrisë së Drejtësisë nr. *** prot., datë 8.2.2021, nuk rezulton që në regjistrin noterial shqiptar të jetë regjistruar një deklaratë e tillë noteriale. Veprimi i fundit noterial i kryer nga znj. E.M është deklarata noteriale nr. *** , datë 13.1.2019.

58. Komisioni vlerëson se kjo deklaratë nuk mund të marrë vlerë në këtë proces sepse znj. Mëhilli në të njëjtën datë, për të njëjtin objekt, pra përdorimin e të ardhurave të saj, ka nënshkruar një deklaratë tjetër noteriale nr. *** , e cila rezulton të jetë në Regjistrin Noterial. Në këtë deklaratë ajo pranon faktin se të ardhurat e saj janë administruar nga vajza e saj M.Ç dhe se një pjesë e këtyre të ardhurave janë depozituar në “Tirana Bank” dhe më pas janë përdorur nga mbesa e saj për blerjen e shtëpisë në Mbretërinë e Bashkuar. Në lidhje me këtë deklaratë, znj. M nuk kishte asnjë pengese të deklaronte edhe mbulimin e shpenzimeve të jetesës së vajzës së subjektit në Mbretërinë e Bashkuar për vitet 2010 – 2011. Komisioni

vlerëson se përmbajtja e kësaj deklarate, që as nuk gjendet në Regjistrin Noterial Shqiptar, ka për qëllim rregullimin e analizës financiare të subjektit të rivlerësimit. Kjo deklaratë duket se është bërë vetëm pas kalimit të barrës së provës me qëllim arritjen e një rezultati të favorshëm të subjektit. Ky veprim i subjektit do të merret në konsideratë nga Komisioni në vlerësimin tërësor të procedurave.

Në këto kushte, Komisioni nuk do të përfshijë në analizë financiare të ardhurat e znj. E.M për sa i përket shpenzimeve jetike të vajzës së subjektit.

59. Në lidhje me pretendimet e subjektit për të ardhurat nga avokatia, Komisioni është shprehur në pikën 47 të këtij vendimi.

60. Në përfundim, subjekti rezulton me mungesë burimesh të ligjshme në shumën kumulative - 41,371,549.60 lekë për blerjen e apartamentit dhe garazhit, ndërsa për vitet përkatëse kur janë kryer pagesat në shumat 2,797,310.67 lekë dhe 4,079,450.75 lekë.

Si rrjedhojë, subjekti ka kryer deklaram të pasaktë, të paplotë dhe të pamjaftueshëm për këtë pasuri, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe shkronjave “a” dhe “b” të nenit 33/5 të ligjit nr. 84/2016.

61. Komisioni, për të qenë sa më ezaures në lidhje me pretendimet e subjektit, ka kryer një analizë financiare hipotetike, duke përfshirë të ardhurat nga avokatia si në pikën 49 të këtij vendimi, duke hequr shpenzimet jetike të vajzës së tij në Mbretërinë e Bashkuar, të emërtuara si “shpenzime TIMS” në analizë financiare. Edhe në këtë rast subjekti rezulton me një rezultat kumulativ negativ në shumën 13,901,195 lekë dhe për vitet kur janë kryer pagesat me një rezultat total negativ në shumën 5,562,605 lekë.

62. Depozitë¹⁷ në “Intesa Sanpaolo Bank”, me datë krijimi 16.10.2003, në shumën 25,350 USD. Interesat bankarë deri në datën 20.10.2016 janë 4,999 USD. Vlera: 30,348 USD. Pjesa takuese: 50%.

Burimi sipas deklaratës Vetting: të ardhurat nga puna si avokat në vitet 1993 – 2010, të ardhurat e bashkëshortes nga paga si punonjëse e “P.D” sh.a., Vlorë, në vitet 1987 – 2011, si dhe interesat bankarë në vite.

Hetimi¹⁸ dhe analiza financiare-juridike e kryer nga Komisioni

63. “Intesa Sanpaolo Bank” informon se subjekti dhe bashkëshortja e tij kanë/kanë pasur llogaritë bankare si vijon:

i. Llogari në paund (GBP), me gjendje në vitin 2016 në shumën 26 GBP

Nga nxjerrja e llogarisë rezulton se:

- subjekti në datën 20.7.2007 ka depozituar shumën 4,704 GBP;
- në datën 19.9.2007 ka tërhequr shumën 4,500 GBP;
- në datën 23.3.2018 subjekti ka tërhequr shumën e mbetur prej 26 GBP, duke e mbyllur këtë llogari.

Në lidhje me këtë llogari, e cila rezulton se nuk është deklaruar në deklaratën Vetting, Komisioni i ka kërkuar shpjegime subjektit.

64. Subjekti, në lidhje me këtë konstatim, shpjegoi¹⁹ se përpara se të dorëzonte deklaratën Vetting ai dhe bashkëshortja e tij kanë kërkuar informacion për të gjitha llogaritë bankare nga

¹⁷ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës Vetting: (i) shkresë datë 20.10.2017, të ISP Bank; (ii) kontratë depozite e datës 16.10.2003, për shumën 25,350 USD.

¹⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 28.1.2021, drejtuar bankave dhe institucioneve financiare; kthim përgjigje nr. *** prot., datë 16.2.2021, e ISP Bank.

¹⁹ Për më shumë referohuni në prapësimet dhe provat e depozituara nga subjekti pas dërgimit të rezultateve të hetimit, si dhe gjatë seancës dëgjimore.

bankat përkatëse. Për llogarinë e sipërcituar subjekti deklaroi se nuk i është dhënë asnjë informacion nga e "Intesa Sanpaolo Bank". Nga nxjerrja e llogarisë që banka ka vënë në dispozicion vihet re që veprimet janë bërë nga ana e tyre në vitin 2007 dhe më pas nuk ka asnjë transaksion me këtë llogari, kohë kur ai nuk ka qenë subjekt deklarimi. Në kujtesën e tij kjo llogari është konsideruar e mbyllur. Kur është paraqitur tek "Intesa Sanpaolo Bank" në datën 23.3.2018, punonjësi i bankës e ka informuar se kishin edhe një llogari të hershme, e mbetur në vlerën 26 GBP. Nisur edhe nga shuma minimaliste që kishte mbetur, e mbyllën këtë llogari, pasi shuma e mbetur 26 GBP do të vazhdonte të pakësohej për mirëmbajtje llogarie nga banka derisa të bëhej zero. Subjekti ka cituar edhe një vendim të Komisioni, me nr. 46/2018.

65. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerëson se ato nuk janë të mbështetura në prova, për më tepër subjekti ka kryer veprime në lidhje me këtë llogari bankare duke e mbyllur atë në vitin 2018. Për rrjedhojë, subjekti ka kryer deklaram të pasaktë në deklaratën *Vetting*, në kuptim të germës "a" të nenit 33/5 të ligjit nr. 84/2016. Ky deklaram i subjektit nuk përbën shkak autonom për marrjen e masës disiplinore, por do të merret në konsideratë në vlerësimin tërësor të kriterit të pasurisë.

ii. Llogari në lekë e mbyllur në datën 29.12.2006

Nga përmbledhësja e dërguar nga "Intesa Sanpaolo Bank" rezultoi se subjekti, në datën 31.12.2003, ka pasur gjendje në këto llogari shumën 2,924,086 lekë, e cila në datën 29.12.2006 ka qenë në vlerën 5,930,392 lekë.

iii. Llogari në dollarë (USD) me gjendje në vitin 2016, në shumën 30,348.52 USD

Nga përmbledhësja e dërguar nga "Intesa Sanpaolo Bank" rezultoi se subjekti, në datën 31.12.2003, ka pasur gjendje në këtë llogari shumën 25,350 USD.

Nga nxjerrja e llogarisë bankare së subjektit rezultoi se depozita e mësipërme ka vijuar deri në vitin 2019, me gjendje në shumën 30,502 USD.

Në datën 23.10.2019 shuma 30,350 USD transferohet në llogarinë e vajzës së subjektit në Mbretërinë e Bashkuar.

Në lidhje me këtë depozitë rezultoi se nga analiza financiare²⁰, në momentin e krijimit të saj, subjekti nuk ka pasur të ardhurat të mjaftueshme të ligjshme për krijimin e kësaj depozite në shumën 4,462,397.50 lekë. Në lidhje me burimin e llogarisë, subjekti ka kryer deklaram të pasaktë në deklaratën *Vetting*, pasi nuk mund të kenë shërbyer si burim të ardhurat e tij dhe të bashkëshortes deri në vitin 2011.

66. Pas kalimit të barrës së provës²¹ subjekti pretendoi se përlllogaritjet mund të kryhen vetëm në mënyrë kumulative për shkak se ai nuk ka qenë subjekt deklarues. Edhe praktika e organeve të *Vetting*-ut ka ecur në këtë mënyrë.

67. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerëson se ato nuk janë bindëse, si dhe nuk mbështeten në prova. Analiza financiare është kryer kumulative, por rezultatit negativ të kësaj analize nuk i është shtuar rezultati negativ kumulativ i viteve të mëparshme, pasi në këtë rast ky rezultat do të ishte në vlerën negative prej 27,283,756.89 lekësh.

68. Në përfundim, subjekti rezultoi me mungesë burimesh të ligjshme për krijimin e kësaj depozite në shumën 3,327,875.03 lekë. Gjithashtu, subjekti ka kryer deklaram të pasaktë në lidhje me burimin e kësaj pasurie, pasi të ardhurat e tij të krijuara pas vitit 2003 nuk mund të shërbenin për krijimin e kësaj depozite.

²⁰ Shihni tabelën nr. 2 të rezultateve të hetimit.

²¹ Për më shumë referohuni në prapësimet dhe provat e depozituara nga subjekti pas dërgimit të rezultateve të hetimit, si dhe gjatë seancës dëgjimore.

Si rrjedhë, subjekti ka kryer deklaram të pasaktë, të paplotë dhe të pamjaftueshëm për këtë pasuri, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe shkronjave “a” dhe “b” të nenit 33/5 të ligjit nr. 84/2016.

69. Komisioni, për të qenë sa më ezaures, ka kryer një analizë financiare hipotetike, duke përfshirë të ardhurat nga avokatia si në pikën 49 të këtij vendimi. Sërish subjekti rezultoi me një rezultat negativ në vitin e krijimit në shumën 1,397,211 lekë.

70. Depozitë²² në E.B, Greqi. Vlera: 9,030 euro. Pjesa takuese: 100%.

Burimi sipas deklaratës Vetting: të ardhurat nga puna si avokat në vitet 1993 – 2010, të ardhurat e bashkëshortes nga paga si punonjëse e “P.D” sh.a., Vlorë, në vitet 1987 – 2011, si dhe interesat bankarë në vite.

Hetimi dhe analiza financiare-juridike e kryer nga Komisioni

71. Së bashku me deklaratën Vetting subjekti ka dorëzuar një dokument në gjuhën greke, nga ku rezultoi se ai ka një depozitë me bashkëshorten e tij, e cila është hapur në datën 30.12.2005, në vlerën 28,222 euro.

Subjekti, në përgjigje të pyetësorit të datës 26.1.2023, ka deklaruar: *“Periudhën e saktë se kur është hapur kjo depozitë nuk e përcaktoj dot pasi ka kaluar një kohë shumë e gjatë. Depozita tek E.B, Greqi, sipas librezës që ne jemi pajisur nga kjo bankë, në faqen e dytë ka datë fillimi datën 30.12.2005, shuma 28,222.48 euro. Veprimi i fundit i kryer në këtë bankë është data 22.6.2015. Arsyeja për hapjen e kësaj llogarie në Greqi kanë qenë ngjarjet e vitit 1997, ku ne që banonim në qytetin e Vlorës i përjetuam në mënyrën më të keqe.*

U detyruam të shkonim në Greqi dhe u strehuam tek të afërmit tanë që jetonin e punonin atje. Kur kemi mbërritur atje nuk kishim mjete financiare, pasi bankat në Shqipëri ishin mbyllur dhe nuk kishim mundësi të tërhiqnim vlera monetare për të marrë me vete për konsum familjar.

Ka qenë kjo një nga arsyet që unë kam hapur një depozitë bankare në Greqi, për ta pasur si mbështetje në të ardhmen. Hapjen e kësaj depozite e favorizoi edhe fakti që E.B nuk na solli asnjë pengesë ligjore për hapje depozite”.

72. Subjekti ka depozituar librezë kursimesh të Bankës Kombëtare të Greqisë, nga e cila rezultoi se:

- llogaria ka pasur gjendje në datën 30.12.2005, në shumën 28,222 euro;
- në datën 21.9.2007 rezultoi një tërheqje në shumën 8,522 euro;
- në datat 13.3.2015 dhe 22.6.2015 rezultojnë dy tërheqje nga 5,000 euro, në total 10,000 euro. Gjendja në datën 22.6.2015 ka qenë 9,030 euro.

73. Komisioni ka kryer një analizë financiare në momentin e krijimit të kësaj depozite, në datën 30.12.2005²³, tek e cila janë përfshirë:

- të ardhurat e subjektit nga aktiviteti “Avokati”, bazuar në marzhin e fitimit 26%;
- të ardhurat e bashkëshortes së subjektit nga paga;
- të ardhurat nga interesat bankarë;
- shpenzimet jetike të përlllogaritura për vitet 1992 – 2000 në masën 66% të të ardhurave dhe në vijim sipas shkresës ref. nr. *** prot., datë 29.1.2019, të ILDKPKI-së, ndërsa shpenzimet jetike të vajzës së subjektit për ditë qëndrimi në Mbretërinë e Bashkuar janë ngarkuar në zërin “TIMS F.Ç” dhe ditët e qëndrimit në Shqipëri janë ngarkuar në zërin “shpenzime jetike të përlllogaritura për 3 persona”;

²² Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratën librezë depozite e E.B, Greqi.

²³ Shihni tabelën nr. 3 të rezultateve të hetimit.

- shpenzimet e mobilimit janë pasqyruar sipas deklaramit të subjektit në pyetësorin standard, si dhe në deklaratën noteriale të shtetasit A.C, paraqitur prej subjektit në pyetësorin nr. 1.

74. Nga analiza financiare rezulton se subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për krijimin e kësaj llogarie në vitin 2005, në shumën 6,318,928.81 lekë. Në lidhje me burimin e llogarisë së krijuar në vitin 2005, subjekti ka kryer deklaramit të pasaktë në deklaratën *Vetting*, pasi nuk mund të kenë shërbyer si burim të ardhurat e tij dhe të bashkëshortes deri në vitin 2011.

75. Pas kalimit të barrës së provës²⁴ subjekti pretendoi se përlllogaritjet mund të kryhen vetëm në mënyrë kumulative për shkak se ai nuk ka qenë subjekt deklarues. Ashtu siç ka shpjeguar gjatë hetimit administrativ, periudhën e saktë se kur është hapur kjo depozitë nuk e përcakton dot, pasi ka kaluar një kohë shumë e gjatë. Depozita tek E.B, Greqi, sipas librezës në faqen e dytë, ka datë fillimi 30.12.2005, në shumën 28,222.48 euro. Në deklaratën e dorëzuar para fillimit të detyrës si gjyqtar në vitin 2010 është deklaruar gjendja në momentin e deklaramit, 20,000 euro. Veprimi i fundit i kryer në këtë bankë është data 22.6.2015. Analiza financiare për depozitën 28,222 euro, në datën 30.12.2005, duhet të përlllogaritet kumulative së bashku me pasuritë e tjera të krijuara deri në vitin 2010. Në analizën financiare të përgatitur nga eksperti A. M rezulton se jo vetëm në fund të vitit 2007 apo në vitin 2010 balanca për krijimin e këtyre pasurive gjatë kësaj periudhe rezulton pozitive, por edhe balancat kumulative në çdo vit rezultojnë pozitive, pra s'ka asnjë vit që balanca kumulative të rezultojë negative.

76. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerëson se ato nuk janë bindëse, si dhe nuk mbështeten në prova. Analiza financiare është kryer kumulative, por rezultati negativ i kësaj analize nuk i është shtuar rezultatit negativ kumulativ të viteve të mëparshme, pasi në këtë rast ky rezultat do të ishte në vlerën negative prej 29,794,359.38 lekësh.

77. Në përfundim, subjekti rezulton me mungesë burimesh të ligjshme për krijimin e kësaj depozitë në shumën 6,318,928.81 lekë. Gjithashtu, subjekti ka kryer deklaramit të pasaktë në lidhje me burimin e kësaj pasurie, pasi të ardhurat e tij të krijuara pas vitit 2005 nuk mund të shërbenin për krijimin e kësaj depozite.

Si rrjedhojë, subjekti ka kryer deklaramit të pasaktë, të paplotë dhe të pamjaftueshëm për këtë pasuri, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe shkronjave “a” dhe “b” të nenit 33/5 të ligjit nr. 84/2016.

78. Komisioni, për të qenë sa më ezaures, ka kryer një analizë financiare hipotetike, duke përfshirë të ardhurat nga avokatia si në pikën 49 të këtij vendimi. Sërish subjekti rezulton me një rezultat negativ në shumën 4,158,928 lekë dhe kumulativ deri në vitin 2005 në shumën 6,627,814 lekë.

79. Depozitë²⁵ në Raiffeisen Invest, krijuar nga depozita me datë krijimi 3.4.2008, shuma 1,555,700 lekë, si dhe interesat e saj. Në datën 9.12.2011 shtuar 441,000 lekë (ekzekutim vendimi gjyqësor). Vlera: 2,871,088 lekë. Pjesa takuese: 100%.

Burimi sipas deklaratës *Vetting*: të ardhurat nga puna si avokat në vitet 1993 – 2010, të ardhurat e bashkëshortes nga paga si punonjëse e “P.D” sh.a., Vlorë, në vitet 1987 – 2011, interesat bankarë në vite, si dhe ekzekutim vendimi gjyqësor.

Hetimi²⁶ dhe analiza financiare-juridike e kryer nga Komisioni

²⁴ Për më shumë referohuni në prapësimet dhe provat e depozituara nga subjekti pas dërgimit të rezultateve të hetimit, si dhe gjatë seancës dëgjimore.

²⁵ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: (i) marrëveshje për depozitë me afat 12-mujor; (ii) nxjerrje llogarie e z. Petraq Çuri në “Raiffeisen Bank”; (iii) vërtetim nr. **, datë 12.1.2017, i studios përmbartimore “K”; (iv) vërtetim nr. ***, datë 6.1.2017, i Raiffeisen Invest.

²⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 28.1.2021, drejtuar bankave dhe institucioneve financiare; kthim përgjigje nr. *** prot., datë 15.2.2021, e “Raiffeisen Bank”; kthim përgjigje nr. *** prot., datë 9.2.2021, e Raiffeisen Invest; shkresë

80. Nga nxjerrja e llogarisë së subjektit të rivlerësimit në “Raiffeisen Bank” rezulton se subjekti ka çelur depozitë në shumën 1,555,700 lekë, në datën 3.4.2008.

Kjo depozitë e ka origjinën nga dy depozita të krijuara, përkatësisht në datën 1.11.2006 në shumën 600,000 lekë dhe në datën 5.1.2007 në shumën 900,000 lekë.

Komisioni ka kryer analizën financiare²⁷ në lidhje me këto dy depozita, përkatësisht në datën 1.11.2006 dhe në datën 5.1.2007. Në analizën financiare janë përfshirë:

- të ardhurat e subjektit nga aktiviteti “Avokati”, bazuar në marzhin e fitimit 26%;
- të ardhurat e bashkëshortes nga paga;
- të ardhurat nga interesat bankarë;
- shpenzimet jetike të përlllogaritura për vitet 1992 – 2000 në masën 66% të të ardhurave dhe në vijim sipas shkresës ref. nr. *** prot., datë 29.1.2019, të ILDKPKI-së, ndërsa shpenzimet jetike të vajzës së subjektit për ditë qëndrimi në Mbretërinë e Bashkuar janë ngarkuar në zërin “TIMS F.Ç” dhe ditët e qëndrimit në Shqipëri janë ngarkuar në zërin “shpenzime jetike të përlllogaritura për 3 persona”.

Nga analiza financiare rezulton se subjektit nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për krijimin e kësaj depozite në shumën 995,032.75 lekë. Në lidhje me burimin e llogarisë, subjekti ka kryer deklaram të pasaktë në deklaratën *Vetting*, pasi nuk mund të kenë shërbyer si burim të ardhurat e tij dhe të bashkëshortes deri në vitin 2011.

81. Pas kalimit të barrës së provës²⁸ subjekti pretendoi se në deklaratën *Vetting* ka sqaruar se në “Raiffeisen Bank”, në datën 3.4.2008, ka çelur depozitë në shumën 1,555,700 lekë. Kjo depozitë e ka origjinën nga dy depozita të krijuara, përkatësisht në datën 1.11.2006 në shumën 600,000 lekë dhe në datën 5.1.2007 në shumën 900,000 lekë. Në datën 9.12.2011, në këtë llogari u transferua shuma 441,000 lekë nga ekzekutimi i vendimit gjyqësor. Këto shuma, së bashku me interesat, u investuan tek Raiffeisen Invest, në datën 21.3.2014. Edhe analiza për depozitat në datat 1.11.2006 dhe 5.1.2007, të paraqitura në tabelën nr. 4 të relacionit të hetimit, nuk është e saktë, bazuar në përlllogaritje e kryera nga audituesi ligjor.

82. Komisioni konstaton se subjekti nuk ka depozituar asnjë dokumentacion provues në lidhje me sa i është kaluar barra e provës. Nga ana e tij sërish është ngritur pretendimi i llogaritjes në mënyrë kumulative, pretendim i cili është i pabazuar, pasi llogaritja e Komisionit është bërë në mënyrë kumulative për sa kohë subjekti nuk ka qenë subjekt deklarimi. Në fund të rezultateve të hetimit Komisioni i ka kaluar barrën e provës për një rezultat negativ kumulativ për kohën që ai nuk ka qenë në detyrë.

83. Në përfundim, subjekti rezulton me mungesë burimesh të ligjshme për krijimin e kësaj depozite, në shumën 995,032.75 lekë. Gjithashtu, subjekti ka kryer deklaram të pasaktë në lidhje me burimin e kësaj pasurie, pasi të ardhurat e tij të krijuara pas vitit 2007 nuk mund të shërbenin për krijimin e kësaj depozite.

Si rrjedhojë, subjekti ka kryer deklaram të pasaktë, të paplotë dhe të pamjaftueshëm për këtë pasuri, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe shkronjave “a” dhe “b” të nenit 33/5 të ligjit nr. 84/2016.

84. Komisioni, për të qenë sa më ezaures, ka kryer një analizë financiare hipotetike, duke përfshirë të ardhurat nga avokatia si në pikën 49 të këtij vendimi. Sërish subjekti rezulton me

nr. *** prot., datë 26.1.2013, drejtuar studios përmbarrimore gjyqësore “K”; kthim përgjigje nr. extra prot., datë 8.2.2023, e studios përmbarrimore.

²⁷ Shihni tabelën nr. 4 të rezultateve të hetimit.

²⁸ Për më shumë referohuni në prapësimet dhe provat e depozituara nga subjekti pas dërgimit të rezultateve të hetimit, si dhe gjatë seancës dëgjimore.

një rezultat negativ për vitin 2006 në shumën kumulative 8,622,613 lekë, ndërsa për vitin 2006 në shumën 1,994,798 lekë.

85. Në datën 9.12.2011, në llogarinë e tij në “Raiffeisen Bank”, subjektit i është transferuar shuma 441,000 lekë nga personi fizik “J.K”. Në lidhje me këtë shumë Komisioni nuk konstatoi problematika, duke e përfshirë në analizën financiare.

Komisioni mban në vëmendjen faktin që pjesë e shumës 441,000 lekë ka qenë edhe shuma 200,000 lekë, dhënë subjektit nga shoqëria “A” sh.p.k., e cila është përfaqësuar nga një avokat tjetër në çështjen gjyqësore objekt ekzekutimi. Kjo shoqëri në kërkesë shprehet se ajo e ka likuiduar avokatin e saj dhe shuma që i takon për shpenzimet gjyqësore t’i kalojë subjektit të rivlerësimit, i cili, duke qenë se ka qenë përfaqësues ligjor i znj. E.M në këtë gjykim, ka kryer pjesën më të madhe të mbrojtjes. Kjo shoqëri është e njëjta shoqëri me të cilën vajza dhe bashkëshortja e subjektit kanë lidhur kontrata shitblerjeje për disa nga pasuritë e tyre, të cilat do të trajtohen gjerësisht në vijim të këtij vendimi.

86. Llogari rrjedhëse²⁹ në BKT, me datë krijimi 25.2.2010, në shumën 800,000 lekë, kaluar depozitë në datën 10.10.2010, me interesat bankarë shuma 982,576 lekë. Pjesa takuese: 100%.

Burimi sipas deklaratës *Vetting*: të ardhurat nga puna si avokat në vitet 1993 – 2010, të ardhurat e bashkëshortes nga paga si punonjëse e “P.D” sh.a., Vlorë, në vitet 1987 – 2011, si dhe interesat bankarë në vite.

Hetimi³⁰ dhe analiza financiare-juridike e kryer nga Komisioni

87. Nga nxjerrja e llogarisë bankare të subjektit në BKT rezulton se në datën 25.2.2010 ka depozituar shumën 800,000 lekë, të cilën e ka investuar në depozitë. Në datën 6.1.2017 gjendja e kësaj depozitë është në shumën 997,241 lekë.

88. Komisioni ka kryer analizën financiare³¹ në lidhje me këtë depozitë, në të cilën janë përfshirë:

- të ardhurat e subjektit nga aktiviteti “Avokati”, bazuar në marzhin e fitimit 26%;
- të ardhurat e bashkëshortes së subjektit nga paga;
- të ardhurat nga interesat bankarë;
- shpenzimet jetike të përlllogaritura për vitet 1992 – 2000 në masën 66% të të ardhurave dhe në vijim sipas shkresës ref. nr. *** prot., datë 29.1.2019, e ILDKPKI-së, ndërsa shpenzimet jetike të vajzës së subjektit për ditë qëndrimi në Mbretërinë e Bashkuar janë ngarkuar në zërin “TIMS F.Ç” dhe ditët e qëndrimit në Shqipëri janë ngarkuar në zërin “shpenzime jetike të përlllogaritura për 3 persona”.

89. Nga analiza financiare rezulton se subjektit nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për krijimin e kësaj depozite në shumën 672,861.98 lekë. Në lidhje me burimin e llogarisë, subjekti ka kryer deklaram të pasaktë në deklaratën *Vetting*, pasi nuk mund të kenë shërbyer si burim të ardhurat e tij dhe të bashkëshortes deri në vitin 2011.

90. Pas kalimit të barrës së provës³² subjekti pretendoi se në deklaratën *Vetting* ka sqaruar se në BKT, në datën 25.2.2010, ka depozituar shumën 800,000 lekë në llogari rrjedhëse, të cilën e ka kaluar në depozitë. Shuma e depozituar në BKT vjen që nga viti 2010, pra përpara fillimit të detyrës dhe analiza financiare për krijimin e këtij likuiditeti është analizuar nga audituesi

²⁹ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës vërtetimin nr. ***, datë 6.1.2017, të BKT-së.

³⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 28.1.2021, drejtuar bankave dhe institucioneve financiare; kthim përgjigje nr. *** prot., datë 17.2.2021, e BKT-së.

³¹ Shihni tabelën nr. 5 të rezultateve të hetimit.

³² Për më shumë referohuni në prapësimet dhe provat e depozituara nga subjekti pas dërgimit të rezultateve të hetimit, si dhe gjatë seancës dëgjimore.

ligjor dhe, ashtu siç paraqitet edhe në aktin e ekspertimit, analiza financiare, përfshirë edhe këtë pasuri, është pozitive.

91. Komisioni, për të mos rënë në përsëritje të argumenteve, mban të njëjtin qëndrim si në llogaritë bankare më lart, duke konstatuar se nga ana e subjektit nuk është bërë asnjë përpjekje për të kthyer barrën e provës, por e gjithë mbrojtja e tij është bazuar në një akt ekspertimi, i cili nga përmbajtja dhe mënyra e hartimit nuk është bërë konform praktikës së Komisionit apo Kolegjit të Posaçëm të Apelit. Në këndvështrim të Komisionit ky akt ka pasur për qëllim arritjen e një rezultati të favorshëm për subjektin e rivlerësimit, për sa kohë janë përfshirë të ardhurat e prindërve të subjektit dhe të nënës së bashkëshortes së tij, ndërkohë që këto të ardhura nuk janë pretenduar apo deklaruar asnjëherë nga subjekti. Ai, gjatë hetimit administrativ, në deklaratat periodike, por edhe në deklaratën *Vetting*, ka deklaruar si burim të ardhurat e nënës së bashkëshortes së tij vetëm për llogarinë në “Tirana Bank”.

92. Në përfundim, subjekti rezulton me mungesë burimesh të ligjshme për krijimin e kësaj depozite, në shumën 672,861.98 lekë. Gjithashtu, subjekti ka kryer deklaram të pasaktë në lidhje me burimin e kësaj pasurie, pasi të ardhurat e tij të krijuara pas vitit 2010 nuk mund të shërbenin për krijimin e kësaj depozite.

Si rrjedhojë, subjekti ka kryer deklaram të pasaktë, të paplotë dhe të pamjaftueshëm për këtë pasuri, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe shkronjave “a” dhe “b” të nenit 33/5 të ligjit nr. 84/2016.

93. Komisioni, për të qenë sa më ezaures, ka kryer një analizë financiare hipotetike, duke përfshirë të ardhurat nga avokatia si në pikën 49 të këtij vendimi, sërish subjekti rezulton me një rezultat negativ në shumën 15,259,318 lekë. Në rast se në këtë analizë nuk do të përfshiheshin shpenzimet TIMS të vajzës së tij, ai do të rezultonte me një rezultat negativ në shumën 12,014,900 lekë.

94. Nga nxjerrja e llogarisë bankare në euro në BKT rezulton se subjekti ka marrë kredi me qëllim “blerje automjeti”.

- Në datën 29.8.2005 është disbursuar kredia në vlerën 8,950 euro.
- Në datën 29.8.2005 znj. N.A (drejtor i degës së BKT-së Vlorë) ka kryer kreditimin e llogarisë së subjektit në shumën 50 euro.
- Në datën 29.8.2005 shuma 9,000 euro është transferuar në llogarinë e shoqërisë “C” sh.p.k., me komentin “për blerjen e makinës tip “V” që është bërë pranë kësaj shoqërie...”.
- Në datën 28.1.2017 kjo llogari rezulton me gjendje në shumën 388.84 euro.

Në lidhje me këtë llogari, duke marrë në konsideratë se në të kishte kaluar kredia e marrë në vitin 2005, si dhe ishin kryer veprime në lidhje me pasuri të subjektit, Komisioni i ka kaluar barrën e provës subjektit, pasi nuk e ka deklaruar në deklaratën *Vetting*.

95. Pas kalimit të barrës së provës³³, subjekti sqaroi se siç rezulton edhe nga përsëritja që i bën Komisioni, burimi i krijimit të shumave të depozituara në llogari bankare janë tërësisht të ligjshme. Në këto kushte, bazuar në jurisprudencën e Komisionit, por edhe në jurisprudencën e Kolegjit, harresa në deklarimin e një mbetjeje të vogël të kësaj llogarie bankare nuk mund të konsiderohet as pasaktësi dhe as gjetje, apo shkak për marrjen e masës disiplinore. I njëjti argumentim vlen edhe për gjetjen e Komisionit se: “Nga nxjerrja e llogarisë bankare pranë “Alpha Bank” rezulton se subjekti ka çelur llogarinë nr. Al ***, e cila shërben si llogari page për periudhën 8.6.2010 e në vazhdim. Kjo llogari bankare rezulton me gjendje 98,490 lekë në datën 6.1.2017”.

³³ Për më shumë referohuni në prapësimet dhe provat e depozituara nga subjekti pas dërgimit të rezultateve të hetimit, si dhe gjatë seancës dëgjimore.

96. Komisioni, në lidhje me këtë mosdeklarim, vlerëson se ai nuk përbën shkak autonom për marrjen e masës disiplinore ndaj subjektit, por parë së bashku me pasaktësitë në deklarin e burimeve të pasurive, si dhe mungesën e bashkëpunimit të subjektit, ai do të merret në konsideratë në vlerësimin tërësor të procedurave për kriterin e pasurisë.

97. Automjet³⁴ tip “V.T”. Kontrata e shitjes datë 20.4.2015, me dy këste, kësti i parë në datën 20.4.2015 dhe kësti i dytë në datën 13.7.2015, me kompaninë “C” sh.p.k. Vlera: 26,300 euro. Pjesa takuese: 100%.

Burimi sipas deklaratës *Vetting*: 4,000 euro nga shitja e automjetit tip “V.G *”; 11,000 euro nga pakësimi i llogarisë në euro në E.B, Greqi; 11,570 euro të ardhura neto të përfituara nga shërbim fjetje, dhënie dhoma plazhi Dh, Vlorë, viti 2014, në shumën 1,620,000 lekë.

Hetimi³⁵ dhe analiza financiare-juridike e kryer nga Komisioni

98. Subjekti, në datën 20.4.2015, ka lidhur kontratë shitjeje me shoqërinë “C” sh.p.k. për blerjen e automjetit tip “V.T”, në shumën 26,300 euro me TVSH. Në nenin 10 të kontratës është përcaktuar mënyra e pagesës, sipas së cilës:

- pagesa e parë prej 7,900 euro në momentin e firmosjes;
- pagesa e mbetur prej 18,400 euro ditën e dorëzimit të automjetit.

Në datën 13.7.2015 është lëshuar fatura tatimore nr. ***, në vlerën 3,708,300 lekë (26,300 euro).

99. Subjekti si burim për këtë automjet ka deklaruar:

- 4,000 euro nga shitja e automjetit tip “V.G *”;
- 11,000 euro nga pakësimi i llogarisë në euro në E.B, Greqi;
- 11,570 euro të ardhura neto të përfituara nga shërbim fjetje, dhënie dhoma plazhi Dh, Vlorë, viti 2014, në shumën 1,620,000 lekë.

100. Në lidhje me burimet e mësipërme, nga hetimi ka rezultuar se:

- a. Subjekti ka depozituar së bashku me deklaratën *Vetting* kontratë shitjeje nr. ***, datë 11.7.2015, nëpërmjet së cilës ka shitur automjetin tip “V”, për shumën 4,000 euro.
- b. Nga një dokument në gjuhën greke rezulton se subjekti ka një depozitë me bashkëshorten e tij, e cila është hapur në datën 30.12.2005, në vlerën 28,222 euro. Në datat 13.3.2015 dhe 22.6.2015 subjekti ka tërhequr shumën 5,000 euro, pra në total shumën 10,000 euro dhe jo 11,000 euro, sikundër ka deklaruar në deklaratën *Vetting*.
- c. Në lidhje me shumën 11,570 euro, si të ardhura nga shërbim dhënie dhoma plazhi fjetje në Dh, vlerësimi i Komisionit është bërë në pikën 135-138 të këtij vendimi. Përveç këtij vlerësimi konstatohet se subjekti nuk ka deklaruar gjendje *cash* në asnjë nga deklaratat periodike, përfshirë edhe vitin 2014. Nga ana tjetër, bazuar në analizën financiare të vitit 2014, edhe sikur të ishte deklaruar gjendje *cash*, subjekti nuk ka pasur mundësi financiare për krijimin e saj në shumën 1,587,502 lekë.

101. Nga analiza financiare³⁶ rezultoi subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie në shumën 1,033,885.52 lekë. Në analizën financiare janë përfshirë:

- të ardhurat e subjektit nga paga;

³⁴ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: (i) kontratë shitjeje datë 20.4.2015; (ii) librezë depozite e E.B, Greqi; (iii) kontratë shitjeje nr. ***, datë 11.7.2015.

³⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 28.9.2021, drejtuar DPSHTRR-së; kthim përgjigje nr. *** prot., datë 5.2.2021, e DPSHTRR-së.

³⁶ Shihni tabelën nr. 6 të rezultateve të hetimit.

- të ardhurat e bashkëshortes nga paga;
- të ardhurat nga interesat bankarë;
- të ardhurat nga shitja e automjetit tip “G *”.

Nuk janë përfshirë të ardhurat nga shërbimi dhënie dhoma plazhi fjetje në Dh.

Shpenzimet jetike janë përlogaritur sipas shkresës ref. nr. ***prot., datë 29.1.2019, të ILDKPKI-së. Shpenzimet jetike të vajzës së subjektit për ditë qëndrimi në Mbretërinë e Bashkuar janë ngarkuar në zërin “TIMS F.Ç” dhe ditët e qëndrimit në Shqipëri janë ngarkuar në zërin “shpenzime jetike të përlogaritura për 3 persona”.

102. Pas kalimit të barrës së provës³⁷ subjekti fillimisht pretendoi se i kishte kërkuar një audituesi ligjor të verifikonte të ardhurat e tij, por për shkak të kohës ai nuk e kishte mbaruar ende analizën financiare. Subjekti depozitoi në seancën dëgjimore plotësimin e prapësimeve, ku në pasqyrën nr. 18 të këtyre rezultate është analiza financiare e vitit 2015.

103. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, konstaton se ato janë mbështetur në analizën financiare të kryer nga eksperti kontabël. Në këtë analizë, ndryshe nga analiza e Komisionit, është përfshirë një shumë prej 935,000 lekësh, me emërtimin “të ardhura nga qiraja e objektit”, por pa u specifikuar se për cilin vit. Në lidhje me të ardhurat nga shërbim fjetje, Komisioni i ka trajtuar gjerësisht në pikën 135-138 të këtij vendimi, duke mos i konsideruar ato në analizë financiare. Përpos vlefshmërisë së këtyre të ardhurave, Komisioni konstaton se analiza e ekspertit nuk përputhet me deklarin e subjektit në deklaratën *Vetting*, ku ai ka deklaruar si burim shumë 1,620,000 lekë nga qiratë e viti 2014. Gjithashtu, eksperti ka kryer një analizë vjetore, ndërkohë analiza duhej pjesore. Në momentin e blerjes dhe pagesës së automjetit këto të ardhura nga shërbim fjetje të vitit 2015 nuk ishin gjeneruar ende, pasi pagesat e automjetit janë kryer në muajt prill dhe korrik të atij viti, pra në kohën e fillimit të sezonit turistik. Për sa kohë këto të ardhura krijoheshin gjatë sezonit turistik, ato nuk mund të ishin në dispozicion të subjektit në muajt prill dhe korrik.

104. Në përfundim, subjekti rezulton me mungesë burimesh të ligjshme për blerjen e automjetit, në shumën 1,033,885.52 lekë.

Si rrjedhojë, subjekti ka kryer deklarin të pasaktë, të paplotë dhe të pamjaftueshëm për këtë pasuri, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe shkronjave “a” dhe “b” të nenit 33/5 të ligjit nr. 84/2016.

105. Komisioni, për të qenë sa më ezaures, pavarësisht se nga subjekti pas dërgimit të rezultate të hetimit është ndryshuar qëndrim në lidhje me burimin e kësaj pasurie, duke u përfshirë të ardhurat nga shërbimi fjetje dhoma Dh për vitin 2015, të cilat, sikundër u trajtuan më lart, nuk mund të shërbenin si burim, pasi nuk ishin krijuar ende në momentin e pagesës së automjetit, ka kryer një analizë financiare hipotetike për mundësinë e krijimit të kursimeve *cash* në shumën 1,620,000 lekë të subjektit të rivlerësimit në vitin 2014, bazuar në vetë pretendimet e subjektit, duke përfshirë të ardhurat nga shërbim fjetje dhe pranimin e tyre si të kursyera *cash*.

Nga kjo analizë subjekti rezulton me mungesë burimesh të ligjshme në shumën 1,453,519 lekë.

106. Gjendje *cash* jashtë sistemit bankar në shumën 1,400,000 lekë

Burimi sipas deklaratës *Vetting*: nuk deklarohet.

Hetimi dhe analiza financiare-juridike e kryer nga Komisioni

107. Në DPV/2016 subjekti ka deklaruar kursime *cash* në shumën 1,400,000 lekë dhe bashkëshortja e tij në shumën 656,600 lekë, duke specifikuar edhe burimin kursime nga paga.

³⁷ Për më shumë referohuni në prapësimet dhe provat e depozituara nga subjekti pas dërgimit të rezultateve të hetimit, si dhe gjatë seancës dëgjimore.

Në lidhje me këtë deklaram, subjekti, në përgjigje të pyetësorit të datës 26.1.2023, ka sqaruar: “*Bashkëshortja ime ka deklaruar kursime nga paga, viti 2016, shumën 656,500 lekë dhe jo kursime cash në shumën 656,500 lekë, pra kjo shumë është deklaruar prej saj si kursime në llogarinë e pagës që ka tek “Credins Bank”*”.

108. Nga nxjerrja e llogarisë bankare pranë “Credins Bank” rezulton se:

- në datën 16.12.2016, shtetasja M.Ç gjendjen e llogarisë prej 1,156,492.50 lekësh e ka konvertuar në 8,535 euro, me kursin preferencial 135.5 lekë;
- në datën 31.12.2016 gjendja e llogarisë së pagës së shtetases M.Ç është 105,546.41 lekë.

Për sa më sipër, shpjegimet e subjektit nuk përputhen me të dhënat bankare të bashkëshortes, për rrjedhojë duket se subjekti nuk i ka deklaruar kursimet e saj në deklaratën *Vetting*, duke iu kaluar barrë prove.

Gjithashtu, nga analiza financiare³⁸ rezulton se subjekti nuk ka pasur mundësi financiare për të krijuar gjendje *cash* në fund të vitit 2016, në shumën -1,439,943.06 lekë.

109. Pas kalimit të barrës së provës³⁹ subjekti sqaroi se burim kanë qenë të ardhurat nga dhënia me qira dhoma shërbim fjetje në Dh për vitet 2015 dhe 2016, të deklaruara nga bashkëshortja e tij në DPV/2015 dhe DPV/2016, përkatësisht 935,000 lekë dhe 850,000 lekë, të cilat janë të ardhura të ligjshme, që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore. Mosdeklarimi i gjendjes *cash* në deklaratat e mëparshme ka ardhur si pasojë e mendimit se për veprimet monetare të kryera vlerësohet sasia e të ardhurave të ligjshme dhe e shpenzimeve të dokumentuara sipas ligjit, ndërsa diferenca e pashpenzuar nënkuptohet si kursim *cash*. Këto të ardhura janë deklaruar nga ana e tij si subjekt i rivlerësimit në deklaratat e interesave periodikë privatë dhe janë kursim i përdorur si burim në vitin/vitet pasardhës.

Bashkëshortja e tij, në datën 16.12.2016, bëri transfertë nga “Credins Bank” të shumës 8,500 euro në emër të F.Ç. Është deklaruar që shuma prej 1,156,492 lekësh, kursim nga paga për vitet 2015 – 2016, është konvertuar në 8,500 euro dhe kaloi në llogarinë në euro e u krye transferta. Në datën 16.12.2016 gjendja e llogarisë ka qenë në shumën 1,156,492.50 lekë. Pra gjatë vitit 2016 paga e kredituar në llogarinë e bashkëshortes së subjektit është shtuar në shumën e përafërt të deklaruar prej saj si kursim i vitit 2016, me fjalën “kursim në shumën 656,600 lekë”, e cila ka pasur në vëmendje shumën e kursyer nga të ardhurat nga pagat që janë transferuar në Mbretërinë e Bashkuar, ashtu siç përshkruhet në relacion. Në analizën financiare shpenzimet jetike janë përlllogaritur sipas shkresës ref. nr. *** prot., datë 29.1.2019, të ILDKPKI-së për 3 persona. Në vitin 2016 vajza ka deklaruar që jeton e punon në Birmingham, Mbretëri e Bashkuar dhe nga ana e saj janë deklaruar edhe të ardhura neto, në paund, nga punësimi në këtë shtet. Për rrjedhojë, shpenzimet jetike duhet të llogariten për dy persona që nga viti 2015 e në vijim. Gjithashtu, në analizën financiare duhet të shtohen edhe të ardhurat e krijuar nga aktiviteti i dhënies së dhomave me qira, të ardhura të cilat janë realizuar dhe për të cilat janë paguar edhe detyrimet tatimore sipas nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

110. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, konstaton se ai ka ndryshuar qëndrim në lidhje me deklaramin e gjendjes *cash* të bashkëshortes së tij. Gjatë hetimit ai deklaroi se gjendja *cash* e bashkëshortes përbënte gjendje si kursim në llogarinë e pagës që ajo kishte në “Credins Bank”, ndërkohë pas kalimit të barrës së provës subjekti deklaroi se gjendje *cash* kanë qenë kursimet nga paga në vitet 2015 – 2016, të cilat më pas janë transferuar në llogarinë bankare të vajzës së tij në Mbretërinë e Bashkuar. Edhe ky deklaram i subjektit nuk përputhet me deklaramet e bashkëshortes së tij në deklaratat periodike, pasi nuk rezulton që ajo të ketë kryer një deklaram të tillë, sikundër e pretendon subjekti. Për sa i përket pretendimit të subjektit se

³⁸ Shihni tabelën nr. 7 të rezultateve të hetimit.

³⁹ Për më shumë referohuni në prapësimet dhe provat e depozituara nga subjekti pas dërgimit të rezultateve të hetimit, si dhe gjatë seancës dëgjimore.

kursimet e tij *cash* e kanë burimin nga kursimet e të ardhurave nga qiraja për vitet 2015 – 2016, Komisioni vlerëson të mos e marrë në konsideratë, pasi në lidhje me këto të ardhura është vendosur të mos përfshihen në analizë financiare. Por, edhe në rast se do të përfshiheshin, sërish rezulton se subjekti nuk ka deklaruar kursime *cash* në vitin 2015 dhe për më tepër në analizën e ekspertit kontabël është pretenduar se të ardhurat nga qiraja të vitit 2015 janë përdorur si burim për të mbuluar shpenzimet e këtij viti dhe nuk janë trajtuar si kursime *cash*.

111. Komisioni vendosi të pranojë pretendimin e subjektit në lidhje me shpenzimet jetike të vajzës së tij në vitin 2016, duke i hequr nga analiza financiare. Sërish subjekti rezulton me pamundësi financiare në shumën 1,204,851 lekë.

112. Në përfundim, subjekti rezulton me mungesë burimesh të ligjshme për krijimin e kursimeve *cash* në shumën 1,204,851 lekë.

Si rrjedhojë, subjekti ka kryer deklarim të pasaktë, të paplotë dhe të pamjaftueshëm për këtë pasuri, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe shkronjave “a” dhe “b” të nenit 33/5 të ligjit nr. 84/2016.

Konstatime të tjera

113. Nga nxjerrja e llogarisë bankare pranë “Alpha Bank” rezulton se subjekti ka çelur llogarinë nr. A***, e cila shërben si llogari page për periudhën 8.6.2010 e në vazhdim. Kjo llogari bankare rezulton me gjendje 98,490 lekë në datën 6.1.2017 dhe nuk rezulton të jetë deklaruar në deklaratën *Vetting*.

Në lidhje me këtë llogari page, subjekti dha të njëjtat shpjegimet si në pikën 95 të këtij vendimi.

114. Komisioni, për të mos rënë në përsëritje, vlerëson se kjo pasaktësi e subjektit në lidhje me mosdeklarimin e llogarisë së pagës nuk përbën shkak për marrjen e masës disiplinore ndaj tij, por do të merret në konsideratë në vlerësimin tërësor të kriterit të pasurisë.

DEKLARIMI I PASURIVE TË BASHKËSHORTES SË SUBJEKTIT – M.Ç

115. Banesë⁴⁰ dy kate + sofite, me sipërfaqe ndërtimore 131 m², në Dh. ZVRPP Vlorë, vërtetim hipotekor nr. ***, datë 26.2.2007. Vlera: 15,000,000 lekë. Pjesa takuese: 100%.

Burimi sipas deklaratës *Vetting*: të ardhurat nga puna e bashkëshortit si avokat në vitet 1993 – 2010, të ardhurat e bashkëshortes nga paga si punonjëse e “P.D” sh.a., Vlorë, në vitet 1987 – 2011, si dhe interesat bankarë në vite.

Konstatimi i ILDKPKI-së

- *Mungesë dokumentacioni justifikues ligjor lidhur me vlerën e pasurisë së paluajtshme, banesë dy kate + sofite, me sipërfaqe ndërtimore 131 m², në Dh, Vlorë, deklaruar në pronësi të bashkëshortes së subjektit.*

Hetimi⁴¹ dhe analiza financiare-juridike e kryer nga Komisioni

116. Bashkëshortja e subjektit është pajisur me leje ndërtimi nga Bashkia Himarë në datën 18.2.2002, për ndërtimin e objektit banesë dy kate + sofite, Dh. Sipërfaqja e sheshit 270 m², sipërfaqja e ndërtimit 131 m². Në datën 18.12.2004 është bërë edhe rinovimi i kësaj lejeje ndërtimit.

⁴⁰ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: (i) vërtetim nga dokumenti hipotekor, datë 28.2.2007, për pasurinë në z. k. ***; (ii) leje ndërtimi datë 22.2.2002, për banesë 2 kate + sofite, me sipërfaqe ndërtimore 131 m², në Dh.

⁴¹ Kthim përgjigje nr. *** prot., datë 30.8.2017, e Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (gjendur në dosjen e ILDKPKI-së); shkresë nr. *** prot., datë 28.1.2021, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve; kthim përgjigje nr. *** prot., datë 26.2.2021, e DRT-së Tiranë.

Sipas vërtetimit nga dokumentet hipotekore vërtetohet se në regjistrin hipotekor nr. ***, datë 26.2.2007, figuron e regjistruar në pronësi të shtetases M.M pasuria në z. k. ***, me adresë Dh, Vlorë. Banesë dy kate + sofite, me sipërfaqe ndërtimore 131 m².

117. Bazuar në procesverbalin e kolaudimit të kësaj banese rezulton se:

- shpenzimet për ndërtim janë në shumën 20,000,000 lekë, sipas deklarimeve të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit;
- ndërtimi ka filluar në datën 22.2.2002 dhe ka përfunduar më 22.8.2002;
- trualli ka qenë në pronësi të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit;
- sipërmarrësi i ndërtimit ka qenë shoqëria “A” sh.p.k.

118. Në përgjigje të pyetësorit të datës 26.1.2023⁴² subjekti ka sqaruar se: “Nga këqyrja me vëmendje e procesverbalit të kolaudimit nuk rezulton që bashkëshortja ime të ketë deklaruar shumën prej 20,000,000 lekësh, si vlerë e objektit në Dh. Në këtë akt ka nënshkruar vetëm ing. L.A dhe ing. L.D... Kjo godinë banimi nuk është ndërtuar nga shoqëria “A” sh.p.k., por me brigada punëtorësh që punonin në Dh. Sqaroj se bashkëshortja ime nuk ka lidhur asnjë kontratë sipërmarrje me këtë shoqëri. Leja e ndërtimit nr. ** e vitit 2002 ka dalë në emër të bashkëshortes sime dhe jo të shoqërisë “A” sh.p.k. Sqarojmë se banesa e sipërcituar nuk është ndërtuar për hotel por për banesë... Sipërfaqja totale e truallit që është ndërtuar banesa, referuar lejes së sheshit të ndërtimit, është 270 m², dhe sipërfaqja ndërtimore 131 m². Trualli është në pronësi të gjyshes së bashkëshortes sime nga babai F.M, e cila e ka përfutur me Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi me nr. regj. akti ***, datë 7.2.1994, me sipërfaqe totale 3240 m², i paregjistruar në regjistrat publikë, e ndodhur në lagjen “Gj”, fshati Dh, Bashkia Himarë, kopje të së cilës do e gjeni bashkëlidhur. Ndërtimi i godinës është kryer mbi parcelën me toponimin “Ll”...

Me deklaratën noteriale nr. ***rep., nr. *** kol., datë 26.12.2020, noter A.Xh, A.C deklaroi: “...Av. Petraç Çuri ka paguar vlerën e materialeve në masën 200,000 lekë për mobilimin në godinën Dh...”.

Sqarojmë se mobilimi i banesës nuk ka ndryshuar, është po ai që është bërë në vitet 2005 – 2007”.

119. Për sa i përket vlerës së ndërtimit të godinës, Komisioni do të marrë në konsideratë atë të përcaktuar në aktin e kolaudimit, si i vetmi dokument ligjor provues në lidhje me këto shpenzime. Nga analiza financiare⁴³ e kryer nga Komisioni⁴⁴ subjekti rezultoi me mungesë burimesh të ligjshme në shumën 21,063,072 lekë, për ndërtimin e kësaj godine në vitin 2002.

120. Në përfundim, subjektit i kaloi barra e provës në lidhje me këtë pasuri, si vijon:

⁴² Subjekti ka bashkëlidhur: (i) leje sheshi ndërtimi nr. ***, datë 18.2.2002; (ii) leje ndërtimi datë 22.2.2002; (iii) vendim nr. **, datë 18.12.2004, e KRRT Bashkia Himarë, për rinovimin e lejes së ndërtimit; (iv) leje shfrytëzimi nr. ** prot., datë 29.1.2007; (v) procesverbal kolaudimi; (vi) vërtetim nr. *** prot., datë 22.8.2018, i kryesisë së fshatit Gj, sipas të cilit znj. E.M banon në shtëpinë e vajzës së saj M.M në këtë fshat; (vii) akt vlerësimi nga ing. A.N. Ky akt vlerësimi nuk do të merret në konsideratë për sa i përket vlerës së pronës, pasi vlera e saj është përcaktuar në procesverbalin e kolaudimit dhe nuk bazohet në të dhëna hipotetike, sikundër bazohet akti i ekspertimit, por në të dhëna faktike. Për sa kohë vlera e investimit në këtë procesverbal është 20,000,000 lekë dhe nuk rezultoi të jetë kundërshtuar nga bashkëshortja e subjektit, por është përdorur për regjistrimin e pronës, vlera e banesës në analizë do të konsiderohet 20,000,000 lekë; (viii) kopje AMTP me nr. akti ***, datë 7.2.1994, sipas së cilës shtetases F.M i jepet në pronësi në fshatin Gj 3240 m² tokë bujqësore; (ix) deklaratë noteriale nr. ***, datë 26.12.2020, sipas së cilës shtetasi A.C deklaroi se: “...Av. Petraç Çuri ka paguar vlerën e materialeve në masën 200,000 lekë për mobilimin në godinën Dh...””; (x) foto të godinës.

⁴³ Në analizën financiare janë përfshirë: (i) të ardhurat e subjektit nga aktiviteti “Avokati”; (ii) të ardhurat e bashkëshortes së subjektit nga paga; (iii) të ardhurat nga interesat bankarë; (iv) shpenzimet jetike të përlllogaritura për vitet 1992 – 2000 në masën 66% të të ardhurave dhe në vijim sipas shkresës ref. nr. *** prot., datë 29.1.2019, të ILDKPKI-së, të përlllogaritura për 3 persona.

⁴⁴ Shihni tabelën nr. 8 të rezultateve të hetimit.

- a. Vlera e investimit të banesës është 20,000,000 lekë.
- b. Subjekti nuk ka deklaruar saktë vlerën e kësaj pasurie në deklaratën *Vetting*.
- c. Subjekti nuk ka deklaruar saktë burimin e ligjshëm të kësaj pasurie në deklaratën *Vetting*, pasi nuk mund të kenë shërbyer si burim të ardhurat e tij dhe të bashkëshortes deri në vitin 2011.
- d. Subjekti nuk ka depozituar asnjë dokument për të provuar shpenzimet në shumën 15,000,000 lekë.
- e. Subjekti nuk ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për ndërtimin e kësaj banese në shumën kumulative 20,303,632.68 lekë.

121. Pas kalimit të barrës së provës⁴⁵ subjekti parashtrroi të njëjtat pretendime si gjatë hetimit administrativ, duke shtuar se deklarimi i shumës 15,000,000 lekë është bërë bazuar në projektpreventivin e hartuar nga ing. L.D. Subjekti është referuar edhe në vendimet e Kolegjit me nr. 6/2022 dhe nr. 479/2021. Subjekti deklaroi se pavarësisht se eksperti kontabël A.M ka vendosur në analizën financiare shumën 20,000,000 lekë, vlera e kësaj godine është maksimalisht 15,000,000 lekë. Megjithatë, edhe nga analiza financiare e kryer nga audituesi ligjor rezultoi se kjo pasuri është krijuar me të ardhura të ligjshme. Subjekti pretendon për herë të parë se godina është ndërtuar nga shtetasi Gj.S, ish-kryeplak i fshatit Dh, si dhe është ndërtuar gjatë viteve 2002 – 2004. Në përfundim, subjekti kërkon që në analizë të merret në konsideratë shuma prej 11,000,000 lekësh, sipas deklarimeve të shtetasit Gj.S dhe të jetë e shpërndarë në vite.

122. Subjekti ka depozituar:

- i. Deklaratë noteriale nr. ***, datë 20.4.2023, të shtetasit Gj.S, i cili deklaroi se në vitet 2001 – 2011 ka qenë kryeplak në fshatin Dh. Në këtë periudhë ka qenë në cilësinë e sipërmarrësit privat në fushën e ndërtimeve në zonën e Himarës, pa u regjistruar në organet tatimore. Ai deklaroi se ka kryer punimet për ndërtimin e godinës së banimit të bashkëshortes së subjektit, të cilat kanë kushtuar në vlerën 1,100,000 lekë.
- ii. Projekt banese 3 kate.
- iii. Preventiv nga ing. L.D, ku vlera e parashikuar është 15,349,361 lekë.
- iv. Vërtetim datë 3.5.2023, i kryesisë së fshatit Gj.

123. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerëson se ato nuk janë bindëse. Në lidhje me vendimet e cituara të Kolegjit, ato gjejnë zbatim si referencë në rastet kur mungon dokumentacioni provues i kohës. Në këtë rast, si Komisioni, ashtu edhe Kolegji, u referohen të dhënave të Entit Kombëtar të Banesave. Ndërkohë, në rastin e banesës së bashkëshortes së subjektit ekziston preventivi i punimeve, i cili ka parashikuar një vlerë prej 15,349,361 lekësh, po ashtu dhe akti i kolaudimit, i cili ka përcaktuar që këto punime kanë kushtuar në vlerën 20,000,000 lekë. Të dyja dokumentet e mësipërme rezultojnë të përgatitura nga i njëjti person, z. L.D. Për rrjedhojë, të dhënat në këto dokumente janë të dhëna zyrtare dhe për më tepër janë përdorur për të përfituar lejen e ndërtimit, si dhe regjistrimin e pasurisë dhe marrjen e lejes së shfrytëzimit. Subjekti është kontradiktor në lidhje me vlerën e ndërtimit, pasi në deklaratën *Vetting* ka deklaruar shumën 15,000,000 lekë, ndërkohë gjatë hetimit dhe pas kalimit të barrës së provës ka pretenduar vlerën 11,000,000 lekë, ndërkohë në analizën e ekspertit kontabël të depozituar nga subjekti është vendosur vlera 20,000,000 lekë. Për të provuar pretendimin e tij se banesa ka kushtuar në vlerën 11,000,000 lekë, subjekti fillimisht ka depozituar një akt ekspertimi, i cili nuk ka asnjë vlerë provuese, pasi është bërë bazuar në të dhëna hipotetike dhe nuk mund të barazohet me dy aktet e mësipërme, të cilat janë hartuar në kohën e ndërtimit të banesës dhe me pas ka depozituar një deklaratë noteriale. Komisioni, duke u bazuar edhe në

⁴⁵ Për më shumë referohuni në prapësimet dhe provat e depozituara nga subjekti pas dërgimit të rezultateve të hetimit, si dhe gjatë seancës dëgjimore.

jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit⁴⁶ në lidhje me deklaratën noteriale të depozituar nga subjekti, nëpërmjet së cilës pretendohet se punimet janë kryer nga ish-kryeplaku i fshatit Dhërmi, por edhe për të gjitha deklaratat e tjera noteriale të depozituara nga subjekti, të cilat janë hartuar pas deklaratës *Vetting*, vlerëson se megjithëse nuk janë të pavlefshme, në kuptim të legjislacionit për noterinë, ato nuk kanë fuqi provuese në këtë proces, pasi janë kryer gjatë procesit të rivlerësimit dhe, e parë në raport me të dhënat e tjera, nuk mbështeten nga rrethanat dhe provat e administruara gjatë shqyrtimit të çështjes, në kuptim të nenit 49, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, çka të krijon bindjen se janë konceptuar në favor të deklarimeve të subjektit të rivlerësimit.

Për sa më sipër, Komisioni vlerëson se subjekti është përpjekur të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasurinë banesë në pronësi të tij në lidhje me burimin e kësaj pasurie dhe vlerën e ndërtimit, si dhe ka mungesë burimesh të ligjshme për të justifikuar krijimin e saj.

124. Në përfundim, Komisioni çmon se: (i) subjekti ka kryer deklaram të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin në lidhje me këtë pasuri; (ii) subjekti ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar ndërtimin e kësaj pasurie në shumën 20,303,632.68 lekë.

Si rrjedhojë, subjekti ka kryer deklaram të pasaktë, të paplotë dhe të pamjaftueshëm për këtë pasuri, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe shkronjave “a” dhe “b” të nenit 33/5 të ligjit nr. 84/2016.

125. Komisioni, për të qenë sa më ezaures me subjektin, ka kryer edhe një analizë financiare hipotetike, duke përfshirë të ardhurat nga avokatia sipas pikës 49 të këtij vendimi dhe ndërtimin e kësaj banese të ndarë në tri vite sipas vlerave të përcaktuara nga eksperti në aktin e ekspertimit dhe në këtë rast subjekti rezulton me një rezultat negativ në vlerën 2,468,885 lekë.

126. Në lidhje me të ardhurat e përfituara nga shërbimi fjetje dhoma Dh, për periudhën 2012 – 2016

Bashkëshortja e subjektit në deklaratën *Vetting* ka deklaruar të ardhura në totale në shumën 6,905,000 lekë, nga shërbimi fjetje dhoma Dh.

127. Për të provuar këto të ardhura, subjekti ka depozituar:

i. Viti 2012

- Njoftim debitimi datë 30.7.2012, të “Raiffeisen Bank”⁴⁷, për pagesë të shumës 80,000 lekë nga subjekti, me përshkrimin “M.Ç tatim në burim shërbim fjetje qershor – korrik 2012”, në favor të Degës së Tatimeve Vlorë + urdhërpagesë për shumën 80,000 lekë.
- Mandat urdhërpagesë, datë 27.8.2012, i “Alpha Bank”, për pagesë të shumës 120,000⁴⁸ lekë nga subjekti me përshkrimin “M.Ç me NIPT K***K, pagesë tatimi në burim shërbim fjetje në dhoma në Dh”, në favor të Degës së Tatim Taksave Vlorë + urdhërpagesë për shumën 120,000 lekë.

Në DPV/2012 bashkëshortja e subjektit deklaron të ardhura në shumën 1,800,000 lekë. Kjo shumë është deklaruar edhe në DIVA/2012 si e ardhur bruto nga qiraja.

ii. Viti 2013

- Pagesë *cash* për tatimet datë 29.7.2013, nëpërmjet “Union Bank”, e shumës 80,000 lekë nga bashkëshortja e subjektit, me përshkrimin “M.Ç pagesë tatim për fjetje në dhoma

⁴⁶ Vendim nr. 6/2018 (JR), datë 12.9.2018, paragrafët 35 dhe 36; vendim nr. 11/2019 (JR), datë 22.5.2019, paragrafi 27.12.1; vendim nr. 34/2019 (JR), datë 2.12.2019, paragrafi 85.2; vendim nr. 23/2020 (JR), datë 25.9.2020, paragrafi 26.2; dhe vendim nr. 11/2021 (JR), datë 31.3.2021.

⁴⁷ Konfirmuar edhe nga nxjerrja e llogarisë së subjektit në “Raiffeisen Bank”.

⁴⁸ Konfirmuar edhe nga nxjerrja e llogarisë së subjektit në “Alpha Bank”.

plazhi qershor – korrik 2013”, në favor të DRT-së Vlorë + urdhërpagesë në shumën 80,000 lekë.

- Njoftim për depozitim *cash*, datë 30.8.2013, nga “Intesa Sanpaolo Bank”, i shumës 110,000 lekë nga shtetasja M.Ç, me përshkrimin “Zona turistike Dh, tatim në burim për shërbim fjetje në dhoma, M.Ç, NIPT K***K + urdhërpagesë në shumën 110,000 lekë”.

Në DPV/2013 bashkëshortja e subjektit deklaroi të ardhura në shumën 1,700,000 lekë. Në DIVA/2013 është deklaruar si e ardhur bruto nga qiratë shuma 1,900,000 lekë.

iii. Viti 2014

- Pagesë e datës 29.8.2014 në BKT, e shumës 180,000 lekë, me përshkrimin “M.Ç derdh detyrim pagesë për dhoma plazhi, tatim në burim 2014 + urdhërpagesë në shumën 180,000 lekë”.

Në DPV/2014 bashkëshortja e subjektit deklaroi të ardhura në shumën 1,620,000 lekë. Në DIVA deklaroi të ardhura bruto nga qiraja në shumën 1,800,000 lekë.

iv. Viti 2015

Në DPV/2015 bashkëshortja e subjektit deklaroi të ardhura në shumën 935,000 lekë.

Në DIVA/2015 deklaroi të ardhura bruto nga qiraja 1,100,000 lekë. Në këtë deklaratë rezultoi me një detyrim tatimi për të paguar në shumën 165,000 lekë.

Pagesa e detyrimeve tatimore provohet me depozitim në arkë i “Tirana Bank”, datë 1.3.2016, i shumës 165,000 lekë, depozituar nga subjekti, me përshkrimin “M.Ç, tatim të ardhura individuale + urdhërpagesë të shumës 165,000 lekë, tatim mbi të ardhurat individuale”.

v. Viti 2016

Në DPV/2016 bashkëshortja e subjektit deklaroi të ardhura në shumën 850,000 lekë. Në DIVA/2016 deklaroi të ardhura bruto nga qiraja shumën 1,000,000 lekë. Në këtë deklaratë rezultoi tatimi për t’u paguar në shumën 150,000 lekë.

Pagesa e detyrimeve tatimore provohet me veprim në llogarinë e “Credins Bank”, datë 13.1.2017, nga bashkëshortja e subjektit, pagesë tatim mbi të ardhura individuale, 150,000 lekë, periudha janar – dhjetor 2016 + urdhërpagesë për shumën 150,000 lekë.

vi. Viti 2017

Në DPV/2017 bashkëshortja e subjektit deklaroi të ardhura në shumën 807,500 lekë.

Në DIVA/2017 deklaroi të ardhura bruto nga qiraja në shumën 950,000 lekë. Në këtë deklaratë rezultoi tatimi për t’u paguar shuma 142,500 lekë.

vii. Viti 2018

Në DPV/2018 bashkëshortja e subjektit deklaroi të ardhura në shumën 935,000 lekë. Në DIVA/2018 deklaroi të ardhura bruto nga qiraja në shumën 1,100,000 lekë. Në këtë deklaratë rezultoi tatimi për t’u paguar në shumën 165,000 lekë.

128. Në lidhje me këto të ardhura, Komisioni i ka kërkuar subjektit dokumentacion provues për të provuar krijimin e tyre, pasi vetëm pagimi i tatimit në burim nuk është i mjaftueshëm. Gjithashtu, Komisioni i ka kërkuar subjektit të dhëna në lidhje me shpenzimet për mirëmbajtjen dhe administrimin e kësaj sipërmarrjeje.

129. Në përgjigje të pyetësorit të datës 26.1.2023, subjekti ka sqaruar: “Nuk kam kryer rinovim të kësaj banese pas ndërtimit të saj. Shfrytëzimi i banesës në konceptet tatimore është dhënie dhoma me qira, e cila i nënshtrohet tatimit në burim. Tatimi në burim vendoset për një kategori shërbimesh siç është dhënia e dhomave me qira dhe nuk i nënshtrohet regjistrimit tatimor... Kjo godinë është banesë dhe, për rrjedhojë, nuk ka emër dhe nuk është e regjistruar në booking.

Nga ana jonë nuk është bërë asnjë llogaritje se sa është vlera e mirëmbajtjes së kësaj banese gjatë një viti, pasi mirëmbajtja e saj bëhet rast pas rasti, e shtrirë në kohë që nga koha e përfundimit të ndërtimit fundviti 2006 - fillimviti 2007 e deri më sot. Banesa nuk shfrytëzohet si hotel, por shfrytëzohet për dhënie dhoma me qira në periudhën e verës. Duke qenë se periudha e verës është një periudhë e kufizuar, ashtu sikurse vepron edhe pjesa më e madhe e banorëve në fshatin Dh me banesat e tyre kur i japin me qira, nga ana e bashkëshortes sime nuk punësohen persona. Në banesën time në pjesën më të madhe të vitit jeton vjehrra ime E.M, për të cilën kjo banesë është vendqëndrimi i saj. Ajo kujdeset për të si çdo person kujdeset për shtëpinë e vet. Pavarësisht se unë dhe bashkëshortja ime jemi të punësuar në kohë festash, pushimesh dhe leje vjetore, vemi në banesën tonë në Dh dhe i shërbejmë asaj.

Dhënia e dhomave me qira në kohë vere, lidhur me banesën tonë, lehtësohet nga pozicioni saj buzë rrugës kryesore që të çon buzë detit”.

130. Subjekti ka bashkëlidhur:

- i. pagesë datë 26.1.2018, në “Credins Bank”, shuma 142,500 lekë;
- ii. pagesë datë 5.2.2019, në “Credins Bank”, shuma 165,000 lekë;
- iii. pagesë datë 17.1.2020, në “Intesa Sanpaolo Bank”, shuma 180,000 lekë;
- iv. pagesë datë 22.1.2021, në “Credins Bank”, shuma 90,000 lekë;
- v. pagesë datë 4.3.2022, në “Credins Bank”, shuma 40,500 lekë.

131. Komisioni, referuar përgjigjeve të subjektit, si dhe dokumentacionit të administruar, konstaton se:

- a. Subjekti i rivlerësimit nuk ka depozituar asnjë dokumentacion provues për të provuar realizimin e veprimtarisë shërbim fjetje, si dhe të masës së të ardhurave të pretenduara.
- b. Në procesverbalin e kolaudimit të banesës cilësohet se ndërtimi ka funksion strehim të një familjeje, si dhe për motel. Moteli është i kompletuar me të gjitha pajisjet e nevojshme për pushim, si me afat të shkurtër, ashtu edhe për të pushuar për një periudhë të gjatë kohe. Pajisjet e shërbimit janë bashkëkohore.
- c. Referuar vetë deklarimeve të subjektit kemi të bëjmë me një aktivitet i cili zhvillohet gjatë sezonit turistik dhe për qëllime turistike, për rrjedhojë, referuar ligjit nr. 93/2015, “Për Turizmin”, ai ushtron veprimtari turistike.

Në këto kushte, subjekti, në zbatim të ligjit të mësipërm, ka qenë i detyruar të regjistrohej në organet përkatëse, si dhe të mbante evidencë në lidhje me personat të cilëve u ofrohej shërbim fjetjeje.

- d. Referuar ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, një ndër taksat vendore të cilat administrohen nga pushteti vendor është edhe taksa e fjetjes në hotel.

Referuar nenit 26 të të njëjtit ligj, për qëllime të këtij ligji, me “hotel” kuptohet çdo veprimtari që jep strehim kundrejt pagesës dhe përfshin emërtimet hotel, motel, stabiliment turistik, pension, shtëpi pritjeje, turizëm familjar dhe çdo objekt tjetër që përdoret për këtë qëllim, përcaktim ky që përfshin edhe aktivitetin e deklaruar nga ana e subjektit të rivlerësimit, ndonëse rezultojnë që të mos jetë regjistruar pranë organit tatimor për ushtrimin e një aktiviteti të tillë. Sipas të njëjtit nen, detyrimi për taksën i takon klientit që strehohet në hotel, detyrim i cili mbahet nga hoteli për llogari të bashkisë, në territorin e të cilit ndodhet hoteli dhe derdhja e të ardhurave për këtë taksë nga hoteli në favor të bashkisë, në juridiksionin e së cilës ndodhet vendndodhja e tij, bëhet brenda datës 5 të muajit pasardhës. Për sa më sipër, rezultojnë se subjekti nuk ka depozituar dokumentacion provues të njësisë administrative për pagimin e detyrimeve vendore, duke qenë se ai ka ushtruar veprimtarinë shërbim fjetjeje për qëllime turistike vetëm për sezonin e verës.

- e. Subjekti, për disa pyetje të drejtuara atij në lidhje me këtë aktivitet, nuk ka kthyer përgjigje me qëllim shmangien e Komisionit nga kryerja e një analize të plotë financiare mbi mundësinë e krijimit të të ardhurave të deklaruara dhe besueshmërinë e tyre.

Komisioni i ka kërkuar subjektit të provojë këto të ardhura të krijuara, pasi fakti që janë paguar tatimet nuk mund të përdoret si provë e vetme për të provuar këto të ardhura.

132. Në përfundim, për sa kohë nuk është administruar gjatë hetimit administrativ asnjë provë e faktit të realizimit të veprimtarisë shërbim fjetje, të masës së këtyre të ardhurave të pretenduara, si dhe se, lidhur me këto të ardhura nuk rezulton të jetë paguar ndonjë nga detyrimet vendore, Komisioni nuk i ka përfshirë këto të ardhura në analizë financiare. Komisioni, duke mbajtur në konsideratë konstatimet e mësipërme, si dhe sjelljen e subjektit gjatë hetimit administrativ, duke mos deklaruar shpenzimet në lidhje me mirëmbajtjen, shfrytëzimin dhe administrimin e ushtrimit të veprimtarisë shërbim fjetje, sjellje e cila është konsideruar si mungesë bashkëpunimi në kuptim të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, ka ngritur dyshime për deklarim fiktiv të të ardhurave me qëllim justifikimin e pasurive të krijuara gjatë periudhës së rivlerësimit.

133. Pas kalimit të barrës së provës⁴⁹ subjekti sqaroi se: *“Godina në Dh është për banim dhe shërben si e tillë gjatë gjithë vitit, por në periudhën e verës jepen dhoma me qira dhe nuk ofrohet asnjë lloj tjetër shërbimi nga ana e bashkëshortes time dhe për këtë paguhet tatim në burim, bazuar në nenin 33 të ligjit “Për tatimin mbi të ardhurat”. Tatimi në burim vendoset për një kategori shërbimesh, siç është dhënia e dhomave me qira dhe nuk i nënshtrohet regjistrimit tatimor. Ka qenë kjo arsyeja që në ligjin për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë është kjo mënyrë tatimi, e cila është e lidhur edhe me ligjin për të ardhurat personale. Pra, të ardhurat nga qiradhënia konsiderohen si të ardhura personale... Nga ana e bashkëshortes janë ndjekur procedurat siç përshkruhen në njoftimin zyrtar të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve... Në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, Administrata Tatimore, në njoftim e saj drejtuar qytetarëve ka deklaruar: “Gjatë sezonit turistik Administrata Tatimore i ka kushtuar vëmendje të veçantë garantimit të përmbushjes vullnetare të këtij detyrimi nga ana e individëve, të cilët shfrytëzojnë këto mjedise për pushimet verore. Pra, veprimtaria private e “dhënies së dhomave me qira” zhvillohet gjatë sezonit turistik, por është një veprimtari private e ndryshme nga ajo e hotelarisë, për rrjedhojë ajo nuk mund të rregullohet si veprimtari në bazë të ligjit nr. 93/2015, “Për Turizmin”... Në taksat vendore përfshihet, ndër të tjera, taksa e fjetjes në hotel dhe njësitë vendore kanë autoritet të plotë ligjor për të vendosur nivelin e taksës. Nga ana e njësisë vendore Himarë nuk i është vendosur asnjë taksë, pasi nga ana e tyre është vlerësuar që nuk kanë hotel”.*

Në lidhje me konstatimin e Komisionit se subjekti nuk ka qenë bashkëpunues, nuk është dhënë sërish asnjë informacion për sa i përket shpenzimeve në lidhje me mirëmbajtjen, shfrytëzimin dhe administrimin e ushtrimit të veprimtarisë shërbim fjetje, por nga ana e tij është deklaruar se ka paguar detyrimet tatimore.

134. Subjekti ka depozituar provat e mëposhtme:

- i. përgjigje nr. *** prot., datë 20.4.2023, të Ministrisë së Financave;
- ii. njoftim të Ministrisë së Financave në lidhje me pagesën e tatimit të qirasë;
- iii. vërtetim datë 3.5.2023, i kryesisë së fshatit Gj.

135. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, konstaton se të gjithë mbrojtjen e tij e ka bazuar vetëm në faktin e pagesës së detyrimeve tatimore. Nga ana e tij, edhe pas kalimit të barrës së provës, nuk është vënë në dispozicion asnjë provë për të vërtetuar të ardhurat e krijuara nga ky aktivitet. Subjekti ka vijuar të refuzojë të deklarojë shpenzimet në lidhje me

⁴⁹ Për më shumë, referohuni në prapësimet dhe provat e depozituara nga subjekti pas dërgimit të rezultateve të hetimit, si dhe gjatë seancës dëgjimore.

ushtrimin e këtij aktiviteti, refuzim i cili konsiderohet si mungesë bashkëpunimi me Komisionin, në kuptim të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016 dhe do të merret në konsideratë në vlerësimin tërësor të procedurave. Subjekti nuk ka vënë në dispozicion asnjë dokumentacion provues për pagesat e taksës vendore. Ai ka pretenduar se Bashkia Himarë nuk i ka vendosur taksë, pasi ka vlerësuar se nuk ka hotel, por ky deklaram i tij është i pambështetur në prova.

136. Komisioni, duke mbajtur në konsideratë qëndrimet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit⁵⁰, vlerëson se subjekti:

- i. Nuk ka depozituar asnjë provë për të provuar realizimin e veprimtarisë shërbim fjetje, duke mos u provuar bindshëm krijimi i të ardhurave nga ky aktivitet.
- ii. Ka refuzuar në mënyrë të vazhdueshme të deklarojë shpenzimet në lidhje me mirëmbajtjen, shfrytëzimin dhe administrimin e ushtrimit të veprimtarisë shërbim fjetje, sjellje e cila është vlerësuar si mungesë bashkëpunimi, në kuptim të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016 dhe ka vënë në pamundësi Komisionin për të kryer një analizë të mirëfilltë financiare, qoftë edhe për mundësinë e krijimit të të ardhurave nga veprimtaria shërbim fjetje.
- iii. Nuk ka paguar detyrimet vendore sipas parashikimeve të ligjit nr. 9632/2006.

Për sa më sipër, çmohet se të ardhurat e deklaruara nga shërbim fjetje janë deklaruar në mënyrë fiktive me qëllim justifikimin e pasurive të krijuara gjatë periudhës së rivlerësimit.

137. Në përfundim, Komisioni vlerëson se të ardhurat nga shërbimi fjetje nuk do të përfshihen në analizë financiare, pasi subjekti: (i) nuk provoi bindshëm krijimin e tyre; (ii) nuk ka paguar taksat vendore sipas kërkesave të ligjit nr. 9632/2006; si dhe (iii) ka refuzuar të japë të dhëna në lidhje me shpenzimet e kryera për të përfituar këto të ardhura.

138. Referuar përfundimeve të mësipërme, Komisioni vlerëson se subjekti ka kryer deklaram të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin, si dhe deklaram të rremë në lidhje me të ardhurat nga shërbimi fjetje dhoma Dh, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe shkronjave “a” dhe “ç” të nenit 33/5 të ligjit nr. 84/2016.

139. Apartament⁵¹ me sipërfaqe 91.7 m², vol. **, f.***, përfituar nga nëna e bashkëshortes, znj. E.M, me kontratë sipërmarrjeje nr. ***, datë 30.8.2007, lidhur në Vlorë dhe deklaratë noteriale nr. ***, datë 7.10.2011. Pjesa takuese: 100%.

140. Apartament me sipërfaqe 79.25 m², vol. **, f. **, përfituar nga nëna e bashkëshortes, znj. E.M, me kontratë sipërmarrjeje nr. ***, datë 30.8.2007, lidhur në Vlorë dhe deklaratë noteriale nr. ***, datë 7.10.2011, notere A.D. Pjesa takuese: 100%.

Konstatimi i ILDKPKI-së

- *Deklarim i rremë për përfitimin nga M.Ç të apartamentit me sip. 91.7 m², me nr. pasurie ***, z. k. ***, vol. **, f. ***, Vlorë, me deklaratë noteriale nga nëna e saj (e cila e ka përfituar me kontratë sipërmarrjeje në këmbim të truallit dhënë për ndërtim shoqërisë “A-M” sh.p.k.), pasi sipas kontratës së konfirmuar nga DPPPP-ja dhe ZVRPP-ja Vlorë (ASHK Vlorë) apartamenti është blerë nga kjo shoqëri në shumën 5,410,000 lekë, në datën 20.5.2011.*
- *Deklarim i rremë për përfitimin nga M.Ç të apartamentit me sip. 79.25 m², me nr. pasurie ***, z. k. ***, vol. **, f. ***, Vlorë, me deklaratë noteriale nga nëna e saj (e cila e ka përfituar me kontratë sipërmarrjeje në këmbim të truallit dhënë për ndërtim shoqërisë “A-*

⁵⁰ Shihni vendimet nr. 33/2022 paragraf 79-81, nr. 35/2021 paragraf 18.6 dhe nr. 3/2023 të Kolegjit paragraf 21.7.

⁵¹ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: (i) certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, datë 16.6.2011; (ii) kontratë sipërmarrjeje nr. ***, datë 30.8.2007; (iii) certifikatë për vërtetim pronësie datë 9.8.2007; (iv) deklaratë noteriale nr. ***, datë 7.10.2011; (v) certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, datë 13.4.2011.

M” sh.p.k.), pasi sipas kontratës së konfirmuar nga DPPP-ja dhe ZVRPP-ja Vlorë (ASHK Vlorë) apartamenti është blerë nga shtetasi A.Gj.M në shumën 4,755,000 lekë, në datën 14.3.2011.

Hetimit⁵² dhe analiza financiare-juridike e kryer nga Komisioni

141. Në datën 30.8.2007 nëna e bashkëshortes së subjektit ka lidhur kontratë sipërmarrjeje nr. *** me shoqërinë “A-M” sh.p.k., sipas së cilës në truallin në pronësi të saj me sip. 522 m² do të ndërtohej një pallat 8-katësh. Në marrëveshje është përcaktuar se nëna e bashkëshortes së subjektit do të përfitonte 29% të sipërfaqes ndërtimore të apartamenteve dhe 30% të sipërfaqes ndërtimore të dyqaneve dhe garazheve.

142. Në datën 7.10.2011 nëna e bashkëshortes së subjektit, me deklaratë noteriale nr. ***, ka deklaruar se: *“Në bazë të kontratës së lidhur 29% përfaqëson 8 apartamente, 4 dyqane dhe 2 garazhe. Duke qenë se jam e moshuar këto pasuri i ndava midis tre fëmijëve dhe i vura në dispozicion të firmës ndërtuese në mënyrë që ajo të lidhte kontratat përkatëse me fëmijët e mi.*

- *djalit tim Th.M i kam dhënë 4 apartamente, 2 dyqane dhe 1 garazh;*
- *vajzës sime M.Ç i kam dhënë në pronësi 2 apartamente, vajzës së saj F.Ç i kam dhënë në pronësi 2 dyqane dhe 1 garazh;*
- *vajzës sime V.B i kam dhënë në pronësi një apartament”.*

143. Nga hetimi ka rezultuar se:

- a. Bashkëshortja e subjektit, me kontratë shitjeje nr. ***, datë 20.5.2011, ka blerë nga shoqëria “A-M” sh.p.k. apartamentin me sip. 91.7 m², me nr. pasurie ***, vol. **, f. ***, z. k. ***, Vlorë, si dhe një tarracë të regjistruar në kartelën e pasurisë së paluajtshme me sip. 12.3 m², me çmim 5,410,000 lekë.

Në nenin 5 të kontratës përcaktohet se shuma është likuiduar nga blerësi tek shitësi jashtë kësaj zyre noteriale. Bashkëlidhur kësaj kontrate gjendet kartela e pasurisë, nga ku rezulton se ajo është regjistruar me leje ndërtimi. Në këtë kontratë nuk citohet kontrata e sipërmarrjes së lidhur midis znj. E.M dhe shoqërisë së ndërtimit, si dhe nuk deklarohet se kjo kontratë lidhet si vijimësi e kontratës së sipërmarrjes së lidhur me znj. M.

Nga hetimi ka rezultuar se bashkëshortja e subjektit ka lidhur kontratë nr. ***, datë 4.3.2011, për blerjen e apartamentit të mësipërm në shumën 5,502,000 lekë me shoqërinë “A-M” sh.p.k. Kjo kontratë është revokuar me aktin noterial nr. ***, datë 26.3.2011.

- b. Bashkëshortja e subjektit, me kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 14.3.2011, ka blerë nga shoqëria “A-M” sh.p.k. apartament me sip. 79.25 m², me nr. pasurie ***, z. k. ***, Vlorë, kundrejt çmimit 4,755,000 lekë.

Në nenin 5 të kontratës përcaktohet se shuma është likuiduar nga blerësi tek shitësi jashtë kësaj zyre noteriale. Bashkëlidhur kësaj kontrate gjendet kartela e pasurisë, nga ku rezulton se ajo është regjistruar me leje ndërtimi. Në këtë kontratë nuk citohet kontrata e sipërmarrjes së lidhur midis znj. E.M dhe shoqërisë së ndërtimit, si dhe nuk deklarohet se kjo kontratë lidhet si vijimësi e kontratës së sipërmarrjes së lidhur me znj. M.

Në DPV/2011 bashkëshortja e subjektit ka deklaruar se dy apartamentet i ka përfituar sipas kontratës së sipërmarrjes dhe deklaratës noteriale.

⁵² Kthim përgjigje nr. *** prot., datë 30.8.2017, e Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (gjendur në dosjen e ILDKPKI-së); shkresë nr. *** prot., datë 28.1.2021, drejtuar ASHK-së; kthim përgjigje nr. *** prot., datë 30.3.2021, e ASHK Vlorë; shkresë nr. *** prot., datë 28.1.2019, drejtuar OSHEE-së; kthim përgjigje nr. *** prot., datë 11.2.2021, e FSHU-së; shkresë nr. *** prot., datë 28.1.2021, drejtuar UKV-së; kthim përgjigje nr. *** prot., datë 4.2.2021, e UKV-së; shkresë nr. *** prot., datë 28.1.2021, drejtuar noterit publik A. D; kthim përgjigje noterit publik, datë 25.1.2023.

c. Në lidhje me këto pasuri, në procesverbalin e datës 22.5.2015, në ILDKPKI⁵³, subjekti ka deklaruar: *“Kontrata e sipërmarrjes, ashtu siç është deklaruar nga ime, është nënshkruar nga E.M, për faktin se ajo është pronarja e truallit. Kur është bërë ndarja e apartamenteve kanë kaluar në emër të gruas dhe vajzës, ashtu siç është rënë dakord me marrëveshje nga ana e tyre. Deklarata noteriale është nënshkruar më vonë, për të qenë në rregull me mënyrën e përfitimt të këtyre aseteve nga ana ime”*.

d. Në lidhje me këto pasuri, subjekti, në përgjigje të pyetësorit të datës 26.1.2023, ka sqaruar se: *“Në datën 30.8.2007 është lidhur kontratë sipërmarrje me nr. *** rep., nr. *** kol., me palë E.A.M, si pronare trualli (porositës) dhe palë sipërmarrëse + investitor “A-M” sh.p.k. dhe P.E... Në kontratën e shkëmbimit nr. *** rep., nr. *** kol., datë 12.2.2011, notere A. D, citohet: “...pronarja ia jep këtë truall “A-M” sh.p.k. në këmbim të ambientit të poshtëcituar:*

*“Në objektin që po ndërtohet sipas vendimit të KRRT-së me leje ndërtimi nr. ***, datë 24.2.2009, objekt 2-4-6-8 kate, në lagjen “D”, Vlorë: një apartament i ndodhur në z. k. ***, Vlorë, me nr. pasurie ***, vol. **, f. ***, me sip. 62.8 m²; si dhe një shumë lekësh.”*

Po në këtë datë nga ana e shoqërisë “A-M” sh.p.k. është bërë “deklarimi”, me përmbajtje si më poshtë:

“...Në kontratën e këmbimit të lidhur midis nesh si shoqëri dhe pronares së truallit E.M është shënuar që ajo merr si pjesë një hyrje 1+1 në katin e katërt, si dhe një shumë parash.

Në fakt shuma e parave nuk i është dhënë, por ajo përfaqëson 7 apartamente, 4 dyqane dhe 2 garazhe, të cilat do t’u jepen fëmijëve të saj Th.M, M.Ç dhe V.B, sipas marrëveshjes që kanë bërë ata vetë.

Ky deklarim bëhet për të zhdukur çdo keqkuptim që mund të lindë me kontratën e këmbimit.

Ai bëhet me vullnetin tim të lirë e firmoset rregullisht, secila palë mban edhe një kopje.”

Në vazhdim të këtij argumenti, sqaroj se lidhur me kontratat e shitblerjeve të poshtëshënuara:

*1. kontratë shitblerjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 14.3.2011, me palë shitëse shoqëria “A-M” sh.p.k. dhe palë blerëse F.Ç, të pasurisë nr. ***-N*, z. k. ***, njësi, me sip. 21.7 m², në Vlorë;*

*2. kontratë shitblerjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 14.3.2011, me palë shitëse shoqëria “A-M” sh.p.k. dhe palë blerëse F.Ç, të pasurisë nr. ***-G*, z. k. ***, garazh, me sip. 24.5 m², në Vlorë;*

*3. kontratë shitblerjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 14.3.2011, me palë shitëse shoqëria “A-M” sh.p.k. dhe palë blerëse F.Ç, të pasurisë nr. **-N*, z. k. ***, njësi, me sip. 37.6 m², në Vlorë;*

*4. kontratë shitblerjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 14.3.2011, me palë shitëse shoqëria “A-M” sh.p.k. dhe palë blerëse M.Ç, të pasurisë nr. ***, z. k. ***, apartament, me sip. 79.25 m², në Vlorë;*

*5. kontratë shitblerjeje nr. *** rep., nr.*** kol., datë 14.3.2011, me palë shitëse shoqëria “A-M” sh.p.k. dhe palë blerëse M.Ç, të pasurisë nr. ***, z. k. ***, apartament, me sip.91.7 m², në Vlorë,*

– vlera në lekë e tyre është shuma e lekëve të përcaktuar në kontratën e këmbimit të lidhur midis E.M dhe shoqërisë “A-M” sh.p.k., e konfirmuar nga kjo e fundit me “deklarimin” e saj datë 12.2.2011.

*Me deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 26.12.2020, noter A.Xh, A.C deklaroi: “...Av. Petraç Çuri ka paguar vlerën e materialeve në masën dhe 100,000 lekë për apartamentin në Vlorë...”*

⁵³ Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 3.3.2021, të ILDKPKI-së.

*Pasuria nr. ***, z. k. ***, Vlorë, është mobiluar nga vjehrra ime në momentin kur i ka kaluar në pronësi nga shoqëria "A-M" dhe aktualisht përdoret prej saj për banim. Kjo pasuri ka kaluar në pronësi të vajzës sime F.Ç, me kontratë dhurimi nga vjehrra ime E.M, datë 29.3.2014, me nr. ***, rep., nr. *** kol., notere S.H".*

144. Subjekti ka depozituar:

- Kontratë shkëmbimi trualli nr. ***, datë 12.2.2011, të lidhur midis shtetasës E.M, në cilësinë e pronares së truallit, dhe shoqërisë ndërtuese që ka shërbyer për kalimin e pronësisë së truallit në favor të shoqërisë së ndërtimit (objektit të ndërtuar). Në këtë kontratë përcaktohet se *pronarja ia jep këtë truall shoqërisë "A-M" sh.p.k. në këmbim të një apartamenti të ndodhur në z. k. ***, me nr. pasurie ***, me sip. 62.8 m², si dhe një shumë lekësh.*
- Kopje të një deklaratë dore që mban datën 12.2.2011 të administratorit të shoqërisë "A-M" sh.p.k., z. A.M, me përmbajtje: *"Në kontratën e këmbimit të lidhur midis nesh si shoqëri dhe pronares së truallit E.M është shënuar që ajo merr si pjesë një hyrje 1+1 në katin e 4-t, si dhe një shumë parash. Në fakt, shuma e parave nuk i është dhënë, por ajo përfaqëson 7 (shtatë) apartamente dhe 4 (katër) dyqane, si dhe dy garazhe, të cilat do t'u jepen fëmijëve të saj, Th.M, M.Ç dhe V.B, sipas marrëveshjes që kanë bërë ata vetë. Ky deklaram bëhet për të zhdukur çdo keqkuptim që mund të lindi me kontratën e këmbimit. Ai bëhet me vullnetin tim të lirë e firmoset rregullisht, secila palë mban edhe një kopje".*
Edhe sikur kjo deklaratë të merret e mirëqenë nuk rezulton që znj. F.Ç të ketë qenë pjesë e kësaj deklaratë, për rrjedhojë pasuritë e blera prej saj nuk provohet se rrjedhin nga kjo marrëveshje.
- Kopje të testamentit nr. ***, datë 20.9.2007, sipas së cilës shtetasja E.M ia lë në trashëgimi në mënyrë të barabartë tokën truall vajzës së saj M.Ç dhe djalit të saj Th.M.
- Vendimi nr. ***, datë 13.3.1996, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.
- Shkresë kthim përgjigje e shoqërisë "A-M" sh.p.k., datë 20.2.2023, sipas së cilës sipërfaqja totale e përfutur nga shtetasja E.M është 713.5 m² apartamente + dyqane dhe 2.5 garazhe.
- Vendim nr. ***, datë 24.2.2009, i KKRRT-së.
- Leje ndërtimi datë 16.6.2009.
- Akt kolaudimi.
- Leje shfrytëzimi datë 17.11.2010.
- Foto të pasurisë nr. ***, z. k. ***, Vlorë.
- Deklaratë noteriale nr. ***, datë 26.12.2020, e shtetasit A.C, i cili deklaron se ka mobiluar një apartament të subjektit në Vlorë rreth fillimit të vitit 2010 në shumën 100,000 lekë.

Kjo deklaratë noteriale nuk përputhet me kontratat e nënshkruara nga vajza dhe bashkëshortja e subjektit, pasi apartamentet janë përfutur në vitin 2011 dhe nuk kishte si ky apartament të mobilohet në vitin 2010, ku ai nuk ishte ende i përfunduar apo i blerë nga ana e familjarëve të subjektit. Ky fakt provohet edhe me aktin e kolaudimit të objektit ku ndodhet pallati që është hartuar në gusht të vitit 2010, si dhe me lejen e shfrytëzimit të objektit.

Për sa më sipër, duket se subjekti ka depozituar një deklaratë noteriale që nuk përmban të dhëna të vërteta për sa kohë mobilimi i hyrjes nuk ishte i mundur të kryhej fizikisht, duke i kaluar barra e provës.

145. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, konstaton se ato nuk përputhen me përmbajtjen e kontratave, si dhe me veprimet e znj. M. Më konkretisht, në të gjitha kontratat thuhet se shuma është likuiduar nga blerësi tek shitësi jashtë zyrës noteriale. Në asnjë prej këtyre kontratave nuk citohet kontrata e shkëmbimit të truallit apo vlera në lekë e pretenduar nga subjekti. Subjekti ka depozituar një deklaratë dore të shoqërisë "A-M" sh.p.k., e cila nuk përputhet me vetë deklaratën noteriale të znj. M, në të cilën ajo shprehet se apartamentet i vuri në dispozicion të firmës ndërtuese për të lidhur kontratat dhe nuk citon në asnjë pikë të saj që vlera në lekë e kontratës së shkëmbimit është konvertuar në këto apartamente.

146. Në lidhje me deklaratën e depozituar nga subjekti të shoqërisë “A-M” sh.p.k., Komisioni, duke marrë në konsideratë se:

1. kjo deklaratë është me shkrim dore dhe jo në formë noteriale;
2. kjo deklaratë nuk kishte asnjë arsye të mos ishte noteriale, për sa kohë pretendohet nga subjekti që është bërë në të njëjtën datë me kontratën e shkëmbimit të truallit;
3. në kontratën e shkëmbimit të truallit nuk përcaktohet që vlera në lekë do të konvertohet në apartament për fëmijët e znj. M;
4. kjo deklaratë është depozituar nga subjekti vetëm pas pyetësorit të parë;
5. kjo deklaratë por edhe kontratat e shitje blerjes nuk janë dorëzuar nga subjekti gjatë plotësimit të deklaratës *Vetting*;
6. kjo deklaratë nuk përputhet me deklaratën noteriale të znj. E.M;
7. kjo deklaratë nuk përputhet me përmbajtjen e kontratave të shitblerjes,

– vlerëson se ajo është përgatitur nga subjekti gjatë procesit të rivlerësimit me qëllim arritjen e një rezultati pozitiv nga ana e tij.

147. Komisioni ka kryer një analizë financiare⁵⁴ në lidhje me mundësinë e blerjes së këtyre apartamenteve, si dhe të pasurive të vajzës së subjektit të trajtuar më poshtë në këtë vendim. Nga analiza financiare subjekti dhe familjarët e tij rezultojnë me mungesë burimesh të ligjshme në shumën 19,084,457 lekë. Në analizën financiare janë përfshirë:

- të ardhurat e subjektit nga paga;
- të ardhurat e bashkëshortes së subjektit nga paga;
- të ardhurat nga llogaria bankare e nënës së subjektit;
- të ardhurat nga interesat bankarë;
- shpenzimet jetike të përllogaritura sipas shkresës ref. nr. ***prot., datë 29.1.2019, të ILDKPKI-së. Shpenzimet jetike të vajzës së subjektit për ditë qëndrimi në Mbretërinë e Bashkuar janë ngarkuar në zërin “TIMS F.Ç” dhe ditët e qëndrimit në Shqipëri janë ngarkuar në zërin “shpenzime jetike të përllogaritura për 3 persona”.

148. Në lidhje me këto dy pasuri të bashkëshortes së subjektit, Komisioni i ka kaluar barrën e provës, si vijon:

- i. Bashkëshortja e subjektit ka blerë pasuritë e mësipërme, të cilat do të përfshihen në analizë financiare.
- ii. Subjekti nuk ka qenë i saktë në deklarinimin e tij në deklaratën *Vetting*.
- iii. Subjekti nuk ka depozituar dokumentacionin e përfitimit të këtyre pasurive në deklaratën *Vetting*, duke fshehur kontratat e blerjes.
- iv. Subjekti nuk ka depozituar foto të plota të këtyre pasurive (ku të dilnin qartë ndarjet e tyre dhe pozicionimi i tyre me objektin ku kanë ndërtuar dhe rrugën), sikundër i është kërkuar nga Komisioni, duke u konsideruar si mungesë bashkëpunimi në kuptim të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016.
- v. Subjekti gjatë hetimit ka depozituar një deklaratë fiktive të shoqërisë “A-M” sh.p.k.
- vi. Nga analiza financiare bashkëshortja e subjektit nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për blerjen e këtyre pasurive në shumën 19,084,457.83 lekë.

149. Pas kalimit të barrës së provës, subjekti⁵⁵ ka parashtruar të njëjtat pretendime si gjatë hetimit administrativ, duke pretenduar se vlera në lekë e kontratave është shuma e lekëve të përcaktuara në kontratën e këmbimit të lidhur midis shtetases E.M dhe shoqërisë “A-M”

⁵⁴ Shihni tabelën nr. 9 të rezultateve të hetimit.

⁵⁵ Për më shumë, referohuni në prapësimet dhe provat e depozituara nga subjekti pas dërgimit të rezultateve të hetimit, si dhe gjatë seancës dëgjimore.

sh.p.k., e konfirmuar nga kjo e fundit me “deklarimin” e saj datë 12.2.2011. Subjekti ka vijuar argumentimin e tij se në të njëjtën mënyrë ka vepruar edhe vëllai i bashkëshortes së tij duke depozituar dhe kontratat përkatëse.

150. Në lidhje me deklaratën noteriale të z. C subjekti sqaron se të gjithë pronarët e truallit që përfituan apartamente kanë hyrë të parët në pallat, menjëherë pas përfundimit të tij. Kjo për faktin se për ta firma e ndërtimit paguante qiratë e shtëpive ku ata qëndronin derisa pallati u ndërtua. Pallati përfundoi së ndërtuari rreth fundvitit 2009. Viti 2011 është viti ku firma i pajisi me dokument pronësie, i cili u zgjat pak në kohë nga momenti kur ndërtimi i pallatit përfundoi. Konkretisht, ai ka filluar të banojë në atë pallat menjëherë pas shitjes, datë 27.10.2010, të banesës që kishte përfituar nga privatizimi i banesave dhe në këtë datë shtëpia ka qenë e mobiluar, sikurse është edhe sot.

151. Lidhur me deklaratën e shoqërisë “A-M” sh.p.k., datë 12.2.211, subjekti sqaron se ky akt është redaktuar nga një subjekt privat dhe ka vlerën e provës, pasi është me firmë e vulë të shoqërisë “A-M” sh.p.k., nuk është kontestuar/kontestohet nga vjehrra e tij/fëmijët e saj që e kanë pranuar dhe ai që e ka lëshuar. Me deklaratë noteriale nr. ***, datë 11.4.2023, notere E. R.T, shoqëria “A-M” sh.p.k., përfaqësuar nga administratori dhe ortaku i vetëm i shoqërisë A. M, deklaroi: *“Unë deklaruesi, shoqëria “A-M” sh.p.k., përfaqësuar nga administratori dhe ortaku i vetëm i shoqërisë A.M, në datën 12.2.2011, kam nënshkruar deklaratë të thjeshtë lidhur me objektin e ndërtuar nga shoqëria jonë në truallin e pronares E.M, ndodhur në Vlorë, deklaratë e lëshuar në datën që përmban ky akt, për të sqaruar mënyrën e realizimit të kontratës së shkëmbimit me këtë pronar truall dhe fëmijëve të saj. Deklarata që i referohemi është shkruar në formë të thjeshtë duke qenë se subjekti është person juridik dhe është vulosur e nënshkruar në përputhje me ligjin, kopje të deklaratës bashkëlidhur këtij akti. Këtë deklaratë e lëshoj me vullnet të lirë në mbështetje të deklarimeve të bëra në datën 12.2.2011”.*

152. Subjekti pretendon se kontratat e shitblerjes të lidhura midis shoqërisë “A-M” sh.p.k. dhe bashkëshortes së tij M.Ç e vëllait të saj Th.M, si dhe motrës V.B, në fakt konsiderohen kontrata dhurimi dhe jo shitblerjeje.

153. Subjekti ka depozituar edhe një analizë për vitin 2011 në prapësimet shtesë në seancë dëgjimore, duke pretenduar se shpenzimet e shkollimit të vajzës ishin në vlerën 516,011 lekë.

Subjekti ka vënë në dispozicion të Komisionit:

- i. kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 21.4.2011;
- ii. kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 21.4.2011;
- iii. kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 14.3.2011;
- iv. kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 14.3.2011.
- v. deklaratë noteriale nr. ***, datë 11.4.2023, të shoqërisë “A-M” sh.p.k., në të cilën deklarohet: *“Unë deklaruesi shoqëria “A-M” sh.p.k., përfaqësuar nga administratori dhe ortaku i vetëm i shoqërisë A.M deklaroj se në datën 12.2.2011 kam nënshkruar deklaratë të thjeshtë lidhur me objektin e ndërtuar nga shoqëria jonë në truallin e E.M...”*

154. Komisioni fillimisht verifikoi kontratat e depozituara nga subjekti pas kalimit të barrës së provës. Më konkretisht:

- i. Kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 21.4.2011, lidhur midis shoqërisë “A-M” sh.p.k. dhe shtetasit Th.M për blerje garazhi me sip. 17.5 m², me nr. pasurie ***-G*, z. k. ***. Çmimi i shitjes: 722,800 lekë. Në nenin 5 specifikohet se shuma është likuiduar nga shitësi te blerësi jashtë kësaj zyre noteriale.
- ii. Kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 21.4.2011, lidhur midis shoqërisë “A-M” sh.p.k. dhe shtetasve Th dhe J.M për blerje apartamenti me sip. 90 m², me nr. pasurie ***, z. k. ***. Çmimi i shitjes: 5,310,000 lekë. Në nenin 5 specifikohet se shuma është likuiduar nga shitësi te blerësi jashtë kësaj zyre noteriale.

- iii. Kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 14.3.2011, lidhur midis shoqërisë “A-M” sh.p.k. dhe shtetases M.M për blerje apartamenti me sip. 62.8 m², me nr. pasurie ***, z. k. ***. Çmimi i shitjes: 3,768,000 lekë. Në nenin 5 specifikohet se shuma është likuiduar nga shitësi te blerësi jashtë kësaj zyre noteriale.
- iv. Kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 14.3.2011, lidhur midis shoqërisë “A-M” sh.p.k. dhe shtetases M.M për blerje apartamenti me sip. 63.3 m², me nr. pasurie ***, z. k. ***. Çmimi i shitjes: 3,798,000 lekë. Në nenin 5 specifikohet se shuma është likuiduar nga shitësi te blerësi jashtë kësaj zyre noteriale.

155. Këto kontrata kanë të njëjtin format si kontrata e lidhur nga bashkëshortja e subjektit dhe vajza e tij. Komisioni konstaton se shtetasi Th.M ka lidhur vetëm 4 kontrata shitblerjeje për 3 apartamente dhe një garazh, ndërkohë në deklaratën noteriale të shtetases E.M thuhet se ai do të përfitojë 4 apartamente, 2 dyqane dhe 1 garazh.

156. Këto kontrata nuk provojnë se janë lidhur në vijimësi të kontratës së shkëmbimit të lidhur midis shtetases E.M dhe shoqërisë “A-M” sh.p.k. Referuar Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, neneve 659, 660, 663 dhe 690, ky trup gjykues vlerëson se nuk ekziston asnjë shkak ligjor që të vërë në dyshim vërtetësinë e fakteve të përshkruara në kontratat noteriale, përfshirë këtu edhe likuidimin e çmimit të tyre. Për rrjedhojë, në analizën financiare të subjektit pasuritë e përfituara nga bashkëshortja dhe vajza e tij do të konsiderohen të blera dhe të likuiduara sipas çmimeve të nënshkruara me vullnet të lirë nga palët.

157. Për sa i përket deklaratës jonoteriale të shoqërisë “A-M” sh.p.k., Komisioni vlerëson se ajo nuk mund të merret në konsideratë për arsyet e listuara në pikën 146 të këtij vendimi, duke u krijuar bindja se ajo është përgatitur nga subjekti gjatë procesit të rivlerësimit me qëllim arritjen e një rezultati pozitiv nga ana e tij. Ky veprim i subjektit do të merret në konsideratë në vlerësimin tërësor të procedurave.

158. Në lidhje me deklaratën noteriale nr. ***, datë 26.12.2020, të shtetasis A.C, Komisioni konstaton se shpjegimet e subjektit janë në nivel deklarativ dhe të pashoqëruara me dokumentacion provues për të provuar që subjekti ka hyrë në këtë banesë në vitin 2010, ndërkohë që ai si adresë banimi në deklaratat periodike ka deklaruar banesën në Tiranë dhe si adresë në gjendje civile adresën e apartamentit në qytetin e Vlorës në rajonin nr. *. Ky deklaram është konfirmuar nga subjekti edhe në pyetësorin standard. Për sa më sipër, rezulton se subjekti gjatë hetimit administrativ ka depozituar një deklaratë noteriale që nuk përmban të dhëna të vërteta për sa kohë mobilimi i hyrjes nuk ishte i mundur të kryhej fizikisht. Ky veprim i subjektit do të mbahet në konsideratë në vlerësimin tërësor të procedurave.

159. Subjekti sërish ka refuzuar të paraqesë foto të plota të pasurive të bashkëshortes dhe vajzës së tij, duke u bërë pengesë për Komisionin për kryerjen e një procesi të plotë rivlerësimi për kriterin e pasurisë. Ky veprim i subjektit konsiderohet si mungesë bashkëpunimi në kuptim të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016 dhe do të mbahet në konsideratë në vlerësimin tërësor të procedurave.

160. Në lidhje me pretendimin se shpenzimet e vajzës në vitin 2011 janë në shumën 516,011 lekë nga verifikimi i llogarive bankare të subjektit në BKT rezulton se ai ka transferuar shumat e mëposhtme:

- datë 14.10.2010, shuma 4,000 GBP, me emërtimin “*Study Payment*”;
- datë 24.3.2010, shuma 2,000 GBP, me emërtimin “*Study Payment*”;
- datë 6.7.2010, shuma 1,000 GBP, me emërtimin “*Study Payment*”.

Pra, në total 7,000 GBP ose 1,034,471 lekë.

161. Në përfundim, në lidhje me pasuritë e mësipërme rezulton se:

- i. Bashkëshortja e subjektit ka kryer deklaram të pasaktë në deklaratën *Vetting*, pasi ka deklaruar se këto pasuri i ka përfituar me kontratë sipërmarrjeje, lidhur në Vlorë, datë 30.8.2007, me nr. *** dhe deklaratë noteriale nr. ***, datë 7.10.2011.
- ii. Subjekti ka fshehur duke mos i deklaruar në deklaratat periodike vjetore, përpara ILDKPKI-së, si dhe në deklaratën *Vetting* kontratat e shitblerjes të nënshkruara midis shoqërisë “A-M” sh.p.k. dhe familjarëve të tij. Gjithashtu, ai nuk i ka depozituar këto kontrata, të cilat kanë shërbyer për kalimin e pronësisë së pasurive të familjarëve të tij.
- iii. Nga analiza financiare bashkëshortja e subjektit nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për blerjen e këtyre pasurive në shumën 19,084,457.83 lekë.
- iv. Subjekti nuk është treguar bashkëpunues me Komisionin në kuptim të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016.
- v. Subjekti, më shumë se një herë, ka paraqitur dokumente që nuk përmbajnë të dhëna të vërteta me qëllim arritjen e një rezultati pozitiv të procesit të tij të rivlerësimit.

162. Komisioni çmon se subjekti: (i) ka kryer deklaram të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin në lidhje me pasuritë e përfituara nga bashkëshortja e tij; (ii) ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar blerjen e këtyre pasurive 19,084,457.83 lekë.

Si rrjedhojë, subjekti ka kryer deklaram të pasaktë, të paplotë dhe të pamjaftueshëm për këtë pasuri, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe shkronjave “a” dhe “b” të nenit 33/5 të ligjit nr. 84/2016.

163. Komisioni, për të qenë sa më ezaurues me subjektin, ka kryer edhe një analizë financiare hipotetike për vitin 2011, duke mos përfshirë vlerën e apartamenteve dhe sërish subjekti rezulton me një bilanc negativ në shumën 2,577,957 lekë.

164. Tokë bujqësore⁵⁶ në Dh, Vlorë, pjesë zotëruese ideale e pandarë 1/6, sip. 8860 m², e paregjistruar në ZVRPP Vlorë, dhuruar nga nëna e bashkëshortes së subjektit, znj. E.M. Pjesa takuese: 100%.

Konstatimi i ILDKPKI-së

- *Nuk është e qartë arsyeja e dhurimit nga E.M e pjesës takuese prej 1/6 në tokën me sip. 8.860 m², në Dh, Vlorë, të trashëguar nga babai i saj vetëm vajzës M.Ç, ndërkohë që ajo ka edhe fëmijë të tjerë.*

Hetimi⁵⁷ dhe analiza financiare-juridike e kryer nga Komisioni

165. Në datën 3.1.2013, me kontratë dhurimi nr. ***, datë 3.1.2013, nëna e bashkëshortes së subjektit i ka dhuruar bashkëshortes së tij pjesën e saj që i takon 1/6 pjesë ideale të pandarë të pasurisë me sipërfaqe totale prej 8860 m².

Këtë pasuri nëna e bashkëshortes së subjektit e ka përfituar me dëshmi trashëgimie nr. ***, datë 19.9.2001 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Prona është ende e paregjistruar në ZVRPP Vlorë dhe është përfituar në bazë të AMTP-së nr. ***, datë 19.2.2001, në emër të trashëgimlënësit A.L.

⁵⁶ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: (i) kontratë dhurimi nr. **, datë 3.1.2013. (ii) AMTP-në nr. ***, datë 19.11.2001; (iii) vendim nr. ***, datë 15.9.2001, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

⁵⁷ Kthim përgjigje nr. *** prot., datë 30.8.2017, e Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (gjendur në dosjen e ILDKPKI-së); shkresë nr. *** prot., datë 28.1.2021 drejtuar ASHK; kthim përgjigje nr. *** prot., datë 30.3.2021, e ASHK-së Vlorë; shkresë nr. *** prot., datë 28.1.2019, drejtuar OSHEE-së; kthim përgjigje nr. *** prot., datë 11.2.2021, e FSHU-së; shkresë nr. *** prot., datë 28.1.2021, drejtuar UKT-së; kthim përgjigje nr. *** prot., datë 4.2.2021, e UKV-së; shkresë nr. *** prot., datë 28.1.2021, drejtuar noterit publik A.D; kthim përgjigje noterit publik datë 25.1.2023.

166. Në vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, nëpërmjet të cilit është vendosur lëshimi i dëshmisë së trashëgimisë, konstatohet se i ndjeri A.L ka ndërruar jetë në datën 27.10.1970, duke e bërë të paqartë përfitimin e tokës bujqësore nga ana e tij në cilësinë e kryefamiljarit.

167. Në lidhje me këtë konstatim, subjekti, në përgjigje të pyetësorit të datës 26.1.2023, ka sqaruar se: *“E.A.M, sipas vendimit nr. ***, datë 19.9.2001, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, me objekt “Lëshim dëshmi trashëgimie, është trashëgimtare ligjore e radhës së parë të babait të saj, A.M.L, në masën 1/6 pjesë, të pasurisë së tij të luajtshme dhe të paluajtshme”. Ky vendim përcakton vetëm trashëgimtarët ligjorë të radhës së parë dhe pjesën e secilit mbi pasurinë e tij trashëgimore... Akti i marrjes së tokës në pronësi, nr. regjistrimi akti ***, datë 19.11.2001, është lëshuar nga komisioni i ndarjes së tokës së fshatit Dh, sipas kërkesës së (dajave) vëllezërve të vjehrrës sime E.M. Ligjin nr. 7501, datë 19.7.1991 “Për tokën”, në fshatin Dh, komisioni i ndarjes së tokës nuk e zbatoi. Toka bujqësore u nda sipas pronarëve të vjetër. Është kjo arsyeja që A.L, babai i vjehrrës sime përfitoi tokë bujqësore, pavarësisht se kishte vdekur në vitin 1970. Të gjitha problemet ligjore që janë evidentuar në dhënien e AMTP-ve janë të rregulluara me ligjin nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë” dhe VKM-në Nr. 1174, datë 24.12.2020, “Për procedurat e regjistrimit të AMTP-ve, saktësimin e kufijve e sipërfaqeve, si dhe normat për sipërfaqet shtetërore shitesë e pronat shërbyese”, që ka dalë në funksion të këtij ligji.”*

168. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, konstaton se nga ana e tij:

- a. Nuk u është dhënë përgjigje e plotë pyetjeve të Komisionit⁵⁸, duke mos u deklaruar:
 - arsyet e dhurimit të kësaj pasurie të bashkëshortja e subjektit, pasi në kontratën e dhurimit nuk përcaktohen arsye;
 - për çfarë është përdorur/përdoret kjo pasuri, si dhe nëse janë kryer investime ose ndërtime në këto pasuri, pavarësisht faktit se nga kush janë kryer, pasi bashkëshortja e subjektit është pronare e 1/6 pjesë takuese të pandarë të kësaj pasurie.
- b. Është refuzuar të depozitohet foto e kësaj pasurie ku të dalin qartë të gjitha parcelat dhe pozicionimi i tyre me rrugën.

Për sa më sipër, subjekti duket se nuk është treguar bashkëpunues me Komisionin në kuptim të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016. Gjithashtu, në lidhje me këtë pasuri, për Komisionin mbetet e paqartë arsyeja e lëshimit të AMTP-së në emër të një personi që ka ndërruar jetë.

169. Në lidhje me këto konstatime, subjekti sqaroi se sa i përket kontratës së dhurimit nr. * rep., nr. * kol., datë 3.1.2013, notere M.D shpreh vullnetin dhe motivin e nënës së bashkëshortes, sipas përcaktimeve në këtë kontratë dhurimi. Nga ana e vjehrrës E.M dhe bashkëshortes së tij nuk është përdorur dhe as përdoret asnjë parcelë e kësaj AMTP-je. Ai dhe bashkëshortja e tij nuk e dinë saktë se ku janë një pjesë e këtyre parcelave dhe nuk mund të vënë në dispozicion foto të parcelave.

170. Në lidhje me refuzimin për depozitimin e fotove të kësaj pasurie, subjekti deklaroi: *“Ky konceptim i juaji është i gabuar, pasi refuzimi konceptohet “që nuk dua t’ju tregoj parcelat”, kurse mosdijenja është një konceptim tjetër “unë nuk kam mundësi objektive t’ju tregoj pasi nuk i di”. Parcelat janë të paregjistruara dhe është fakt i njohur botërisht ky problem në zonën e bregdetit, ato janë të shpërndara në parcela të ndryshme dhe të pakufizuara për t’u individualizuar.”*

171. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, konstaton se ai sërish nuk ka paraqitur foto të kësaj pasurie. Argumentimi i tij se nuk ka dijeni ku ndodhet pasuria nuk është bindës, si dhe nuk është i mbështetur në prova. Subjekti ka detyrimin ligjor që të jetë bashkëpunues

⁵⁸ Shihni pyetësorin datë 26.1.2023.

me Komisionin dhe, në këtë rast, ai duhet të depozitonte foto të kësaj pasurie në mënyrë të tillë që Komisioni të bënte një vlerësim të plotë të saj. Komisioni vlerëson se subjekti është përpjekur ta paraqesë në mënyrë të pasaktë këtë pasuri ose të fshehtë ndonjë investim të mundshëm në të, për sa kohë nuk i është përgjigjur kërkesave të Komisionit. Statusi i tij, si dhe eksperiencia e tij si avokat, por edhe si gjyqtar i krijon mundësi jo vetëm të evidentojë pasurinë, por dhe të japë përgjigje për të, për sa kohë është një pasuri në pronësi të bashkëshortes së tij. Subjekti nuk dha asnjë shpjegim se cila ka qenë arsyeja që kjo pasuri e ka origjinën nga një AMTP e lëshuar në emër të një personi që ka ndërruar jetë vite më parë.

172. Në përfundim, sa i përket kësaj pasurie, Komisioni vlerëson se subjekti nuk është treguar bashkëpunues në kuptim të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, duke refuzuar të japë shpjegime shteruese në lidhje me këtë pasuri si dhe mënyra e fitimit të kësaj pasurie me një AMTP në emër të një personi që ka ndërruar jetë mbetet e paqartë.

Si rrjedhojë, subjekti ka kryer deklaram të pasaktë, të paplotë dhe të pamjaftueshëm për këtë pasuri, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe germës “a” të nenit 33/5 të ligjit nr. 84/2016.

173. Depozitë⁵⁹ në “Intesa Sanpaolo Bank”, datë krijimi 16.3.2012, shuma 1,000,000 lekë. 141,696 lekë interesat bankarë deri në datën 20.10.2016. Vlera: 1,141,696 lekë. Pjesa takuese: 100%.

Burimi sipas deklaratës *Vetting*: kursime nga paga si punonjëse e “P.D” sh.a., Vlorë.

174. Depozitë në “Intesa Sanpaolo Bank”, datë krijimi 31.7.2014, shuma 4,600,000 lekë. 215,578 lekë nga interesat bankarë deri në datën 20.10.2016. Vlera: 4,815,578 lekë. Pjesa takuese: 100%.

Burimi sipas deklaratës *Vetting*:

- a. 1,882,326 lekë, shumë e krijuar nga depozita prej 1.800.000 lekësh, krijuar në datën 8.2.2013 nga të ardhurat neto shërbim fjetje dhoma Dh, viti 2012, si dhe interesat bankarë prej 82,326 lekësh;
- b. 750,000 lekë të ardhura nga shitja e pasurisë nr. ***, z. k. ***, sip. 75 m²;
- c. 230,000 lekë, të ardhura nga dhënia njësi me qira, viti 2013;
- d. 1,700,000 lekë, të ardhura neto shërbim fjetje dhoma Dh, viti 2013;
- e. diferenca nga kursimet.

Hetimi⁶⁰ dhe analiza financiare-juridike e kryer nga Komisioni

175. Nga nxjerrja e llogarisë së bashkëshortes së subjektit në “Intesa Sanpaolo Bank” në lekë rezulton se:

- i. në datën 16.3.2012 ka krijuar depozitë në shumën 1,000,000 lekë;
- ii. në datën 8.2.2013 ka depozituar shumën 1,800,000 lekë;
- iii. në datën 31.7.2014 ka depozituar shumën 2,717,700 lekë, e cila së bashku me depozitën e mësipërme ka shërbyer për krijimin e depozitës në shumën 4,600,000 lekë.

176. Në DPV/2014 bashkëshortja e subjektit ka deklaruar si burim:

- a. Vlera 1,800,000 lekë, depozitë e deklaruar në vitin 2012 + interesa bankarë

Bashkëshortja e subjektit në DPV/2013 ka deklaruar si burim për këtë depozitim të ardhurat neto të përfituara nga shërbimi fjetje dhënie dhoma me qira, deklaruar në vitin 2012. Në lidhje

⁵⁹ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës shkresën e datës 20.10.2017 të “Intesa Sanpaolo Bank”.

⁶⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 28.1.2021, drejtuar bankave dhe institucioneve financiare; kthim përgjigje nr. *** prot., datë 16.2.2021, nga “Intesa Sanpaolo Bank”.

me të ardhurat nga shërbimi fjetje, Komisioni është shprehur në pikën 135-138 të këtij vendimi.

Në lidhje me shumën 1,800,000 lekë, konstatohet se subjekti nuk ka deklaruar gjendje *cash* në asnjë nga deklaratat periodike, përfshirë edhe vitin 2012. Nga ana tjetër, bazuar në analizën financiare të vitit 2012, edhe sikur të ishte deklaruar gjendje *cash*, subjekti nuk ka pasur mundësi financiare në shumën 605,139 lekë, për rrjedhojë Komisioni nuk do të përfshijë në analizë financiare si kursim *cash* shumën 1,800,000 lekë.

b. Vlera 750,000 lekë, e ardhur nga shitja e apartamentit 2+1, deklaruar në vitin 2013. Kjo vlerë është përfshirë në analizën financiare.

c. Vlera 230,000 lekë, e ardhur nga dhënia e njësisë me qira, deklaruar në vitin 2013.

Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar të ardhura nga qiradhënia në vlerën 296,000 lekë. Për të provuar këtë deklaram ai ka depozituar kontratën e qirasë nr. ***, datë 11.2.2013, sipas së cilës vajza e tij ka dhënë me qira njësinë me sip. 37.6 m² për periudhën 15.2.2013 – 15.2.2015, në shumën 22,000 lekë/muaj.

Në lidhje me këtë marrëdhënie qiraje, subjekti, në përgjigje të pyetësorit datë 26.1.2023, ka deklaruar se: *“Me kontratën nr. *** rep. dhe nr. *** kol., datë 11.2.2013, është lidhur kontratë qiraje me shtetasin V.K. Kjo kontratë do të fillonte në datën 15.2.2013 deri në datën 15.2.2015, me vlerë qiraje 22,000 lekë/muaj.*

Pala qiramarrëse do të ushtronte aktivitetin e shitjes së bojërave dhe materiale të tjera ndërtimi.

Duke qenë se ai ushtronte aktivitet privat mori përsipër edhe pagesën e tatimit mbi qiranë. Nga ana jonë, marrja e detyrimeve tatimore për ta paguar qiramarrësi u reflektua në vlerën e qirasë mujore që e zbritëm nga 25,000 lekë/muaj në 22,000 lekë/muaj.

Kjo u bë me një marrëveshje verbale mes nesh dhe në dijeninë tonë u pagua nga qiramarrësi, pasi edhe organet tatimore që kontrollonin subjektin qiramarrës nuk konstatuan shkelje në pagimin e detyrimeve tatimore.”

Në lidhje me këto të ardhura, për sa kohë nuk provohet pagimi i detyrimeve tatimore dhe vetë subjekti ka pranuar që ato nuk janë paguar duke pretenduar se ka ulur çmimin e qirasë, Komisioni vlerëson të mos i përfshijë në analizën financiare. Pretendimet e subjektit që çmimi është ulur me qëllim zbritjen e detyrimeve tatimore është në nivel deklarativ, për sa kohë kontrata ka të specifikuar çmimin 22,000 lekë.

Në përfundim, të ardhurat nga dhënia me qira e njësisë nuk do të përfshihen në analizë financiare.

d. Vlera 1,700,000 lekë, e ardhura neto, shërbim fjetje dhoma Dh, viti 2013.

Në lidhje me vlerën 1,700,000 lekë, si e ardhur nga shërbimi dhënie dhoma plazhi fjetje në Dh, vlerësimi i Komisionit është bërë në pikën 135-138 të këtij vendimi. Përveç këtij vlerësimi, konstatohet se subjekti nuk ka deklaruar gjendje *cash* në asnjë nga deklaratat periodike, përfshirë edhe vitin 2013. Nga ana tjetër, bazuar në analizën financiare të vitit 2014, edhe sikur të ishte deklaruar gjendje *cash*, subjekti nuk ka pasur mundësi financiare në shumën 559,484 lekë, për rrjedhojë Komisioni nuk do të përfshijë në analizë financiare si kursim *cash* shumën 1,700,000 lekë.

e. Diferenca nga kursimet.

177. Komisioni ka kryer një analizë financiare në lidhje me shtesat në depozitë në vitin 2013 në shumën 1,800,000 lekë dhe në vitin 2014 në shumën 2,717,000 lekë. Në analizën financiare janë përfshirë:

- të ardhurat e subjektit nga paga;
- të ardhurat e bashkëshortes së subjektit nga paga;
- të ardhurat e vajzës së subjektit nga paga në Shqipëri;
- të ardhurat nga interesat bankarë;
- shpenzimet jetike të përlllogaritura sipas shkresës ref. nr. *** prot., datë 29.1.2019, të ILDKPKI-së. Shpenzimet jetike të vajzës së subjektit për ditë qëndrimi në Mbretërinë e Bashkuar janë ngarkuar në zërin “TIMS F.Ç” dhe ditët e qëndrimit në Shqipëri janë ngarkuar në zërin “shpenzime jetike të përlllogaritura për 3 persona”;
- nuk janë përfshirë të ardhurat nga shërbimi dhënie dhoma plazhi fjetje në Dh dhe ato nga qiraja.

Nga analiza financiare⁶¹ duket se subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për krijimin e depozitës prej 1,800,000 lekësh në vitin 2013 në vlerën 1,540,548.67 dhe për depozitën prej 2,717,000 lekësh në vitin 2014, në vlerën 1,644,123.92 lekë.

178. Pas kalimit të barrës së provës⁶² subjekti pretendoi se pavarësisht se nuk ka deklaruar kursime *cash*, ai e ka ndrequr këtë mosdeklarim duke i deklaruar në deklaratat e tjera pasardhëse. Subjekti ka cituar vendimet nr. 1, datë 27.1.2022 dhe nr. 28, datë 14.7.2022, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

179. Komisioni, në analizën financiare, nuk ka përfshirë të ardhurat nga shërbimi fjetje dhoma Dhërmi sipas argumentimit në pikën 135-138 të këtij vendimi, ndërkohë, për të qenë sa më ezaurues me subjektin, e vuri në dijeni gjatë hetimit në lidhje me mungesën e deklarimit *cash*, si dhe të burimeve të ligjshme për krijimin e gjendjes *cash* në vitet 2012 dhe 2013. Komisioni ka analizuar edhe pretendimet e ekspertit kontabël, i cili në vitet 2013 dhe 2014 ka përfshirë në analizë të ardhurat nga shërbimi fjetje të atyre viteve. Këto të ardhura nuk mund të kenë shërbyer si burim, pasi depozitimet janë kryer përkatësisht në datat 18.2.2013 dhe 31.7.2014, kohë në të cilën këto të ardhura nuk ishin gjeneruar ende, pasi sipas deklarimeve të subjektit ato krijoheshin gjatë sezonit turistik.

180. Në përfundim, subjekti rezulton me mungesë burimesh të ligjshme për krijimin e depozitës prej 1,800,000 lekësh në vitin 2013 në vlerën 1,540,548.67 dhe për depozitën prej 2,717,000 lekësh në vitin 2014 në vlerën 1,644,123.92 lekë.

Si rrjedhojë, subjekti ka kryer deklarim të pasaktë, të paplotë dhe të pamjaftueshëm për këtë pasuri, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe shkronjave “a” dhe “b” të nenit 33/5 të ligjit nr. 84/2016.

181. Nga nxjerrja e llogarisë së bashkëshortes së subjektit në euro rezulton se:

- i. në datën 17.4.2019 është transferuar shuma 40,000 euro nga noteri publik S.H në lidhje me kontratën e shitjes së apartamentit nr. ***, datë 5.4.2019, nga blerësi V.N;
- ii. nga hetimi i Komisionit⁶³ ka rezultuar se bashkëshortja e subjektit më 5.4.2019, me kontratën nr. *** ka shitur apartamentin me sip. 91.7 m², për shumën 40,000 euro;
- iii. në datën 28.5.2019 kjo shumë i është transferuar vajzës së subjektit në Angli;
- iv. në datën 27.12.2019 është transferuar shuma 9,550.97 euro, e cila në po të njëjtën datë i është transferuar vajzës së subjektit.

Burimi i shumës 9,550.97 euro është një depozitë e krijuar nga bashkëshortja e subjektit në datën 16.3.2012, në shumën 1,000,000 lekë.

182. Nga nxjerrjet e llogarive bankare pranë “Intesa Sanpaolo Bank” gjendja e llogarisë së pagës në datën 16.3.2012 është 1,004,569.00 lekë. Në datën 16.3.2012 bashkëshortja e subjektit

⁶¹ Shihni tabelën nr. 10 të rezultateve të hetimit.

⁶² Për më shumë referohuni në prapësimet dhe provat e depozituara nga subjekti pas dërgimit të rezultateve të hetimit, si dhe gjatë seancës dëgjimore.

⁶³ Kthim përgjigje datë 7.2.2023 e noterit publik S.H.

transferon në depozitë shumën 1,000,000 lekë, e cila në datën 31.12.2016 rezulton në vlerën 1,141,696.29 lekë. Nga analiza financiare⁶⁴ rezulton se subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për krijimin e depozitës prej 1,000,000 lekësh më 16.3.2012, në vlerën 939,079.25 lekë.

Në analizën financiare janë përfshirë:

- të ardhurat e subjektit nga paga;
- të ardhurat e bashkëshortes së subjektit nga paga;
- të ardhurat e vajzës së subjektit nga paga në Shqipëri;
- të ardhurat nga interesat bankarë;
- shpenzimet jetike të përlllogaritura sipas shkresës ref. nr. *** prot., datë 29.1.2019, të ILDKPKI-së, ndërsa shpenzimet jetike të vajzës së subjektit për ditë qëndrimi në Mbretërinë e Bashkuar janë ngarkuar në zërin “TIMS F.Ç” dhe ditët e qëndrimit në Shqipëri janë ngarkuar në zërin “shpenzime jetike të përlllogaritura për 3 persona”.

183. Subjekti nuk ka dhënë asnjë shpjegim në lidhje me këtë rezultat hetimi. Në përfundim, subjekti rezulton me mungesë burimesh të ligjshme për krijimin e depozitës në vlerën 939,079.25 lekë.

Si rrjedhojë, subjekti ka kryer deklaram të pasaktë, të paplotë dhe të pamjaftueshëm për këtë pasuri, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe shkronjave “a” dhe “b” të nenit 33/5 të ligjit nr. 84/2016.

DEKLARIM I VAJZËS SË SUBJEKTIT – F.Ç

184. Garazh⁶⁵ me sipërfaqe 24.05 m². Pjesa takuese: 100%.

185. Njësi me sipërfaqe 37.6 m². Pjesa takuese: 100%.

186. Njësi me sipërfaqe 21.7 m². Pjesa takuese: 100%.

Burimi sipas deklaratës Vetting: përfituar nga gjyshja e vajzës së subjektit, znj. E.M, me kontratë sipërmarrjeje, lidhur në Vlorë, datë 30.8.2007, me nr. *** dhe deklaratë noteriale nr. ***, datë 7.10.2011.

Konstatimi i ILDKPKI-së

- *Deklarim i rremë për përfitimin nga F.Ç të garazhit me sip. 24.05 m² me nr. pasurie **-G*, vol. **, f. ***, z. k. ***, Vlorë, me deklaratë noteriale nga gjyshja e saj (e cila e ka përfituar me kontratë sipërmarrjeje në këmbim të truallit dhënë për ndërtim shoqërisë “A-M” sh.p.k.), pasi sipas kontratës së konfirmuar nga DPPPP-ja, garazhi është blerë nga kjo shoqëri në shumën 1,004,500 lekë, në datën 14.3.2011.*
- *Deklarim i rremë për përfitimin nga F.Ç të njësisë me sip. 37.6 m², me nr. pasurie **-N*, vol. **, f. ***, z. k. ***, Vlorë, me deklaratë noteriale nga gjyshja e saj (e cila e ka përfituar me kontratë sipërmarrjeje në këmbim të truallit dhënë për ndërtim shoqërisë “A-M” sh.p.k.), pasi sipas kontratës së konfirmuar nga DPPPP-ja dhe ZVRPP-ja Vlorë (ASHK Vlorë), njësia është blerë nga kjo shoqëri në shumën 3,384,000 lekë, në datën 14.3.2011.*
- *Deklarim i rremë për përfitimin nga F.Ç, të njësisë me sip. 21.7 m² me nr. pasurie ***-N*, vol. **, f. ***, z. k. ***, Vlorë, me deklaratë noteriale nga gjyshja e saj (e cila e ka përfituar me kontratë sipërmarrjeje në këmbim të truallit dhënë për ndërtim shoqërisë “A-M”*

⁶⁴ Shihni tabelën nr. 11 të rezultateve të hetimit.

⁶⁵ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: (i) certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, datë 2.5.2011; (ii) certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, datë 13.4.2011, (iii) certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, datë 14.4.2011; (iv) kontratë sipërmarrjeje nr. ***, datë 30.8.2007; (v) deklaratë noteriale nr. ***, datë 7.10.2011.

sh.p.k.), pasi sipas kontratës së konfirmuar nga DPPPP-ja dhe ZVRPP-ja Vlorë (ASHK Vlorë), kjo njësi është blerë nga kjo shoqëri në shumën 1,953,000 lekë, në datën 14.3.2011.

- Nuk është i qartë kriteri i ndarjes së pasurive të përfituara me kontratën e sipërmarrjes në këmbim të dhënies së truallit për ndërtim nga E.M, fëmijëve të saj, ku djalit i kalon 7 pasuri, vajzës M dhe mbesës F 5 pasuri, ndërsa vajzës tjetër 1 pasuri.
- Gjithashtu, nuk është e qartë mënyra e përfitimit të truallit me sip. 522 m², në Vlorë, nga E.M, nga dhënia për ndërtim e të cilit janë përfituara pasuritë e deklaruara.
- Konstatohet se regjistrimi në hipotekë i pasurive të dhuruara nga E.M është bërë përpara shprehjes së vullnetit të saj në deklaratën noteriale për këtë qëllim, megjithëse pasuritë e deklaruara janë regjistruar në hipotekë nëpërmjet përfitimit nga kontratat e shitjes me shoqërinë “A-M” sh.p.k. dhe jo nëpërmjet dhurimit, çka e bën deklarinimin të rremë.

Hetimi⁶⁶ dhe analiza financiare-juridike e kryer nga Komisioni

187. Në datën 30.8.2007 nëna e bashkëshortes së subjektit ka lidhur kontratë sipërmarrjeje nr. *** me shoqërinë “A-M” sh.p.k., sipas së cilës në truallin në pronësi të saj me sip. 522 m² do të ndërtohej një pallat me 8 kate. Në marrëveshje është përcaktuar se nëna e bashkëshortes së subjektit do të përfitonte 29% të sipërfaqes ndërtimore të apartamenteve dhe 30% të sipërfaqes ndërtimore të dyqaneve dhe garazheve.

Në datën 7.10.2011 nëna e bashkëshortes së subjektit me deklaratë noteriale nr. *** ka deklaruar se: “Në bazë të kontratës së lidhur, 29% përfaqëson 8 apartamente, 4 dyqane dhe 2 garazhe. Duke qenë se jam e moshuar këto pasuri i ndava midis tre fëmijëve dhe i vura në dispozicion të firmës ndërtuese në mënyrë që ajo të lidhte kontratat përkatëse me fëmijët e mi.

- i. djalit tim Th.M i kam dhënë 4 apartamente, si dhe dy dyqane dhe një garazh;
- ii. vajzës time M.Ç i kam dhënë në pronësi 2 apartamente, vajzës së saj F.Ç i kam dhënë në pronësi dy dyqane dhe një garazh;
- iii. vajzës sime V.B i kam dhënë në pronësi një apartament”.

188. Nga hetimi ka rezultuar se:

- i. Në datën⁶⁷ 14.3.2011, me kontratën nr. ***, vajza e subjektit ka blerë një garazh me sip. 24.5 m² me nr. pasurie ***-G*, z. k. ***, Vlorë, për shumën 1,004,500 lekë, me palë shitëse shoqërinë “A-M” sh.p.k.

Në nenin 5 të kontratës përcaktohet se shuma është likuiduar nga blerësi te shitësi jashtë kësaj zyre noteriale. Bashkëlidhur kësaj kontrate gjendet kartela e pasurisë, nga ku rezulton se ajo është regjistruar me leje ndërtimi. Në këtë kontratë nuk citohet kontrata e sipërmarrjes së lidhur midis shtetasës E.M dhe shoqërisë së ndërtimit, si dhe nuk deklarohet se kjo kontratë lidhet si vijimësi e kontratës së sipërmarrjes së lidhur me znj. M.

- ii. Me kontratë shitjeje nr. ***, datë 14.3.2011, vajza e subjektit, e përfaqësuar nga bashkëshortja e tij, ka blerë nga shoqëria “A-M” sh.p.k. njësinë me sip. 37.6 m², me nr. pasurie **-N*, z. k. ***, Vlorë, me çmimin 3,384,000 lekë.

Në nenin 5 të kontratës përcaktohet se shuma është likuiduar nga blerësi te shitësi jashtë kësaj zyre noteriale. Bashkëlidhur kësaj kontrate gjendet kartela e pasurisë, nga ku rezulton se ajo është regjistruar me leje ndërtimi. Në këtë kontratë nuk citohet kontrata e sipërmarrjes së lidhur

⁶⁶ Kthim përgjigje nr. *** prot., datë 30.8.2017, e Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (gjendur në dosjen e ILDKPKI-së); shkresë nr. *** prot., datë 28.1.2021, drejtuar ASHK-së; kthim përgjigje nr. *** prot., datë 30.3.2021, e ASHK-së Vlorë; shkresë nr. *** prot., datë 28.1.2019, drejtuar OSHEE-së; kthim përgjigje nr. *** prot., datë 11.2.2021, e FSHU-së; shkresë nr. ** prot., datë 28.1.2021, drejtuar UKT-së; kthim përgjigje nr. *** prot., datë 4.2.2021, e UKV-së; shkresë nr. *** prot., datë 28.1.2021, drejtuar noterit publik A. D; kthim përgjigje noterit publik datë 25.1.2023.

⁶⁷Sipas kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., të nënshkruar para noteres A.D.

midis shtetas E.M dhe shoqërisë së ndërtimit, si dhe nuk deklarohet se kjo kontratë lidhet si vijimësi e kontratës së sipërmarrjes së lidhur me znj. M.

- iii. Me kontratë shitjeje nr. ***, datë 14.3.2011, vajza e subjektit, e përfaqësuar nga bashkëshortja e tij, ka blerë nga shoqëria “A-M” sh.p.k. njësinë me sip. 21.7 m², me nr. pasurie ***-N*, z. k. ***, Vlorë, me çmimin 1,953,000 lekë.

Në nenin 5 të kontratës përcaktohet se shuma është likuiduar nga blerësi te shitësi jashtë kësaj zyre noteriale. Bashkëlidhur kësaj kontrate gjendet kartela e pasurisë, nga ku rezulton se ajo është regjistruar me leje ndërtimi. Në këtë kontratë nuk citohet kontrata e sipërmarrjes së lidhur midis shtetas E.M dhe shoqërisë së ndërtimit, si dhe nuk deklarohet se kjo kontratë lidhet si vijimësi e kontratës së sipërmarrjes së lidhur me znj. M.

189. Në lidhje me këto kontrata, subjekti, gjatë hetimit, ka dhënë të njëjtat shpjegime si në pasuritë në pikën 139 dhe 140 të këtij vendimi, për rrjedhojë edhe qëndrimi i Komisionit është i njëjtë si në pikat 145-147 të këtij vendimi, duke i kaluar barrën e provës subjektit, si vijon:

- i. Vajza e subjektit i ka blerë pasuritë e mësipërme, të cilat do të përfshihen në analizë financiare.
- ii. Subjekti nuk ka qenë i saktë në deklarin e tij në deklaratën *Vetting*.
- iii. Subjekti nuk ka depozituar dokumentacionin e përfitimit të këtyre pasurive në deklaratën *Vetting*, duke fshehur kontratat e blerjes.
- iv. Subjekti nuk ka depozituar foto të plota të këtyre pasurive (ku të dilnin qartë ndarjet e tyre dhe pozicionimi i tyre me objektin ku janë ndërtuar dhe rrugën), sikundër i është kërkuar nga Komisioni, duke u konsideruar si mungesë bashkëpunimi në kuptim të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016.
- v. Subjekti, gjatë hetimit, ka depozituar një deklaratë fiktive të shoqërisë “A-M” sh.p.k.
- vi. Nga analiza financiare vajza e subjektit nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për blerjen e këtyre pasurive në shumën 19,084,457.83 lekë.

190. Në lidhje me këtë barrë prove subjekti ka dhënë të njëjtat shpjegime si në pikat 149-153 të këtij vendimi, për rrjedhojë edhe qëndrimi i Komisionit është si në pikat 154-161 të këtij vendimi.

191. Në përfundim, Komisioni çmon se subjekti: (i) ka kryer deklarin të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin në lidhje me pasuritë e përfituara nga bashkëshortja e tij; (ii) ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar blerjen e këtyre pasurive 19,084,457.83 lekë.

Si rrjedhojë, subjekti ka kryer deklarin të pasaktë, të paplotë dhe të pamjaftueshëm për këtë pasuri, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe shkronjave “a” dhe “b” të nenit 33/5 të ligjit nr. 84/2016.

192. Komisioni ka konstatuar se të gjitha kontratat e mësipërme të shtetas F.Ç janë firmosur nga shtetasja M.Ç, bazuar në prokurën e përgjithshme nr.***, datë 12.3.2011, lëshuar nga shtetasja F.Ç.

Kjo prokurorë rezulton se nuk është e nënshkruar nga shtetasja F.Ç. Gjithashtu, nga të dhënat e sistemit TIMS rezulton se kjo shtetase ka dalë nga territori shqiptar në datën 14.1.2011, nga pika e daljes Rinas dhe është futur në Shqipëri në datën 25.10.2011.

Për sa më sipër, në momentin e redaktimit të kësaj prokure, shtetasja F.Ç nuk ka qenë në Shqipëri. Në lidhje me këtë konstatim ai është konfirmuar nga ana e noterit publik S.H⁶⁸, duke

⁶⁸ Shihni kthim përgjigjen datë 7.2.2023 të noterit publik S.H.

pretenduar se vajza e subjektit ka nënshkruar prokurën në faqen e dytë me qëllim përdorimin e saj nëse do t'i nevojitej prindërve, pasi do të kthehej së shpejti në Shqipëri. Ky pretendim i noterit publik nuk qëndron, pasi ajo nuk ka pasur asnjë pengesë për të regjistruar prokurën në datën e pretenduar të nënshkrimit të saj. Bashkëlidhur gjendet edhe një *email* nga adresa **** me emër F.Ç, në të cilin shkruhet se është paraqitur në zyrën e noterit së bashku me prindërit, ku ka nënshkruar vetë faqen e dytë të prokurës pa e zyrtarizuar atë, por në kohën që do t'i duhej prindërve do të zyrtarizohej.

193. Ky sqarim i noterit, si dhe deklarimi bashkëlidhur, duket se janë bërë me qëllim shmangien e përgjegjësisë së noterit nga një veprim, i cili bie në kundërshtim me ligjin për noterin dhe për më tepër përmban të dhëna të rreme, pasi nuk është nënshkruar nga porositësi, i cili provohet që nuk ka qenë në Shqipëri. Noteri publik nuk ka pasur asnjë pengesë të regjistronte prokurën e firmosur, pasi prokura është një akt i njëanshëm, si dhe pretendimi i saj mbetet i paprovuar dhe në nivel deklarativ.

Për sa më sipër, duket se subjektit ka përdorur më shumë se një herë një dokument që përmban të dhëna jo të vërteta, pasi vajza e tij nuk ka qenë në Shqipëri në momentin e hartimit të këtij dokumenti.

Për rrjedhojë, veprimet e subjektit nuk përputhen me etikën e magjistratit sepse duket se janë kryer jo në përputhje me ligjin për noterin.

194. Pas kalimit të barrës së provës⁶⁹ subjekti sqaroi se prokura është një veprim juridik i njëanshëm, sipas dispozitave të Kodit Civil, e cila mban datën 12.3.2011. Nga kjo datë kanë kaluar 12 vjet dhe nuk mban mend sesi kanë rrjedhur ngjarjet. Për këtë ka pyetur vajzën, e cila i ka thënë se në muajin janar 2011 ka qenë në Shqipëri dhe se është paraqitur para noterit publik S.H, ku ka depozituar firmën e saj, duke e porositur që të redaktonte një prokurë ku si përfaqësues të saj do të ishin prindërit M e P.Ç. Në datën 12.3.2011 ajo është kontaktuar nga ana e noterit ku i është kërkuar konfirmimi i përmbajtjes së prokurës, siç ajo është e përfunduar.

195. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, konstaton se për sa i përket faktit që prokura është veprim juridik i njëanshëm, ky pretendim qëndron, por ndërkohë mbetet fakt që dokumenti prokurë e posaçme, i përdorur nga bashkëshortja e subjektit, nuk mban të dhëna të vërteta, pasi në datën e redaktimit dhe firmosjes së saj vajza e subjektit nuk ka qenë në Shqipëri.

Për sa më sipër, Komisioni vlerëson se nga ana e subjektit më shumë se një herë janë përdorur dokumente që përmbajnë të dhëna jo të vërteta, veprime të cilat nuk përputhen me etikën e magjistratit dhe do të mbahen në konsideratë në vlerësimin tërësor të procedurave.

196. Apartament⁷⁰ me sipërfaqe 62.8 m². Pjesa takuese: 100%.

Burimi sipas deklaratës *Vetting*: kontratë dhurimi nr. ***, datë. 29.3.2014, me nr. pasurie ***, z. k.**, apartament me sip. 62.8 m², në emër të shtetasës E.M, e cila e ka përfituar me kontratë sipërmarrjeje, lidhur në Vlorë, në datën 30.8.2007, me nr. ***.

Konstatimi i ILDKPKI-së

- *Praktikisht, E.M i ka dhuruar mbesës edhe një apartament, përveç pasurive të dhuruara me deklaratën noteriale nr. ***, datë 7.10.2011, i cili, sipas referencave të pronës është në objektin e ndërtuar nga shoqëria "A-M" sh.p.k. Në kontratën e dhurimit citohet si kundërshpërblim i kujdesit ndaj saj nga shtetasit Petra dhe M. Ç, me çdo mjet në vlerën 3,811,960 lekë. Nuk është e qartë çfarë simbolizon vlera e vënë në kontratë.*

⁶⁹ Për më shumë referohuni në prapësimet dhe provat e depozituara nga subjekti pas dërgimit të rezultateve të hetimit, si dhe gjatë seancës dëgjimore.

⁷⁰ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: (i) certifikatë për vërtetimin pronësie nr. ***, datë 11.4.2014; (ii) kontratë dhurimi nr. ***, datë 29.3.2014; (iii) certifikatë për vërtetimin pronësie nr. ***, datë 28.2.2011.

Hetimi⁷¹ dhe analiza financiare-juridike e kryer nga Komisioni

197. Nëna e bashkëshortes së subjektit me kontratë dhurimi nr. ***, datë 29.3.2014, i ka dhuruar vajzës së tij pasurinë apartament me sip. 62.8 m², vol. **, f. ***, z. k. ***, Vlorë. Në kontratën e dhurimit përcaktohet se dhurata i bëhet mbesës në mënyrë të pakthyeshme dhe pa asnjë lloj shpërblimi, si vlerësim që prindërit e saj Petraq dhe M.Ç kanë bërë e bëjnë ndaj saj, duke u kujdesur me të gjitha mjetet për jetesën e saj, shëndetin e çdo nevojë tjetër që ka pasur, me vlerën 3,811,960 lekë.

Në kartelën e pasurisë së apartamentit të dhuruar origjina e regjistrimit të tij është kontrata e shkëmbimit nr. ***, datë 12.2.2011, e lidhur midis shtetasës E.M, në cilësinë e pronares së truallit dhe shoqërisë ndërtuese që ka shërbyer për kalimin e pronësisë së truallit me sip. 522 m², në favor të shoqërisë së ndërtimit.

198. Në lidhje me shumën 3,811,960 lekë subjekti, në përgjigje të pyetësorit të datës 26.1.2023, ka deklaruar se: *“Në kontratën e dhurimit nr. *** rep., nr. *** kol., datë 29.3.2014, notere S.H, bashkëlidhur saj është certifikatë pronësie për pasurinë nr. ***, z. k. ***, Vlorë, apartament me sipërfaqe 62.8 m², në emër të E.M.*

Në kartelën e pasurisë së paluajtshme të kësaj pasurie në rubrikën “Përshkrim i veçantë” ka të shënuar “çmimi i rivlerësimit 3,811,960 lekë, kryer datë 18.11.2013”. Shuma prej 3,811,960 lekësh është çmim i rivlerësimit të apartamentit nga ana e ish-ZVRPP-së Vlorë.

Ky rivlerësim pasurie është kryer nga ana e vjehrrës sime E.M dhe nuk mund të deklarohej nga ana ime”.

199. Në lidhje me shumën 3,811,960 lekë, Komisioni do ta përfshijë në analizë financiare, për sa kohë ajo është deklaruar si shpenzim në një kontratë të bërë para një noteri publik dhe nuk rezulton që nga ana e subjektit të jetë kundërshtuar ky shpenzim.

Subjekti duket se nuk është treguar bashkëpunues me Komisionin, pasi nuk ka deklaruar kohën kur janë kryer shpenzimet në shumën 3,811,960 lekë.

200. Pas kalimit të barrës së provës⁷² subjekti sqaroi se shuma prej 3,811,960 lekësh është çmim i rivlerësimit të apartamentit nga ana e ish-ZVRPP-së Vlorë. Motivi i kësaj kontrate dhurimi del qartë edhe nga deklaratat e mëposhtme, sipas të cilave nëna e bashkëshortes i ka dhuruar vajzës së tij shuma në euro dhe, për rrjedhojë, nuk mundej që ato t’i jepnin shumën e sipërcituar në kontratë dhurimi.

i. Me deklaratën noteriale nr. ** rep., nr. ** kol., datë 13.1.2019, noteri publik S.S. H, nëna e bashkëshortes, znj. E.M, deklaroi: *“...se me vajzën time M.M(Çuri), që pas vdekjes së bashkëshortit tim M.M, kam mbajtur marrëdhënie të ngushta e më të afërta në raport me fëmijët e tjerë. Nga viti 1998, unë, duke qenë se jam nga Dh, kam marrë pension nga shteti grek deri në fund të vitit 2012, e cila në total është rreth 50,000 euro, të cilat i vërtetoj me dokumentacionin që unë kam marrë nga shteti grek me kërkesën time. Këtë shumë unë ia kam dhënë ta administrojë vajzës sime M.Ç, pasi për shkak të moshës nuk kisha mundësi që ta administroja vetë...”*

ii. Me deklaratën noteriale nr. ** rep., nr. ** kol., datë 13.1.2019, noteri publik S. S. H, nëna e bashkëshortes, znj. E.M, deklaroi: *“...se të ardhurat e mia financiare për periudhën 1998*

⁷¹ Kthim përgjigje nr. *** prot., datë 30.8.2017, e Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (gjendur në dosjen e ILDKPKI-së); shkresë nr. *** prot., datë 28.1.2021, drejtuar ASHK-së; kthim përgjigje nr. *** prot., datë 30.3.2021, e ASHK-së Vlorë; shkresë nr. *** prot., datë 28.1.2019, drejtuar OSHEE-së; kthim përgjigje nr. *** prot., datë 11.2.2021, e FSHU-së; shkresë nr. *** prot., datë 28.1.2021, drejtuar UKT-së; kthim përgjigje nr. *** prot., datë 4.2.2021, nga UKV-ja; shkresë nr. *** prot., datë 28.1.2021, drejtuar noteres publike A.D; kthim përgjigje noterit publik datë 25.1.2023.

⁷² Për më shumë referohuni në prapësimet dhe provat e depozituara nga subjekti pas dërgimit të rezultateve të hetimit, si dhe gjatë seancës dëgjimore.

– 2012, të cilat për moshën time ishin mëse të mjaftueshme e më ngeleshin, pasi unë qëndroja te vajza ime, deklaroj se pasi kam pasur shumë afinitet e dashuri për mbesën time F.Ç, të cilën e kam rritur dhe për këtë e kam ndihmuar të përballoj shpenzimet për qëndrimin e saj në Angli në vitet 2010 – 2011, në shumën që ajo më kërkonte dhe këtë e bëja thjesht për shkak të sjelljes së saj dashamirëse ndaj meje.”

Subjekti ka depozituar *email* të datës 1.5.2023 të noteres S.H, e cila sqaron se vlera e përcaktuar në kontratën e dhurimit është vendosur për efekt të llogaritjes së tatimit nga ZVRPP-ja.

201. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerëson se ato nuk janë bindëse. Nëna e bashkëshortes së subjektit është shprehur qartë që dhurimi bëhet për shkak se subjekti dhe bashkëshortja e tij janë kujdesur për të. Në lidhje me shumën 3,811,960 lekë, Komisioni nuk e ka përfshirë në analizë financiare, pasi e ka pasur të pamundur përcaktimin e viteve se kur është përdorur kjo shumë. Nëse kjo shumë shtohet në analizë financiare në cilëndo pjesë të saj, ajo e thellon më tej rezultatin negativ të subjektit të rivlerësimit. Komisioni ka vendosur që këtë shumë të mos e përfshijë në analizën financiare për të mos rënduar pozitën e subjektit, për sa kohë nuk e kishte përfshirë në rezultatet e hetimit. Duke qenë se deklarata nr. ** rep., nr. ** kol., datë 13.1.2019, nuk figuron e regjistruar në RNSH, Komisioni vlerëson se ajo është përdorur nga subjekti pikërisht për të arritur një rezultat të favorshëm për të dhe do të mbahet në konsideratë në vlerësimin tërësor të procedurave. Deklarimet e nënës së bashkëshortes së tij në këtë kontratë dhurimi tregojnë dhe provojnë se ka qenë subjekti dhe bashkëshortja e tij që kanë mbuluar shpenzimet e saj dhe jo e kundërta, sikundër pretendohet nga subjekti.

202. B.Bank,⁷³ datë 16.5.2016, shuma 16,470 euro. Pjesa takuese: 100%.

Burimi sipas deklaratës *Vetting*: kryer transaksion nga BKT-ja, datë 12.5.2016, nga shtetasja M.Ç, shuma 16,500 euro.

203. B.B, datë 28.6.2016, shuma 41,516 euro. Pjesa takuese: 100%.

Burimi sipas deklaratës *Vetting*: kryer transaksion nga BKT-ja, datë 28.6.2016, nga z. Petraq Çuri, shuma 41,516 euro.

204. B.B, datë 20.12.2016, shuma 8,500 euro. Pjesa takuese: 100%.

Burimi sipas deklaratës *Vetting*: kryer transaksion nga “Credins Bank”, datë 16.12.2016, nga shtetasja M.Ç, shuma 8,500 euro.

Hetimi⁷⁴ dhe analiza financiare-juridike e kryer nga Komisioni

205. Nga dokumenti i datës 6.1.2017 i B.B rezulton se janë kryer tre transferime, si vijon:

- datë 16.5.2016, M.M, shuma 16,470 euro;
- datë 28.6.2016, Petraq Çuri, shuma 41,516.12 euro;
- datë 20.12.2016, M.Ç, shuma 8,500 euro.

206. Nga hetimi konstatohet se shuma 16,470 euro rezulton se është transferuar në datën 12.5.2016 nga llogaria e shtetases M.Ç në BKT.

⁷³ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: (i) dokument datë 6.1.2017 i B.Bank në emër të F.Ç, shuma 16,470 euro; (ii) kërkesë për transaksion nëpërmjet BKT-së, datë 12.5.2016; (iii) vërtetim nr. ***, datë 24.1.2017, nga “Tirana Bank”; (iv) dokument arke i tërheqjes së shumës 16,520 euro nga M.Ç në “Tirana Bank”, datë 25.6.2015; (v) kontratë depozite bankare në BKT e datës 25.6.2015; (vi) vërtetim nr. ***, datë 6.1.2017, i BKT-së; (vii) transfertë “Credins Bank” datë 16.12.2016; (viii) veprim në llogari “Credins Bank” datë 16.12.2022.

⁷⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 28.1.2021, drejtuar bankave dhe institucioneve financiare; kthim përgjigje nr. *** prot., datë 23.3.2021, nga “Credins Bank”; kthim përgjigje nr. *** prot., datë 11.2.2021, nga “Tirana Bank”; kthim përgjigje nr. *** prot., datë 17.2.2021, nga BKT-ja.

Rezultoni se burimi i kësaj shume është një depozitë tjetër e krijuar nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit në datë 16.4.2010 në “Tirana Bank” në shumën fillestare 8,000 euro. Në deklaratën para fillimit të detyrës të vitit 2010 si burim për këtë depozitë deklarohen të ardhurat e nënës së bashkëshortes së subjektit, znj. E.M.

207. Në datën 10.7.2012 bashkëshortja e subjektit e ka shtuar këtë depozitë me shumën 7,500 euro (si burim pranë bankës janë deklaruar të ardhurat e nënës së bashkëshortes së subjektit nga pensioni në Greqi). Si burim në DPV/2012 janë deklaruar të ardhurat e nënës së bashkëshortes së subjektit nga pensioni në Shqipëri dhe Greqi.

208. Në datën 25.6.2015 rezultoni se është tërhequr depozita në shumën 16,520 euro. Në po të njëjtën datë kjo shumë (16,500 euro) është depozituar në BKT. Në DPV/2015 bashkëshortja e subjektit ka deklaruar krijimin e depozitës në BKT, ku si burim ka deklaruar tërheqjen e depozitës në “Tirana Bank”.

209. Për të provuar të ardhurat e nënës së bashkëshortes, subjekti, së bashku me pyetësorin e datës 26.1.2023, ka depozituar:

- vërtetim datë 4.2.2023, marrë nga sistemi e-albania “Për lloj dhe masë pensioni”, nr. pensioni ***, masa 17,972 lekë/muaj, pension pleqërie urbane – ky pension i është lidhur që nga data 16.12.1987;
- vërtetim pensioni datë 18.10.2018 për periudhën 1.1.2002 – 31.12.2002, sipas të cilit shtetasja E.M ka përfituar shumën 2,107 euro;
- vërtetim pensioni datë 18.10.2018 për periudhën 1.1.2003 – 31.12.2003, sipas të cilit shtetasja E.M ka përfituar shumën 2,305 euro;
- vërtetim pensioni datë 18.10.2018 për periudhën 1.1.2004 – 31.12.2004, sipas të cilit shtetasja E.M ka përfituar shumën 2,710 euro;
- vërtetim pensioni datë 18.10.2018 për periudhën 1.1.2005 – 31.12.2005, sipas të cilit shtetasja E.M ka përfituar shumën 2,873 euro;
- vërtetim pensioni datë 18.10.2018 për periudhën 1.1.2006 – 31.12.2006, sipas të cilit shtetasja E.M ka përfituar shumën 3,074 euro;
- vërtetim pensioni datë 18.10.2018 për periudhën 1.1.2007 – 31.12.2007, sipas të cilit shtetasja E.M ka përfituar shumën 3,749 euro;
- vërtetim pensioni datë 18.10.2018 për periudhën 1.1.2008 – 31.12.2008, sipas të cilit shtetasja E.M ka përfituar shumën 4,455 euro;
- vërtetim pensioni datë 18.10.2018 për periudhën 1.1.2009 – 31.12.2009, sipas të cilit shtetasja E.M ka përfituar shumën 4,571 euro;
- vërtetim pensioni datë 18.10.2018 për periudhën 1.1.2010 – 31.12.2010, sipas të cilit shtetasja E.M ka përfituar shumën 4,860 euro dhe përfitim shtesë 150 euro;
- vërtetim pensioni datë 18.10.2018 për periudhën 1.1.2011 – 31.12.2011, sipas të cilit shtetasja E.M ka përfituar shumën 4,860 euro;
- vërtetim pensioni datë 18.10.2018 për periudhën 1.1.2012 – 31.12.2012, sipas të cilit shtetasja E.M ka përfituar shumën 4,860 euro;
- vërtetim nga Ministria e Punës, Sigurimeve Shoqërore dhe Solidaritetit Social, Enti i Përfitimeve Sociale dhe Solidaritetit Social, të Republikës së Greqisë, Athinë, datë 18.10.2018 sipas së cilit: *“Vërtetohet se, siç rezultoni nga regjistri i përfituesve të shërbimit tonë, E.M, e bija e A, përfitonte pagesën e të moshuarit, të pasiguruar, nga viti 1998/12 dhe deri në vitin 2012/12. Dhënia e përfitimit të mësipërm u ndërpre nga viti 2013/01”.*

210. Në lidhje me shumën 41,517.12 euro, rezultoni se ajo është transferuar në datën 24.6.2016 nga llogaria e subjektit në BKT.

Nga nxjerrja e llogarisë së subjektit në BKT rezultoni se:

- në datën 17.4.2010 ka depozituar shumën 5,000 euro;

- në datën 22.11.2010 ka depozituar shumën 33,000 euro në depozitë dhe kjo shumë rezulton të jetë depozituar në datën 5.11.2010 nga shtetasja B.H me emërtimin “Blerje apartamenti për Petraq dhe M.Ç”;
- në datën 21.3.2014 krijohet një depozitë e re me vlerë 40,593 euro, e cila është mbyllur në datën 24.6.2016, me vlerë 41,629 euro.

Në transferimin e shumës 41,559 euro ka shënim transfertë për studime. Nga kjo llogari rezulton që në datën 26.12.2019 të jetë transferuar shuma 8,310 euro, e cila në po të njëjtën datë është transferuar te llogaria e vajzës së subjektit në Angli.

211. Shuma 8,500 euro rezulton se është transferuar në datën 16.12.2016 nga llogaria e znj. M. Ç në “Credins Bank” me emërtimin “*Payment for school*”.

Në lidhje me këtë emërtim subjekti i pyetur⁷⁵ nga Komisioni ka sqaruar se: “*Sqaroj se transfertat e datës 16.12.2016, në shumën 8,500 euro, me emërtimin pagesë shkolle është bërë gabim nga ana e punonjësës së bankës. Duke analizuar transfertën bankare të “Credins Bank” të datës 16.12.2016, shkrimi i bashkëshortes sime është në rubrikën emri i klientit, monedha dhe shuma, shuma në fjalë, emri dhe adresa e përfituesit, numri i llogarisë së përfituesit dhe nënshkrimi. Në rubrikën “përshkrimi i natyrës së veprimit” e shkruar në gjuhën angleze “Payment for school” është shkruar nga punonjësja e bankës. Kjo shtesë nga ana e punonjësës së bankës është bërë pas përfundimit të veprimit bankar nga ana e bashkëshortes sime (e cila nuk është njohëse e gjuhës angleze).*

Edhe për transfertën e datës 24.6.2016, në shumën 41,559 euro, e kryer në BKT, shënimi transfertë për studime është plotësuar nga punonjësja e bankës.

Sqaroj se shumat e sipërcituara, respektivisht në datat 20.12.2016 dhe 28.6.2016 ishin në llogarinë në euro të B.B, në emër të vajzës sime F.Ç dhe kanë qenë burim të ardhurash për blerjen e shtëpisë në Birmingham, Mbretëri e Bashkuar. Vajza ime nuk ka kryer studime pasuniversitare në vitin 2016”.

212. Nga nxjerrja e llogarisë së bashkëshortes së subjektit në “Credins Bank” konstatohet se në datën 16.12.2016 është konvertuar gjendja e llogarisë në shumën 1,156,492 lekë, me kurs këmbimi 135.5 në një vlerë prej 8,535 euro. Kjo shumë ka kaluar në llogarinë në euro të bashkëshortes së subjektit në këtë bankë dhe është transferuar në llogarinë në Angli të vajzës së subjektit.

Në datën 27.12.2019 bashkëshortja e subjekti ka konvertuar shumën 1,168,920 lekë në një vlerë prej 9,550 euro, e cila është transferuar në llogarinë e vajzës së saj në Angli.

Në datën 29.12.2020 bashkëshortja e subjekti ka konvertuar shumën 813,000 lekë në një vlerë prej 6,583 euro, së cilës i ka shtuar një depozitim *cash* në shumën 1,454 euro, duke transferuar në llogarinë e vajzës së saj në Angli shumën 8,000 euro.

213. Nga nxjerrja e llogarive bankare të bashkëshortes së subjektit konstatohet se ajo nuk ka deklaruar në deklaratën *Vetting*:

- llogarinë e saj në lekë me balancë në fund të vitit 2016 në shumën 105,546 lekë;
- llogarinë në euro me balancë në fund të vitit 2016 në shumën 9 euro.

214. Pas kalimit të barrës së provës subjekti sqaroi se nga ana e bashkëshortes së tij janë deklaruar të ardhurat vjetore nga paga për çdo vit dhe duke qenë se llogaria e pagës ndryshon në varësi të pagesave të kryera për të ardhurat nga puna dhe tërheqjet e saj, vlerëson se konstatimi i Komisionit të mos konsiderohet problematikë. Kjo edhe për faktin se nga ana e saj vetëm deklarimi i të ardhurave nga paga është i mjaftueshëm për efekt të deklarimit pasuror, gjë e cila tashmë është rregulluar sidomos me deklarimin *online* të pasurisë.

⁷⁵ Shihni pyetësorin datë 26.1.2023.

215. Komisioni vlerëson se shpjegimet e subjektit nuk janë bindëse. Ai kishte detyrimin ligjor për të deklaruar llogaritë e mësipërme në zbatim të nenit D të Aneksit Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në të cilin parashikohet se subjekti i rivlerësimit dorëzon një deklaratë të re dhe të detajuar të pasurisë.

Për sa më sipër, subjekti ka kryer deklaram të pasaktë në deklaratën *Vetting*, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe germës “a” të nenit 33/5 të ligjit nr. 84/2016. Ky deklaram i pasaktë nuk përbën shkak autonom për shkarkimin e subjektit nga detyra, por do të merret në konsideratë në vlerësimin tërësor të procedurave.

216. B.B⁷⁶, datë 5.9.2016, shuma 12,949 GBP. Pjesa takuese: 100%.

Burimi sipas deklaratës *Vetting*: kryer transaksion nga “Tirana Bank”, datë 5.9.2016, nga z. Petraq Çuri, shuma 12,949 GBP.

217. B.B, datë 1.9.2016, shuma 6.976 GBP. Pjesa takuese: 100%.

Burimi sipas deklaratës *Vetting*: kryer transaksion nga “Alpha Bank”, datë 1.9.2016, nga z. Petraq Çuri, shuma 6,976 GBP.

218. B.B, datë 2.8.2016, shuma 21,997 GBP. Pjesa takuese: 100%.

Burimi sipas deklaratës *Vetting*: kryer transaksion nga NBG Bank, datë 2.8.2016, nga z. Petraq Çuri, shuma 21,997 GBP. Bashkëlidhur dokumentacioni mbi burimin e krijimit të llogarisë para kryerjes së transaksionit.

Hetimi⁷⁷ dhe analiza financiare-juridike e kryer nga Komisioni

219. Nga dokumenti i datës 6.1.2017 i B.B rezulton se janë kryer tre transferime, si vijon:

- datë 5.9.2016, kreditim nga subjekti në shumën 12,949.09 GBP;
- datë 1.9.2016, kreditim nga subjekti në shumën 6,976.73 GBP;
- datë 2.8.2016, kreditim nga subjekti në shumën 21,997.56 GBP.

220. Nga nxjerrja e llogarisë së subjektit në “Tirana Bank” rezulton se ai ka hapur depozitë në datën 13.7.2006 në shumën 1,500,000 lekë, e cila është mbyllur në datën 31.8.2016 së bashku me interesat në shumën 2,175,029 lekë.

Në datën 1.9.2016 subjekti ka bërë kërkesë për transfertë fondesh nga “Tirana Bank”, në shumën 2,174,329 lekë.

221. Nga analiza financiare⁷⁸ rezulton se subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për krijimin e depozitës prej 1,500,000 lekësh në vitin 2006 në vlerën -1,132,988.13 lekë. Në analizën financiare janë përfshirë:

- të ardhurat e subjektit nga aktiviteti “Avokati”, bazuar në marzhin e fitimit 26%;
- të ardhurat e bashkëshortes së subjektit nga paga;
- të ardhurat nga interesat bankarë;
- shpenzime për shlyerjen e detyrimeve ndaj BKT-së dhe shoqërisë “C” sh.p.k.;

⁷⁶ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: (i) dokument i datës 6.1.2017 i B.Bank; (ii) kërkesë për transfertë fondesh i datës 1.9.2016 nga “Tirana Bank”; (iii) konfirmim bankar nr. *, datë 6.1.2017, i “Tirana Bank”; (iv) certifikata e depozitës me afat; (v) transfertë personale me jashtë e datës 30.8.2016; (vi) deklaratë e datës 6.1.2017 e “Alpha Bank”; (vii) kontratë e depozitës me afat 1 vit; (viii) nxjerrje llogarie e Bankës Kombëtare Greke në Londër; (ix) nxjerrje llogarie e NBG Bank e shtetasit Petraq Çuri; (x) vërtetim nr. ***, datë 9.1.2017, i NBG Bank; (xi) marrëveshje për depozitë me afat e NBG Bank; (xii) marrëveshje për depozitë me afat e NBG Bank.

⁷⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 28.1.2021, drejtuar bankave dhe institucioneve financiare; kthim përgjigje nr. ***, datë 11.2.2021, “Tirana Bank”; kthim përgjigje nr. ***, datë 2.2.2021, e ABI Bank; kthim përgjigje nr. *** prot., datë 2.2.2021, e “Alpha Bank”.

⁷⁸ Shihni tabelën nr. 12 të rezultateve të hetimit.

- shpenzimet jetike të përlllogaritura për vitet 1992 – 2000 në masën 66% të ardhurave dhe në vijim sipas shkresës ref. nr. *** prot., datë 29.1.2019, të ILDKPKI-së.

222. Në datën 30.8.2016, me transfertë personale me jashtë nëpërmjet “Alpha Bank”, subjekti ka transferuar shumën 7,000 GBP (1,148,000 lekë), me emërtimin “Shpenzime jetësore familjare”.

Nga nxjerrja e llogarisë së subjektit në “Alpha Bank” rezulton se subjekti në datën 8.7.2009 ka çelur depozitë në shumën 900,000 lekë. Kjo depozitë ka vijuar edhe në datën 30.8.2016, vlera e saj ka qenë 1,153,970.93 lekë.

223. Nga analiza financiare⁷⁹ rezulton se subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për krijimin e depozitës prej 900,000 lekësh në vitin 2009 në vlerën -2,523,887.94. Në analizën financiare janë përfshirë:

- të ardhurat e subjektit nga aktiviteti “Avokati” bazuar në marzhin e fitimit 26%;
- të ardhurat e bashkëshortes së subjektit nga paga;
- të ardhurat nga interesat bankarë;
- shpenzimet për shlyerjen e detyrimeve ndaj BKT-së dhe shoqërisë “C” sh.p.k.;
- shpenzimet jetike të përlllogaritura për vitet 1992 – 2000 në masën 66% të të ardhurave dhe në vijim sipas shkresës ref. nr. *** prot., datë 29.1.2019, të ILDKPKI-së.

224. Subjekti, në datën 26.12.2019, ka transferuar shumën 11,500 euro nga llogaria e tij në euro në “Alpha Bank” në llogarinë e vajzës së tij në Angli dhe në datën 23.12.2020 ka transferuar shumën 12,000 euro. Bazuar në nxjerrjen e llogarisë së subjektit në ABI Bank ish-NBG Bank rezulton se në datën 16.5.2007 ka hapur depozitë në shumën 1,600,000 lekë dhe në datën 6.4.2007 depozitë në shumën 800,000 lekë, të cilat në datën 20.8.2009 janë bashkuar në një depozitë të vetme.

Në datën 29.7.2016 subjekti ka transferuar të gjithë shumën e kësaj depozite në vlerën 3,575,625 lekë (22,022.56 GBP) në llogarinë e vajzës së tij në B.B.

225. Nga analiza financiare⁸⁰ rezulton se subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për krijimin e depozitës prej 2,400,000 lekësh në vitin 2007 në vlerën -2,758,828 lekë. Në analizën financiare janë përfshirë:

- të ardhurat e subjektit nga aktiviteti “Avokati” bazuar në marzhin e fitimit 26%;
- të ardhurat e bashkëshortes së subjektit nga paga;
- të ardhurat nga interesat bankarë;
- shpenzimet për shlyerjen e detyrimeve ndaj BKT-së dhe shoqërisë “C” sh.p.k.;
- shpenzimet jetike të përlllogaritura për vitet 1992 – 2000 në masën 66% të të ardhurave dhe në vijim sipas shkresës ref. nr. *** prot., datë 29.1.2019, të ILDKPKI-së.

226. Pas kalimit të barrës së provës⁸¹ në lidhje me depozitat e mësipërme, subjekti pretendoi se nga analiza financiare e përgatitur nga audituesi ligjor A. M, rezulton se të gjitha pasuritë e krijuara nga prej tij janë krijuar me të ardhura të ligjshme.

227. Komisioni, në lidhje me këto llogari bankare bazuar edhe në arsyetimin e mësipërm për sa i përket pretendimeve të subjektit në lidhje me të ardhurat nga avokatia, vlerëson se subjekti ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar krijimin e tyre përkatësisht:

- për krijimin e depozitës prej 1,500,000 lekësh në vitin 2006, në vlerën -1,132,988.13 lekë;
- për krijimin e depozitës prej 900,000 lekësh në vitin 2009, në vlerën -2,523,887.94 lekë;

⁷⁹ Shihni tabelën nr. 13 të rezultateve të hetimit.

⁸⁰ Shihni tabelën nr. 14 të rezultateve të hetimit.

⁸¹ Për më shumë referohuni në prapësimet dhe provat e depozituara nga subjekti pas dërgimit të rezultateve të hetimit, si dhe gjatë seancës dëgjimore.

- për krijimin e depozitës prej 2,400,000 lekësh në vitin 2007, në vlerën -2,758,828 lekë.

Si rrjedhojë, subjekti ka kryer deklarin të pasaktë, të paplotë dhe të pamjaftueshëm për këtë pasuri, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe shkronjave “a” dhe “b” të nenit 33/5 të ligjit nr. 84/2016.

228. Komisioni, pavarësisht qëndrimit të mësipërm për të qenë sa më ezaures në lidhje me pretendimet e subjektit, ka kryer një analizë financiare hipotetike⁸², duke pranuar pretendimet e subjektit, i cili rezulton me një rezultat negativ në shumën 15,259,318 lekë deri në vitin 2010.

Konstatime të tjera

229. Në vitin 2017 vajza e subjektit ka deklaruar blerjen e një shtëpie banimi në shumën 115,000 GBP në Birmingham, Angli.

Si burim është deklaruar pakësimi i shumës 41,922 GBP dhe 66,486 euro, si dhe 17,297 GBP kursime nga pagat.

Subjekti, së bashku me pyetësozin e datës 26.1.2023, ka depozituar kontratë datë 18.1.2017, sipas së cilës vajza e tij ka blerë një pasuri në shumën 115,000 GBP.

230. Komisioni, duke qenë se ka të bëjë me një apartament të blerë para dorëzimit nga subjekti të deklaratës *Vetting* dhe si burim janë përdorur pasuri të subjektit të deklaruara në deklaratën *Vetting*, ka kryer një analizë financiare në lidhje me mundësinë financiare të vajzës së subjektit për blerjen e kësaj pasurie.

231. Në lidhje me burimin gjendje *cash* në shumën 17,297 GBP, i deklaruar për herë të parë nga subjekti gjatë hetimit administrativ dhe i padeklaruar në deklaratën *Vetting*, por edhe në deklaratat periodike, Komisioni ka kryer një analizë financiare⁸³, nga e cila rezulton se vajza e subjektit ka pasur mundësi për krijimin e këtyre kursimeve. Komisioni ka vlerësuar se kjo pasaktësi e subjektit në deklaratën *Vetting*, për sa kohë nuk shoqërohet me mungesë burimesh financiare, nuk përbën shkak për mospërfshirjen në analizë të këtyre kursimeve *cash*. Ky argumentimi i Komisionit nuk gjen zbatim në analizën e subjektit për kursimet *cash*, pasi të ardhurat nga shërbim fjetje nuk janë përfshirë në këtë analizë, por, edhe sikur hipotetikiisht të përfshiheshin, subjekti nuk ka pasur mundësi për krijimin e kursimeve *cash*, pra pasaktësia e pretenduar e subjektit në lidhje me kursimet *cash* shoqërohet me mungesë burimesh financiare.

232. Nga analiza financiare⁸⁴ për blerjen e apartamentit të vajzës së subjektit rezulton se ajo nuk ka pasur mundësi për blerjen e apartamentit në shumën 79,937.77 GBP. Në analizë janë përfshirë:

- të ardhurat e shtetas F.Ç në vitet 2015 – 2016, të cilat rezultojnë të jenë 32,213.23 GBP;
- shpenzimet jetike të shtetas F.Ç në masën 602 GBP/muaj, referuar kostove mesatare sipas ndarjeve rajoneve në Mbretërinë e Bashkuar;
- nga analiza e financiare e trajtuar më lart në këtë vendim nuk u provua aftësia financiare e subjektit dhe bashkëshortes së tij për krijimin e depozitave në vlerën 41,922 GBP dhe 66,486 euro, për rrjedhojë këto fonde nuk u konsideruan si burim për blerjen e apartamentit nga ana e vajzës F.Ç në Mbretërinë e Bashkuar.

233. Subjekti i rivlerësimit në lidhje me këtë barrë prove nuk ka dhënë shpjegime.

234. Komisioni vlerëson se kjo pasuri, pavarësisht se nuk është e deklaruar në deklaratën *Vetting* për sa kohë është krijuar me pasuri të deklaruara në këtë deklaratë, si dhe përpara plotësimit të kësaj deklarate, do të jetë pjesë e vlerësimit të kriterit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit.

⁸² Shihni pikën 49 të këtij vendimi.

⁸³ Shihni tabelën nr. 15 të rezultateve të hetimit.

⁸⁴ Shihni tabelën nr. 16 të rezultateve të hetimit.

Për sa më sipër, vajza e subjektit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar blerjen e pasurisë apartament në shumën 79,937.77 GBP.

235. Komisioni, gjatë hetimit, ka konstatuar transferta në një vlerë totale prej 58,324 GBP nga llogaria e subjektit dhe vajzës së tij drejt Mbretërisë së Bashkuar. Ndër këto transferta, disa prej tyre janë kryer gjatë kohës që subjekti ka qenë në detyrë, më konkretisht nga nxjerrja e llogarisë së vajzës së subjektit në paund në BKT rezultojnë pagesat në lidhje me arsimin e saj, si vijon:

- datë 15.6.2011, shuma 3,110 GBP;
- datë 23.12.2011, shuma 3,100 GBP, me emërtimin “*Transfer Capi*”;
- datë 3.9.2012, shuma 3,000 GBP, me emërtimin “*Study Expenses*”.

Gjendja e kësaj llogarie në datën 28.12.2016 është 71.2 GBP. Kjo llogari nuk rezulton e deklaruar në deklaratën *Vetting*. Në lidhje me këtë mosdeklarim Komisioni i ka kërkuar shpjegime subjektit.

236. Në lidhje me dy depozitimet e mësipërme subjekti, në përgjigje të pyetësorit të datës 26.1.2023, ka deklaruar: “*Vajza ime F.Ç bëri përpjekje për të studiuar AÇA, i cili është një kualifikim profesional dhe jo edukim universitar. Ajo aplikoi për të studiuar AÇA, full time nëpërmjet institucionit “K”, i cili nëpërmjet letrës së konfirmimit detajoi koston e studimit që ishte në total £6,555, nga të cilat £3,278 do të paguheshin si paradhënie për të siguruar pjesëmarrjen në mësimdhënie.*”

Shoqata e Kontabilistëve të Miratuar të Certifikuar (AÇA) është organi botëror i kontabilitetit profesional që ofron kualifikimin të certifikuar chartered (AÇA). Datë 23.12.2011, shuma prej £3,100 u transferua si paradhënie për të siguruar pjesëmarrjen në mësimdhënie full time. Pasi nuk u bë e mundur që të regjistrohej në kohë për datën e fillimit të mësimit në mars 2012, nga ana e tyre u kthyen paratë nëpërmjet postimit të çekut.

Datë 15.6.2012 është postimi i çekut për kthimin e shumës paradhënie.

*Datë 3.9.2012, F.Ç, shumën £3,000 e ka transferuar në llogarinë e saj nr. ***, Ll. Bank, që ka pasur në Mbretërinë e Bashkuar, me qëllim për të bërë regjistrimin në AÇA part time dhe, më pas, për të bërë pagesat për dhënien e provimeve. Këto pagesa u kryen në një shtrirje kohore në vite, pasi një provim kishte një tarifë rreth £100.*

Në përfundim të këtij argumenti ju paraqes formularin e paraqitjes së provimit të AÇA, ku vajza ime ka marrë pjesë në dhënien e tre provimeve në datat 4.12.2012, 7.12.2012 dhe 11.12.2012, të cilat zhvilloheshin në Universitetin Europian të Tiranës.

Nga sa më lart, del qartë se vajza ime nuk ndoqi studimet e AÇA full time, por i vazhdoi ato part time, ku një pjesë të tyre i ka dhënë kur ishte në Shqipëri...”

237. Bazuar në përgjigjet e subjektit rezulton se vajza e tij në vitet 2012 – 2022 ka kryer studimet *part time*. Këto shpenzime nuk rezulton të jenë deklaruar nga subjekti në pyetësorin standard, por edhe në deklaratat periodike. Komisioni i ka kërkuar informacion të plotë subjektit në lidhje me arsimin e vajzës, të dhënat bankare, si dhe për pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme të vajzës së tij në Mbretërinë e Bashkuar. Nga ana e tij, në përgjigje të pyetësorit datë 26.1.2023, është sqaruar se: “*Datë 18.1.2017, vajza ime F.Ç ka blerë në Mbretërinë e Bashkuar, Birmingham, Angli, shtëpi banimi, në shumën 115,000 paund. Në vitin 2018 ka blerë automjet “H”, model G.C.C.S, me vlerë 1,295 paund. Ky automjet, datë 1.7.2020, u shit me vlerë 500 paund në emër të blerëses B.M. Vajza ime nuk ka llogari në banka të tjera, por vetëm në bankën B.*”

*Llogaria nr. ***, që ka pasur në Ll.B gjatë kohës së studimit nga viti 2007 e në vijim është mbyllur datë 15.3.2016.*

Sqaroj se nga ana e vajzës sime u bë përpjekje për të marrë informacion për llogarinë që kishte mbyllur, por nga ana e bankës nuk iu dha asnjë informacion për sa kërkonte, me arsyetimin se kishin kaluar mbi 5 vjet nga koha e mbylljes së llogarisë...

Nga ana e vajzës sime u kërkua që këtë argument t'ia jepnin me shkrim, gjë që u refuzua nga punonjësit e bankës. Ata e referuan tek rregullat e publikuara të kësaj banke. Në rregullat e publikuara të kësaj banke citohet: “Ju mund të kërkoni kopje të deklaratave (historiku juaj i transaksionit), pasi të keni mbyllur llogarinë tuaj. Ju mund ta bëni këtë në çdo kohë gjatë pesë viteve të ardhshme. Përveç kësaj, nëse jeni duke mbyllur një llogari, ne do t'ju ofrojmë historinë tuaj të transaksioneve (pa kosto) që mbulon deri në pesë vjet përpara datës së mbylljes, përveç nëse vendosni të mos e merrni atë në atë kohë”. Nga ana e vajzës sime nuk janë marrë kredi/hua”.

238. Komisioni, bazuar në përgjigjet e subjektit, konstaton se nga ana e tij nuk rezulton të jetë deklaruar përgjatë gjithë periudhës së deklarimit një llogari bankare e vajzës së tij në L.I.B, gjithashtu, nga ana e subjektit nuk janë depozituar dokumentet e kërkuara në këtë pyetësor, më konkretisht të gjitha nxjerrjet e llogarive bankare të vajzës së tij në B.B, si dhe në banka të tjera, nëse ka llogari në këto banka nga momenti i hapjes së tyre e në vijim, duke përfshirë edhe llogaritë që janë hapur gjatë kohës së studimit të vajzës nga viti 2007 e në vijim.

239. Komisioni i kaloi barrën provës subjektit, duke e konsideruar sjelljen e tij gjatë hetimit si mungesë bashkëpunimi, e cila synon pengesën e Komisionit për të kryer një analizë të plotë financiare, duke e bërë të pamundur objektivisht një proces të plotë rivlerësimi, si dhe subjekti nuk kishte depozituar nxjerrjet e llogarive bankare të vajzës së tij për periudhën e hapjes e në vijim.

240. Në lidhje me arsimimin e vajzës subjekti ka sqaruar: “Nga ana ime janë bërë transfertat për arsimimin e vajzës sime në Universitetin e A, Birmingham, Mbretëri e Bashkuar. Këto transfertat janë bërë para fillimit të detyrës së gjyqtarit. Në këtë periudhë unë ushtroja aktivitetin privat të avokatisë dhe nuk kam mbajtur dokumentacion.

Vajza ime ka filluar studimet në shtator të vitit 2007 dhe i ka përfunduar në maj të vitit 2010.

Shuma e paguar nga ana ime për mbulimin e shpenzimeve, shkollim + akomodim + jetesë nuk është mbajtur nga ana ime, pasi nuk isha subjekt deklarimi. Vajza ime F.Ç ka kontaktuar departamentin e Financës së Universitetit të A, duke kërkuar informacion për tarifën vjetore të studimit dhe akomodimit për vitet 2007 – 2010. Ata krijuan një komunikim në numër reference 2302-1963, të cilën e mbyllën pa i dërguar informacionin që ajo u kërkoi. Kjo ndodhi pasi ata kërkonin që ajo të kishte loginin si studente ku mund të shikonte të dhënat e saj.

*Ajo nuk ka qenë studente në Universitetin e A që prej muajit maj 2010, kohë kur ajo i përfundoi studimet universitare dhe nuk ka më akses te portali studentor. Edhe pse kërkoi t'i dërgonin informacionin direkt, ata nuk e kanë kryer këtë kërkesë. Me një email të dytë A.University konfirmoi mbylljen e komunikimit nr. *** pa ndonjë atach të informacionit që ajo kishte kërkuar”.*

241. Subjekti sërish nuk ka kthyer përgjigje të plota në lidhje me arsimimin e vajzës, sipas pyetësorit të datës 26.1.2023, ku i është kërkuar:

- a. *Të deklarojë sa është shuma e paguar nga ana e tij për mbulimin e shpenzimeve (shpenzime shkollimi + akomodim + jetesë), duke specifikuar për çdo vit këto shpenzime.*
- b. *Të depozitojë:*
 - *dokumentacion bankar për kryerjen e pagesave të universitetit, ku të dalë qartë shuma e pagesës dhe kryerja e saj për llogari të universitetit;*
 - *vërtetim nga universiteti për shumën e paguar;*

- *dokumentacion mbi tarifën e universitetit dhe marrëveshjen e lidhur me këtë universitet për ndjekjen e studimeve nga vajza juaj.*

Subjekti nuk ka plotësuar asnjë nga kërkesat e mësipërme, duke u konsideruar si mungesë bashkëpunimi në kuptim të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016.

242. Pas kalimit të barrës së provës⁸⁵ subjekti ka dhënë të njëjtat sqarime si gjatë hetimit administrativ, duke shtuar se të dhëna nga llogaritë bankare që nuk kontestohen nga ana e tij, përfaqësojnë të vetmet shpenzime të kryera për shkollimin e vajzës dhe përballimin e shpenzimeve jetike të saj në këto vite, të cilat janë përlllogaritur në analizën financiare. Kjo edhe për faktin se ai nuk ka asnjë të dhënë bankare apo dokument tjetër për të paraqitur, pasi është në pamundësi për të dhënat për shkollim + akomodim të vajzës së tij. Mosdeklarimi i llogarisë bankare të vajzës së tij në Ll.B ka qenë thjesht harresë që kur ai ka deklaruar para fillimit të detyrës në vitin 2010. Llogaria në Ll.B ishte llogari studentore, e cila shërbente për xhirimin e shumave për shkollim + akomodim + jetesë të vajzës së tij dhe kur ai filloi detyrën ajo kishte përfunduar studimet dhe për këtë arsye nuk kishte më detyrime për shkollimin e saj.

243. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerëson se ato nuk janë bindëse. Subjekti ka vijuar të refuzojë të depozitojë dokumentacionin e mëposhtëm në lidhje me shkollimin dhe jetesën e vajzës së tij në Mbretërinë e Bashkuar:

- a. nxjerrjet e llogarive bankare në B.B nga viti i hapjes e në vijim;
- b. nxjerrjet e llogarisë bankare në Ll.B, ku kjo llogari bankare bazuar në përgjigjet e subjektit në pyetësoin e datës 26.1.2023 ka qenë aktive deri më 15.3.2016;
- c. dokumentacion bankar për kryerjen e pagesave të universitetit, ku të dalë qartë shuma e pagesës dhe kryerja e saj për llogari të universitetit;
- d. vërtetim nga universiteti për shumën e paguara;
- e. dokumentacion mbi tarifën e universitetit dhe marrëveshjen e lidhur me këtë universitet për ndjekjen e studimeve nga vajza.

Gjithashtu, subjekti ka refuzuar të specifikojë për Komisionin shumën e paguara për mbulimin e shpenzimeve të jetesës. Për rrjedhojë, Komisioni e ka të pamundur të kryejë një analizë të plotë financiare për subjektin dhe familjarët e tij, pasi mungojnë: nxjerrjet e llogarive bankare të vajzës së tij në B.B në vitin 2016; nxjerrjet e llogarive bankare për periudhën 2007 – 2016 në Ll.B dhe B.B të vajzës së tij; të dhëna të plota për shumën e shpenzuar për mbulimin e shpenzimeve të shkollimit, akomodimit dhe të jetesës. Subjekti nuk ka depozituar asnjë dokument për të provuar vlerën e tarifës së universitetit.

Në këto kushte, Komisioni i është referuar të dhënave bankare për pagesën e tarifës së universitetit, ndërsa akomodimin dhe jetesën e vajzës e ka llogaritur me një vlerë minimale prej 30 euro/ditë.

244. Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti ka refuzuar të vërë në dispozicion dokumentacionin e kërkuar, duke u konsideruar si mungesë bashkëpunimi në kuptim të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016. Subjekti ka tentuar të fshehtë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë llogaritë bankare, si dhe shpenzimet e shkollimit, akomodimit dhe jetesës së vajzës së tij në Mbretërinë e Bashkuar, me qëllim që procesi i kontrollit e verifikimit të pasurisë, i mbështetur në këto të dhëna, të prodhojë një rezultat në favor të subjektit të rivlerësimit.

245. Komisioni ka kryer një analizë financiare kumulative të subjektit përpara fillimit të detyrës, duke rezultuar me pamundësi financiare për të krijuar pasuritë ndër vite në vlerën 44,568,643.74 lekë.

Në analizën para detyrës (periudha 1992 – 2010) janë konsideruar si vijon:

⁸⁵ Për më shumë referohuni në prapësimet dhe provat e depozituara nga subjekti pas dërgimit të rezultateve të hetimit, si dhe gjatë seancës dëgjimore.

- të ardhurat e subjektit nga aktiviteti “Avokati” me marzh fitimi 26%, në vlerë totale 6,384,000 lekë;
- të ardhurat e subjektit nga paga në vlerën 918,379 lekë, të përfituara nëpërmjet sistemit bankar;
- të ardhurat e bashkëshortes së subjektit nga paga në vlerën 6,071,814 lekë, të përfituara nëpërmjet sistemit bankar;
- të ardhurat nga interesat bankarë në vlerën 1,169,610.95 lekë;
- të ardhurat nga ekzekutimi i vendimit nr. ***, datë 9.12.2009, në vlerën 441,000 lekë;
- shpenzimet jetike të përlllogaritura për vitet 1992 – 2000 në masën 66% të të ardhurave dhe në vijim sipas shkresës ref. nr. *** prot., datë 29.1.2019, të ILDKPKI-së, ndërsa shpenzimet jetike të vajzës së subjektit për ditë qëndrimi në Mbretërinë e Bashkuar janë ngarkuar në zërin “TIMS F.Ç” dhe ditët e qëndrimit në Shqipëri janë ngarkuar në zërin “shpenzime jetike të përlllogaritura për 3 persona”;
- shpenzimet e mobilimit të pasqyruara sipas deklaramit të subjektit në pyetësorin standard, si dhe në deklaratën noteriale të shtetasit A.C, paraqitur prej subjektit në pyetësorin nr. 1;
- detyrimet dhe shlyerjet e tyre ndaj të tretëve (BKT, C.sh.p.k., firmës së ndërtimit “P.C. A”) për blerjen e pasurive apartament, garazh dhe automjet.

246. Pas kalimit të barrës së provës⁸⁶ subjekti kërkoi që në analizën financiare duhet të konsiderohen:

- ndërtesa në Dh të përlllogaritet në shumën 15,000,000 lekë, e ndarë në 5 vite;
- të ardhurat e subjektit nga aktiviteti “Avokati” të përlllogariten për gjithë periudhën, sipas analizës faktike dhe ligjore të mbështetur në dokumentacionin e administruar dhe në legjislacionin tatimor të çdo viti dhe marzhi i fitimit të përlllogaritet në masën e përcaktuar nga audituesi ligjor A. M, e cila bazohet në përlllogaritje matematikore;
- të ardhurat e tij dhe të bashkëshortes të përlllogariten në vlerën e përcaktuar drejt nga audituesi ligjor;
- të ardhurat nga interesat bankarë të përlllogariten në masën 2,915,105 lekë + 618,099 lekë sipas rezultateve të aktit të ekspertimit;
- shpenzimet jetike të vajzës për ditët e qëndrimit në Mbretërinë e Bashkuar të ngarkuara në zërin “TIMS F.Ç” janë vendosur në mënyrë të padrejtë dhe shpenzimet e kësaj periudhe janë të barabarta me paratë e transferuara me bankë.

247. Në lidhje me këto pretendime të subjektit, Komisioni është shprehur në mënyrë të detajuar në këtë vendim, duke analizuar se ato nuk janë të mbështetura, për më tepër në disa raste subjekti është kontradiktor, më konkretisht në lidhje me vlerën e ndërtesës në Dh një herë deklaroi të merret 11,000,000 lekë, ndërsa më pas deklaroi 15,000,000 lekë. Për sa i përket shpenzimeve jetike të vajzës, Komisioni nuk pranon argumentin e subjektit, pasi ai ka refuzuar të ofrojë të gjithë dokumentacionin e kërkuar, duke pasur për qëllim pikërisht marrjen e analizës, sikundër e ka kërkuar ai.

248. Në përfundim, subjekti dhe personat e lidhur me të kanë mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar krijimin e pasurive përpara detyrës së subjektit, por që janë të deklaruara në deklaratën *Vetting* në shumën 44,568,643.74 lekë.

Si rrjedhojë, subjekti ka kryer deklaramit të pasaktë, të paplotë dhe të pamjaftueshëm për këtë pasuri, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe shkronjave “a” dhe “b” të nenit 33/5 të ligjit nr. 84/2016.

249. Komisioni vlerëson të ndalet në lidhje me faktin e kryerjes së analizës së subjektit për pasuritë e krijuara përpara fillimit të detyrës, por që rezultojnë të deklaruara në deklaratën

⁸⁶ Për më shumë referohuni në prapësimet dhe provat e depozituara nga subjekti pas dërgimit të rezultateve të hetimit, si dhe gjatë seancës dëgjimore.

Vetting. Bazuar në jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit⁸⁷, rivlerësimi është analizë e së shkuarës së një funksionari publik, duke mbajtur në konsideratë që objekt kontrolli është pasuria dhe, për këtë shkak, institucionet e rivlerësimit kontrollojnë burimin në të shkuarën për të cilin është krijuar kjo pasuri dhe rivlerësimi kalimtar *Vetting* mund të përkufizohet si vlerësim i integritetit për të përcaktuar përshtatshmërinë për funksione publike. Legjislacioni i posaçëm për rivlerësimin kalimtar nuk vendos kritere kohore lidhur me provueshmërinë e ligjshmërisë së burimeve të krijimit të pasurive në pronësi apo përdorim, të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të. Në një interpretim të dispozitave të zbatueshme lidhur me vlerësimin e kriterit të pasurive, sipas qëllimit të procesit të rivlerësimit kalimtar, të përcaktuar në nenin 179/b, pika 1 e Kushtetutës dhe në nenin 1 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka arritur në konkluzionin se nëpërmjet procedurës së kontrollit të pasurive synohet identifikimi i atyre subjekteve të rivlerësimit, të cilët janë bërë përfitues apo përdorues të pasurive në mënyrë të paligjshme apo me të ardhura, ligjshmëria e të cilave, referuar standardit të përcaktuar në nenin D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, vihet në dyshim, pavarësisht nëse ky fakt nuk lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me ushtrimin e detyrës së subjektit apo rezulton të ketë ndodhur jashtë periudhës kohore të ushtrimit të saj. Në këtë proces, subjektit të rivlerësimit, bazuar në nenin D të Aneksit të Kushtetutës, i duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave dhe nuk duhet të fshehë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij dhe organet e rivlerësimit kanë si qëllim që të identifikojnë ata që kanë në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht ose ata që nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur.

250. Komisioni, për të qenë sa më ezaures me subjektin, ka kryer një analizë hipotetike, duke u bazuar në pretendimet e tij. Në këtë analizë nuk janë përfshirë të ardhurat e prindërve të subjektit dhe të ardhurat e nënës së bashkëshortes së subjektit, pasi ato nuk rezultojnë të deklaruar jo vetëm në deklaratën *Vetting*, por as në deklaratat periodike si dhe gjatë hetimit. Godina është llogaritur sipas aktit të kolaudimit dhe shpenzimet e vajzës së subjektit janë llogaritur 30 euro dita në mungesë të dokumentacionit të depozituar nga subjekti.

	1992 – 2010
Pasuria	45,385,819.33
Apartament 1+1, me sip. 61 m ² , përfituar me privatizim në vitin 1992	5,630.00
Godinë banimi në Dh ndërtuar në periudhën 2002 – 2004	20,000,000.00
Apartament me sip. 76.7 m ² , blerë në periudhën 2007 – 2008	8,715,192.80
Pasuria garazh, me sip. 19.8 m ² , blerë në periudhën 2007 – 2008	1,478,190.00
Autoveturë V.G 5	1,960,640.00
Ndryshim likuiditeti	13,226,166.53
Detyrime	1,598.20
Kredi në BKT më 29.8.2005	1,102,860.00
Shlyerje principali	-1,083,282.30
Detyrim ndaj C. sh.p.k.	1,960,640.00
Shlyerje detyrimi ndaj C sh.p.k.	-1,960,640.00
Detyrim ndaj firmës së ndërtimit për apartamentin	8,715,192.80
Shlyerje detyrimi ndaj firmës për apartamentin	-8,733,172.30
Detyrim ndaj firmës së ndërtimit për garazh	1,478,190.00
Shlyerje detyrimi ndaj firmës për garazh	-1,478,190.00
Pasuria neto	45,384,221.13

⁸⁷ Vendimet nr. 15/2019, nr. 8/2019, nr. 19/2019 dhe nr. 13/2020

Te ardhurat	44,728,316.24
Të ardhurat e subjektit nga aktiviteti "Avokati"	34,474,000.00
Të ardhurat e subjektit nga paga	0.00
Të ardhurat e bashkëshortes së subjektit nga paga	6,448,176.00
Të ardhurat e P.Ç (nëna e subjektit)	0.00
Të ardhurat e A.Ç (babai i subjektit)	0.00
Të ardhurat nga interesat bankare	3,365,140.24
Të ardhurat nga ekzekutimi i vendimit nr. ***, datë 9.12.2009	441,000.00
Shpenzime	14,603,413.51
Shpenzime jetike	3,948,300.55
TIMS	922,471.27
TIMS vajza në UK	3,244,418.10
Shpenzime për shkollim (nga bankat)	6,069,204.00
Shpenzime për shlyerje interesash kredi në BKT, viti 2005	119,019.59
Shpenzime mobilimi nga pyetësi standard apartamenti në Tiranë	100,000.00
Shpenzime mobilimi nga pyetësi standard apartamentet në Dhërmi	200,000.00
Mundësia për kursime	-15,259,318.40

Nga kjo analizë subjekti rezulton me pamundësi financiare në vlerën 15,259,318 lekë.

251. Edhe sikur në këtë analizë të hiqeshin shpenzimet jetike të vajzës së subjektit në Mbretërinë e Bashkuar, si dhe godina të merrej në vlerën 15,000,000 lekë, sërish do të kishte një rezultat negativ të konsiderueshëm.

252. Komisioni vlerëson se për sa kohë pamundësia financiare e subjektit për të mbuluar shpenzimet dhe për të krijuar pasuritë përpara detyrës është në një vlerë shumë të lartë në shumën 42,619,078.46 lekë ose në rastin hipotetik, nëse merren në konsideratë pretendimet e subjektit në shumën 15,259,318 lekë, nuk mund të zbatohet parimi i proporcionalitetit sikundër është zbatuar nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit në vendimin nr. 6/2022. Për më tepër, subjekti gjatë hetimit, nuk është treguar bashkëpunues, duke refuzuar të depozitojë dokumentacion ose ka depozituar dokumente që nuk përmbajnë të dhëna të vërteta.

253. Komisioni ka kryer një analizë financiare nga fillimi i detyrës deri në deklaratën *Vetting* për subjektin⁸⁸, nga e cila ai rezulton me pamundësi financiare në shumën 26,948,049.15 lekë. Në analizë janë konsideruar:

- të ardhurat e subjektit nga paga në vlerën 6,473,571 lekë, të përfituara nëpërmjet sistemit bankar;
- të ardhurat e bashkëshortes së subjektit nga paga në vlerën 4,852,284 lekë, të përfituara nëpërmjet sistemit bankar;
- të ardhurat e vajzës së subjektit nga paga në Shqipëri në vlerën 761,829 lekë, të përfituara nëpërmjet sistemit bankar;
- të ardhurat nga llogaria bankare e nënës së subjektit në shumën 2,022.4 euro;
- të ardhurat nga llogaria bankare e nënës së bashkëshortes së subjektit në vlerën 8,000 euro;
- të ardhurat nga interesat bankarë në vlerën 4,008,576.09 lekë;
- të ardhurat nga shitja e pasurive të paluajtshme apartament në Vlorë me sip. 75 m², në vlerën 750,000 lekë;
- të ardhurat nga shitja e pasurive të paluajtshme apartament në Vlorë me sip. 61 m², në vlerën 33,000 euro;
- të ardhurat nga shitja e pasurive të luajtshme, automjeti tip "Golf **", në vlerën 4,000 euro;
- shpenzimet jetike janë përlllogaritur sipas shkresës ref. nr. *** prot., datë 29.1.2019, të ILDKPKI-së, ndërsa shpenzimet jetike të vajzës së subjektit për ditë qëndrimi në Mbretërinë e Bashkuar janë ngarkuar në zërin "TIMS F.Ç" dhe ditët e qëndrimit në Shqipëri janë ngarkuar në zërin "shpenzime jetike të përlllogaritura për 3 persona";

⁸⁸ Shihni tabelën me emërtimin "Analiza nga marrja e detyrës deri në deklaratën *Vetting*" në rezultatet e hetimit.

- detyrimet dhe shlyerjet e tyre ndaj të tretëve, shoqëria “C” sh.p.k., për blerjen e pasurive automjet tip “V.T”, në vlerën 26,300 euro;
- shpenzimet e mobilimit të pasqyruara sipas deklaratimit të subjektit në pyetësonin standard, si dhe në deklaratën noteriale të shtetasit A.C, paraqitur prej subjektit në pyetësonin nr. 1;
- të ardhurat nga aktiviteti “Shërbim dhomë fjetje” nuk janë përfshirë në analizë;
- të ardhurat nga dhënia me qira e njësisë me sip. 37.6 m² nga F. Ç nuk janë përfshirë në analizë, pasi nuk provohet pagimi i detyrimeve tatimore dhe vetë subjekti ka pranuar që ato nuk janë paguar duke pretenduar se ka ulur çmimin e qirasë.

254. Pas kalimit të barrës së provës⁸⁹ subjekti kërkon si vijon:

- Shpenzimet jetike të vajzës së subjektit për ditë qëndrimi në Mbretërinë e Bashkuar janë tepër të larta. Të gjitha shpenzimet e kryera nga ana e tij janë kryer me transfertë bankare. Shpenzimet në zërin “TIMS për F.Ç” duhet të zerohen.
- Duhet të përfshihen të ardhurat nga aktiviteti “Shërbim dhomë fjetje”.
- Pasuritë e përfituara në vitin 2011 me dhurim nga vjehrra të mos pasqyrohen në analizën financiare sepse për krijimin e tyre nuk janë shpenzuar të ardhura, ato janë përfituar me dhurim.
- Shpenzimi i vitit 2014 që ka të bëjë me rivlerësimin të mos përllogaritet në analizën financiare.
- Të përllogariten gjendjet *cash* të padeklaruara, por të saktësuara në krijimin e depozitave në vitin pasardhës, të përllogariten në analizën financiare sipas praktikës së Kolegjit.
- Gjendja *cash* e vitit 2016 të përllogaritet në shumën 1,400,000 lekë.
- Teprica e mundësisë për kursim në fund të vitit 2009 të përllogaritet të paktën për pasuritë dhe shpenzimet e vitit 2010.

255. Në lidhje me këto pretendime të subjektit ato janë trajtuar gjërësisht në këtë vendim duke mos u marrë në konsideratë nga Komisioni.

Në përfundim, subjekti dhe personat e lidhur me të kanë mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar krijimin e pasurive nga fillimi i detyrës deri në deklaratën *Vetting* në shumën 26,488,681.15 lekë.

Si rrjedhojë, subjekti ka kryer deklaram të pasaktë, të paplotë dhe të pamjaftueshëm, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe shkronjave “a” dhe “b” të nenit 33/5 të ligjit nr. 84/2016.

256. Komisioni, për të qenë sa më ezaurues me subjektin, ka kryer një analizë hipotetike, duke u bazuar në pretendimet e tij. Në këtë analizë janë përfshirë të ardhurat nga qiraja, nuk janë përfshirë blerja e pasurive të paluajtshme nga bashkëshortja dhe vajza e subjektit, ndërkohë nuk janë pranuar shpenzimet jetike të vajzës së subjektit, pasi jo vetëm që ato nuk janë provuar, por vajza e subjektit pas vitit 2010 nuk ka vijuar shkollën, sikundër deklaroi subjekti, si dhe nuk janë pranuar pretendimet e tij në lidhje me mbulimin e këtyre shpenzimeve nga znj. E.M dhe shtetasi i huaj.

	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	Deklarata <i>Vetting</i>
Pasuria	7,711,926.04	1,979,606.72	2,961,963.83	2,846,995.78	3,212,735.68	1,930,905.84	2,618,807.14	-1,165,954.85
<i>Ndryshim likuiditeti</i>	<i>7,711,926.04</i>	<i>1,979,606.72</i>	<i>2,961,963.83</i>	<i>2,846,995.78</i>	<i>3,212,735.68</i>	<i>-1,689,289.16</i>	<i>2,618,807.14</i>	<i>-1,165,954.85</i>
<i>Total likuiditeti</i>	<i>20,938,092.56</i>	<i>22,917,699.28</i>	<i>25,879,663.11</i>	<i>28,726,658.89</i>	<i>31,939,394.57</i>	<i>30,250,105.41</i>	<i>32,868,912.56</i>	<i>31,702,957.70</i>
Cash	0.00	0.00	1,800,000.00	1,700,000.00	1,620,000.00	935,000.00	2,056,500.00	1,400,000.00
Detyrime	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00

⁸⁹ Për më shumë referohuni në prapësimet dhe provat e depozituara nga subjekti pas dërgimit të rezultateve të hetimit, si dhe gjatë seancës dëgjimore.

Pasuria neto	7,711,926.04	1,979,606.72	2,961,963.83	2,846,995.78	3,212,735.68	1,930,905.84	2,618,807.14	-1,165,954.85
Të ardhurat	7,748,754.80	2,261,673.25	3,793,981.09	4,970,409.27	4,584,949.65	3,447,647.23	3,465,352.87	349,789.43
Të ardhurat e subjektit nga paga	719,976.00	809,849.00	809,053.00	857,057.00	1,069,646.00	1,099,396.00	1,108,594.00	98,490.00
Të ardhurat e bashkëshortes së subjektit nga paga	859,288.00	833,209.00	595,662.52	569,942.62	612,984.00	619,097.00	762,101.00	63,024.00
Të ardhurat e vajzës së subjektit nga paga në Shqipëri	0.00	0.00	0.00	216,686.00	501,600.00	43,543.00	0.00	
Të ardhurat nga llogaria bankare e nënës së subjektit		279,697.92						
Të ardhurat nga llogaria bankare e nënës së bashkëshortes së subjektit	1,110,480.00							
Të ardhurat nga aktiviteti "Shërbim dhomë fjetje"			1,800,000.00	1,700,000.00	1,620,000.00	935,000.00	850,000.00	
Të ardhurat nga interesat bankarë	478,280.80	338,917.33	589,265.57	876,723.65	780,719.65	200,011.23	744,657.87	188,275.43
Të ardhurat nga shitja e pasurive të paluajtshme apartament në Vlorë me sip. 75 m ²				750,000.00				
Të ardhurat nga shitja e pasurive të paluajtshme apartament në Vlorë me sip. 61 m ²	4,580,730.00							
Të ardhurat nga shitja e pasurive të luajtshme autovetura Golf *						550,600.00		
Shpenzime	2,920,372.93	2,860,024.36	1,490,336.51	963,701.30	1,125,733.52	713,336.83	705,276.00	59,513.51
Shpenzime jetike	302,435.51	302,061.21	418,644.00	423,072.00	659,994.00	672,828.00	705,276.00	59,513.51
TIMS	117,605.93	278,791.78	452,663.91	540,629.30	465,739.52	40,508.83	0.00	
TIMS vajza në UK	1,270,111.50	1,244,700.00	105,488.60	0.00	0.00	0.00	0.00	
Shpenzime për shkollim (nga bankat)	1,130,220.00	1,034,471.38	513,540.00					
Shpenzime mobilimi nga pyetësori standard apartamenti në Vlorë	100,000.00							
Mundësia për kursime	-2,883,544.17	-2,577,957.83	-658,319.25	1,159,712.18	246,480.45	803,404.56	141,269.72	1,456,230.77

257. Sërish subjekti rezulton me një pamundësi financiare në vlerën 6,119,821.25 lekë. Edhe sikur të mos përfshihen shpenzimet jetike të vajzës së tij, sërish pamundësia financiare është në një vlerë të konsiderueshme, e cila e kombinuar me pamundësinë financiare përpara detyrës, me mungesën e bashkëpunimit të subjektit, si dhe me përdorimin nga ana e tij të deklaratave që nuk përmbajnë të dhëna të vërteta, e bëjnë të pamundur zbatimin e parimit të proporcionalitetit.

Konkluzioni i Komisionit

258. Në përfundim të vlerësimit të kriterit të pasurisë, trupi gjykues konkludon se:

- i. Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë të pasurive dhe burimeve të ligjshme të tyre në deklaratën e pasurisë *Vetting*, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, shkronja "a" e ligjit nr. 84/2016.

- ii. Subjekti i rivlerësimit ka mungesë burimesh financiare të ligjshme për krijimin e pasurive, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.
- iii. Subjekti i rivlerësimit është përpjekur të fshehë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij, sipas parashikimeve të pikës 5 të nenit D të Aneksit Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Në lidhje me cenimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë

259. Në vlerësimin tërësor të procedurave lidhur me cenimin e besimit të publikut, duke vlerësuar në tërësi kriterin e pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në kuptim të nenit 4, paragrafi 2 i ligjit nr. 84/2016, si dhe referuar vendimit nr. 3/2023 të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, rezultojnë disa rrethana, të cilat, të analizuara së bashku e të para në harmoni me njëra-tjetrën, tregojnë për një sjellje të subjektit të rivlerësimit në raport me detyrën, e cila do të ishte e papranueshme për të pasur besimin e publikut te sistemi i drejtësisë dhe te roli i subjektit, si një funksionar i denjë i këtij sistemi.

260. Në këto rrethana përfshihet problematika e konstatuar në drejtim të kontrollit të kriterit të pasurisë në lidhje me: (i) qëndrimin jobashkëpunues të subjektit gjatë procesit të rivlerësimit, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016; (ii) paraqitjen prej tij të deklaratave apo dokumenteve që nuk përmbajnë të dhëna të vërteta me qëllim arritjen e një rezultati pozitiv për të; (iii) zvarritjen e procesit të rivlerësimit dhe kërkesat e vazhdueshme për kohë shtesë; (iv) tentativat për të fshehur apo paraqitur në mënyrë të pasaktë llogaritë bankare, si dhe shpenzimet e shkollimit, akomodimit dhe jetesës së vajzës së tij në Mbretërinë e Bashkuar, me qëllim që procesi i kontrollit e verifikimit të pasurisë, i mbështetur në këto të dhëna, të prodhojë një rezultat në favor të subjektit të rivlerësimit.

261. Për sa më sipër, subjekti, përveçse nuk është treguar bashkëpunues për dhënien e informacionit të kërkuar nga Komisioni, në kuadër të hetimit, duke u përgjigjur në disa raste se nuk mban mend apo nuk disponon dokumentacion, por nuk ka treguar një sjellje korrekte gjatë procesit të rivlerësimit. Veprimet e tij të krijojnë bindjen se nuk kanë pasur për qëllim zhvillimin e një procesi të rregullt, por zvarritjen e këtij procesi rivlerësimi, deri në pamundësimin e tij, gjë që konstatohet dukshëm me kërkesat në mënyrë të vazhdueshme, të përsëritura dhe haptazi të pabazuara, para dhe pas dërgimit të rezultateve të hetimit. Subjekti gjatë gjithë procesit është përpjekur për ta shtyrë atë deri në qershor të vitit 2023, kohë në të cilën mbushte moshën për të dalë në pension, me qëllim shmangien e procesit të rivlerësimit. Në çdo rast, subjekti i rivlerësimit ka të drejtë të paraqesë kërkesa procedurale të bëra në kuadër të këtij procesi, por jo ato të cilat dukshëm kalojnë kufirin e ligjores dhe të arsyeshmes, për të rënë në abuzivitet. Trupi gjykues sjell në vëmendje kërkesat e subjektit të rivlerësimit, përpara dhe pas dërgimit të rezultateve të hetimit, ku në të gjitha këto kërkesa rezulton se afati i kërkuar nga subjekti synonte të përfundonte në muajin qershor.

262. Subjekti i rivlerësimit ka cenuar, qoftë edhe vetëm me këtë mënyrë sjelljeje, besimin e publikut te një funksionar i drejtësisë, i cili duhet të karakterizohet nga sjellja e denjë, serioze dhe e sinqertë, jo vetëm gjatë ushtrimit të detyrës, por edhe gjatë zbatimit të detyrimeve të tij përgjatë këtij procesi.

263. Në vlerësimin e Komisionit, këto rrethana të cituara më lart do të përbënin mjaftueshëm një bazë të dhënash, mbi të cilën mund të konkludohej se subjekti ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, edhe sikur të mos ekzistonin rrethanat që kanë bërë të mundur aplikimin e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, duke bërë të zbatueshëm në mënyrë autonome paragrafin 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, si një prej shkaqeve të shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit.

KONKLuzion Përfundimtar

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatores së çështjes, dëgjoji subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha shpjegimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit në përgjigje të pyetësorëve, konkludon se:

- i. Subjekti ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kontrollin e pasurisë, sipas parashikimeve të neneve 39 dhe 33 të ligjit nr. 84/2016.
- ii. Nga vlerësimi tërësor, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, rezulton se subjekti ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Gerrit Sprenger, referuar në nenin 4, pika 2, nenin 58, pika 1, shkronja “c”, si dhe në nenin 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Petraq Çuri, gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, në datën 12.5.2023.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Roland ILIA
Kryesues

Genta Tafa (BUNGO)
Relatore

Suela ZHEGU
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Etmonda Hoxha

